ISSN 1857-6443

## Ligji i gjuhëve
Mes dilemave dhe të papriturave



Fq.3

## MUNGESA E INFERMIERËVE
"Terapi" që mungon janë specialistët



Fq.9

## 27 Prilli, një vit më vonë Arben Taravari



Fq.11

www.koha.mk
# Koha



## Si dhe kush e vrau Avni Rustemin

Fq.12-13

E PËRDITSHME INFORMATIVE · Viti XII · Numri 3353 · e shtunë/e martë 28prill - 1 maj, 2018 · 13°c |29°c · 15 DEN

FORUM

## Na e ktheni 2 Majin!



Unë jam ithtar i zgjidhjes në stilin "ose-ose": ose të hiqen festat fetare (më pak të rëndësishme) krejtësisht, ose festat fetare ortodokse dhe myslimane të vlejnë për të gjithë qytetarët, për shkak se me to përfshihen përqindje e madhe e qytetarëve, mungesa e të cilëve ndikon në punën e administratës ose subjekteve ekonomike, ndërkaq, festat e komuniteteve më të vogla fetare (bektashiane, hebraike, katolike...), të vlejnë vetëm për ta, pasi mungesa e pjesëtarëve të këtyre komuniteteve...

Fq.10

RAJON

## Personat e pagjetur, pengu i Kosovës

Fq.14

GLOBI

## Dy Koretë pajtohen për largimin e armëve nukleare

Fq.15



### PARADOKSET E DIPLOMACISË SË MAQEDONISË

# DUKURIA E DIPLOMATËVE KINSE SHQIPTARË!



**Ka kohë që diplomacinë e Maqedonisë e përcjellin paradokse të karakterit të përfaqësimit nga ana e diplomatëve të ashtuquajtur shqiptarë, të cilët përzgjidhen jo sipas aftësive dhe standardeve profesionale, por sipas njëfarë lojaliteti, që në instancë të fundit - dëmton politikat e drejta kadrovike dhe lë jashtë angazhimit diplomatë të aftë, me formim të mirëfilltë intelektual dhe me integritet moral e qytetar**

Fq.6

## Maqedonia pjesë e revistave pseudoshkencore

*Shkup, 27 prill* - Investigimi i revistave gjoja shkencore, ku falë botimit të punimeve të tyre janë avancuar dhe kanë bërë karrierë akademike një numër i konsiderueshëm profesorësh, dekanësh por edhe rektorë të universiteteve të ndryshme, nuk ka lënë jashtë skandalit as Maqedoninë. Në hulumtimin "Pseudoakademia dhe pazaret me tituj shkencorë në Mjekësi", që ka realizuar së fundmi dr.Taulant Muka në Shqipëri, demaskoi një numër të revistave shkencore, të cilat nuk kanë asgjë të përbashkët me shkencën. E keqja qëndron në atë se pavarësisht irelevancës shkencore të këtyre revistave, publikimet në to kanë shërbyer që shumë persona të marrin thirrjet akademike, pasi në ligjet e arsimit të lartë prej vitesh si në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi dhe gjetiu, kërkohet publikimi në revista shkencore...

Fq.7



EDITORIAL

# GJUHA NË MES TË MULTIKULTURALIZMIT DHE INTERKULTURALIZMIT



Emin AZEMI

Problem i gjuhës nuk nënkupton vetëm dimensionin teknik të komunikimit në mes të njerëzve dhe institucioneve. Më shumë se kaq, gjuha është mendim, aksion, frymë identitare e përfaqësuese.

Mirëpo në Maqedoni ka devijuar shkolla e mendimit sociolingustik dhe në vend të kësaj ka kohë që promovohet shkolla e rrugës, në njërën anë, që mohon çfarëdo lloj barazie zyrtare të shqipes me maqedonishten, dhe , në anën tjetër, shkolla e teknokratëve dhe skolastikëve, të cilët disi duan të na bindin se statusi i një gjuhe është i izoluar nga tërësia e atributeve shtetfrmuese të një kombi.

Në këtë vijimësi mendimi, vjen edhe shkoqitja e profesorit universitar, Svetomir Shkariq ( tv.24), sipas të cilit Ligji për përdorimin e gjuhëve nuk i konvenon as bashkësisë etnike shqiptare, as atyre që e propozuan, për arsye se, thotë Shkariqi, Ligji insiston në respektimin rigoroz të multikulturalizmit, në vend të interkulturalizmit.

Përfaqësuesit e kulturave, gjuhëve e traditave të ndryshme, jetojnë pranë njëri tjetrit dhe kjo komponentë e diversiteteve përcakton multikulturalzmin.

Në anën tjetër, nocioni i interkulturalizmit ka të bëjë me raportet në mes të grupeve të përfaqësuar nga kultura, gjuhë, e tradita të ndryshme, që ndryshe i bie të jetë interaksion.

Multikuluturalzimi përdoret për të përshkruar një shoqëri në të cilën kulturat bashkëjetojnë pranë njëra-tjetrës, pa ndonjë interaksion të madh, ndërkaq interkulturalzmi shpreh bindjen se njerëzit e kulturave të ndryshme, përmes kontakteve dhe përvojave bëhen më të pasur dhe më të zhvilluar.

Sipas profesor Shkariqit, shqiptarët janë pjesëtarë të një komuniteti mërgimtarësh që janë të detyruar të komunikojnë me vendësit, në mënyrë që të kenë më shumë përfitime e përparësi. Përjashtimi i komponentës multikulturore nga Ligji për përdorimin zyrtar të gjuhës shqipe, bëhet me qëllim të krijimit të gradacionit statutar, duke i rezervuar maqedonishtes atributin e gjuhës shtetërore (shtefromuese), kurse shqipes atributin e gjuhës në përdorim zyrtar.

Mendësia akademike maqedonase ende nuk është liruar nga konceptet jakobine të shek.19 dhe konceptualizimi i ngushtë i çështjeve me karakter shumëetnik e shumëkulturor bëhet për të shpikur paradigma të paqena të monopolist etatist.

Kjo mendësi është në koleracion edhe me konceptin e kryeministrit Zaev për Maqedoninë si një shoqëri, koncept ky që as nuk është funksional, as nuk është produktiv. Në radhë të pare, është anakronike të pretendosh sot se ka vetëm një opinion publik, ka vetëm një shoqëri, ka vetëm një hapësirë kulturore-shpirtërore etj. Se shoqëria, kultura, opinion publik kanë specifikat e veta dhe në asnjë mënyrë kjo nuk mund t'i atribuohet realitetit të Maqedonisë, flasin shumë shembuj që vijnë nga hapësirat tjera europiane, por edhe nga hapësira mbarëshqiptare.

Aktualisht te shqiptarët, bie fjala, kemi shumë tema të përbashkëta, por që kalojnë nëpër sfera të ndryshme publike dhe për rrjedhojë nuk mund të flasim për një uniformitet mendimesh e pikëpamjesh. Pasi që kjo është kështu brenda një kombi, si mund të jetë ndryshe në suaza të një shtetit si Maqedonia me diversitet gjuhësor e etnopsikologjik. Si mund të thuhet se gjuha paska vetëm komponentën e interkulturalzimit, pos nëse ata që e trumpetojnë këtë tezë duan të reduktojnë historinë e prezencës së shqiptarëve brenda tendave të nomadëve që sot i ke këtu, nesër si ke askund.

Fryma dhe statusi i gjuhës është vetë ekzistenca e një kombi, kurse shqiptarët përfaqësojnë një prej përbërësve thelbësor të asaj që sot quhet Maqedoni. Pa këtë përbërës, nuk do të kishte kuptim edhe vetë ekzistenca e këtij shteti, emri i të cilit mohohet nga fqiu jugor.



**TESTI PËR DREJTËSINË**

"Një vjet mbas 27 Prillit ditës së kthesës së madhe dhe dita kur e kuptuam sa ishte e brishtë demokracia dhe siguria në vend dhe kur sistemi kolaboi tërësisht. Një ditë e errët në historinë e vendit që nuk duhet të përsëritet më. Një ditë që duhet të jetë shtytës për qeveritë në të ardhmen të punojnë sa më shumë në sundimin e ligjit për të gjithë dhe integrimin e vendit në BE dhe NATO për të ngritur nivelin e demokratizimit dhe sigurisë të vendit. Gjyqësori duhet që të punojë me vendosmëri dhe profesionalizëm të plotë për ti arritur dënimi ato që planifikuan, organizuan dhe realizuan atë veprim të turpshëm dhe qyqar atë ditë në Kuvend. Ky është një test i madh për të dëshmuar se drejtësia nuk është selektive dhe të bëhet shembull për të gjithë që në të ardhmen do të mendojnë të bëjnë kështu veprime negative qofshin ato faktorë të brendshëm apo të jashtëm. Në të kundërtën nuk do të kemi ndryshim real të gjendjes nga regjimi i kaluar. Të gjithë duhet të angazhohemi që ti margjinalizojmë dhe eliminojmë dukuritë negative nga e kaluara për të shpresuar për një të ardhme të mirë", shkruan në statusin e tij në Facebook, anëtari i Kryesisë së BESËS, Kastriot Rexhepi.



**LAJME TË MIRA NGA KORETË**

"Koreja sot na pruni lajme të mira, dhe për këte meritën e kanë vetë koreanët. U takunë prijësit e Veriut dhe të Jugut, pa ndërmjetës. Roja e nderit ish veshë me tesha kombtare dhe valviti flamura historikë koreanë. Nuk pat uniforma perëndimore, e as i pamë bajraqet e dy republikave të krijueme prej fuqive të hueja. Udhëheqësi verikorean Kim Xhongun, që deri dje mediet perëndimore e qujshin diktator, u tregu goxha burrështetas. E ftoi kryetarin jugor Mun Xhejin me kapërcy për pak çaste kufinin për në Veri, dhe dukshëm i mallëngjyem eci ma pas drejt Jugut, ku nënshkroi nji premtim për paqe e bashkim. Kurse Mun Xhejini tha se ka me e vizitu Pjonianin në vjeshë. Në bisedime t'ardhshme pritet me u përfshi edhe Shtetet e Bashkueme dhe Kina, dhe me u arritë nji marrëveshje për me i largu armët bërthamore prej gadishullit.
Ka me u dashtë shum kohë e mund për me mbërri paqen përfundimtare dhe me e bashku Korenë. Por kurrë ma ngat nuk kemi qenë. T'urojmë për të mirë!", shkruan në profilin e tij në Facebook, juristi nga Prishtina, Getoar Mjeku



**ARDHMËRIA E FËMIJËVE TANË**

"Për çdo pikë gjaku të derdhur, për çdo dhimbje të shkaktuar- DREJTËSI TË KETË!!! Kjo e KEQE asnjëherë më të mos përsëritet! Ja vlejti të sakrifikohemi për të ardhmen e ndritshme të Maqedonisë sonë dhe të ardhmen e fëmijëve tanë dhe gjeneratave që do vijnë!", shkruan në profilin e tij në Facebook, deputeti i LSDM-së, Muhamed Zekiri.

## MEDIACitate

"Kjo Qeveri, ky kryetar i Serbisë, ky koalicion qeverisë, kurrë nuk do ta njohë pavarësinë e Kosovës të shpallur njëanshëm", ka thënë shefi i diplomacisë serbe Ivica Daçiq. Ai, duke folur në Kuvendin e Serbisë ka pyetur se çfarë është marrëveshja detyruese juridike nëse ajo nuk është vetë marrëveshja? "E çfarë është marrëveshje jodetyruese juridike, pra? Ne insistojmë për zbatimin e Marrëveshjes së Brukselit", citon "Danas" të ketë thënë Daçiq. Duke folur për deklaratat e zyrtarëve të Kosovës se Asociacioni i Komunave serbe do të krijohet pas anëtarësimit të Kosovës në OKB ose pas nënshkrimit të marrëveshjes detyruese juridike, Daçiq ka thënë: "Kjo jo vetëm që nuk është thënë, por kjo është ikje nga mospërmbushja e detyrimeve të tyre". Sipas fjalëve të tij, "BE duhet të reagojë në deklarata të tilla që dëgjohen nga Kosova sepse duket se tash detyruese është ajo që e kemi nënshkruara para pesë vjetësh e kërkohen bisedime të reja". "Bashkimi Europian është pikëpyetje edhe sa kohë do të ekzistojë, ndërsa Serbia do të ekzistojë përgjithmonë dhe duhet të kemi kujdes për interesat kombëtare e shtetërore", ka thënë Daçiq.
*(Danas, 27 prill)*

Në skandalin me dëbimin e gjashtë shtetasve turq, shteti i Kosovës përveçse ka shkelur ligjet e veta dhe të drejtat e njeriut të personave që ia dorëzoi Shërbimit Sekret Turk, ka bërë edhe një ngatërresë të tmerrshme: bazuar në dokumentet dhe dëshmitë e siguruara nga "Koha Ditore", njëri prej gjashtë turqve është arrestuar dhe deportuar gabimisht, shkruan sot Koha Ditore. Policia me urdhër të AKI-së ka kërkuar të arrestojë shtetasin turk Hasan Hüseyin Demir, por në vend të tij ka arrestuar shtetasin tjetër turk, Hasan Hüseyin Günakan. "A jeni ju Hasan Hüseyin Demir?", e ka pyetur zyrtari i Policisë së Kosovës profesorin e kimisë të shkollës "Gylistan". "Jo nuk jam unë ky person", ia ka kthyer ai. "Unë jam Hasan Hüseyin Günakan". Polici largohet dhe flet me dy pjesëtarët e Agjencisë Kosovare për Inteligjencë, të cilët rrinë jashtë ndërtesës së Aeroportit të Prishtinës. "Çka të bëj, ky po thotë që nuk është ai që është në listë?". Zyrtarët e AKI-së flasin me dikë në telefon, supozohet që me eprorin. "Po, po, ky është, dërgojeni!" i thonë zyrtarit policor.
*(KOHA Ditore, 27 prill)*

NËSE NUK E KENI DITUR...

## ÇFARË DIHET PËR KALANË E SKRAPARIT?

Kalaja e Skraparit është një kështjellë mesjetare e ngritur mbi një kodër të lartë në jugperëndim të qytetit Çorovodë. Zotëron rrugën që kalonte nëpër luginën e Osumit. Njihet ndryshe edhe si "Kalaja e Gjenevizit". Përmendet për herë të parë me rastin e thyerjes së bullgarëve më 1018 nga bizantinët. Më 1336 kalaja e Skraparit, sipas kronistit bizantin Joan Kantakuzeni, ra në dorë të malësorëve arbëreshë gjatë përpjekjeve për të marrë qytetet e vendit që ishin në duart e bizantinëve. Kalaja vazhdoi të përdorej edhe pas pushtimit osman. Në shek.XVII përmendet nga E. Çelebiu.

Sipas burimeve qeveritare, është profesoresha universitare Tanja Karakamisheva, anëtare e Komisionit të Venedikut nga Maqedonia, ajo që ka lobuar fuqishëm deri tek anëtaret tjerë në kuptim të asaj se Ligji për gjuhët nuk është në pajtim me Kushtetutën e Maqedonisë

LIGJI I GJUHËVE DHE KOMISIONI I VENEDIKUT

# MES DILEMAVE DHE TË PAPRITURAVE

Koha | Fatos RUSHITI



*Shkup, 27 prill* - Ligji për gjuhët për një kohë të pacaktuar nuk pritet të përcillet deri tek Gazeta Zyrtare me çka do të vonohet dhe zbatimi tij. Kjo, pasi që Ligji të dërgohet për vlerësim deri tek Komisioni i Venedikut bazuar në marrëveshje politike mes dy partnerëve qeverisës LSDM-BDI, jo vetëm dispozitat për bankënotat dhe uniformat, por Ligji në tërësi me gjasë do të vlerësohet si antikushtetues nga Komisioni i Venedikut. Sipas burimeve jozyrtare qeveritare, është profesoresha universitare Tanja Karakamisheva, anëtare e Komisionit të Venedikut nga Maqedonia, ajo që ka lobuar fuqishëm deri tek anëtaret tjerë në kuptim të asaj se Ligji nuk është në pajtim me Kushtetutën e Maqedonisë. Profesoresha së drejtës kushtetuese dhe sistemit politik në Fakultetin Juridik të Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup, Karakamisheva, njëherësh anëtare e Kryesisë së ngushtë të VMRO-së, është mbrojtës fanatike e kauzës së kësaj partie kundër Ligjit për shqipen. Mandatin për anëtare të Komisionit të Venedikut, Karakamisheva e ka marrë në janar të vitit 2018, ndërsa i përfundon në janar të vitit 2020.

"Kemi informata se Karakamisheva, si përfaqësuese e Maqedonisë në Komisionin e Venedikut, ka lobuar tek disa anëtarë që të mos mbështetet Ligji për gjuhët dhe të jepet vlerësim kundër-kushtetues për të njëjtin. Burimet tona nga Komisioni i Venedikut thonë se ka mendime të ndara rreth Ligjit për gjuhët dhe sugjerimet kanë qenë që të mos ngutemi me dërgimin e Ligjit, së pari në Gazetën Zyrtare, e më pas në Komisionin e Venedikut", thonë në Qeveri.

Ndryshe, Karakamisheva kohë më parë përmes një statusi në Facebook ka adresuar kritika të ashpra ndaj Qeverisë së Maqedonisë të udhëhequr nga kryeministri Zoran Zaev, pikërisht lidhur me Ligjin e gjuhëve. Karakamisheva, e cila në opinion njihet si nacionaliste në kurriz të shqiptarëve, shkruan se, "nëse me forcë dhe pa dëshirën e qytetarëve ndryshohet emri, identiteti, gjuha dhe historia, atëherë përgatituni për një proces të gjatë dhe të mundimshëm gjyqësor në nivel botëror ku nuk do mund të ju shpëtojnë as BE as Shën BE". Ajo ishte edhe një nga përkrahësit e protestave "Për një Maqedoni të përbashkët" kundër gjuhës shqipe.

Nga Qeveria ende janë të paqartë nëse Karakamisheva mund të zëvendësohet me ndonjë person tjetër para skadimit të mandatit të saj. Burime të afërta me partitë në pushtet thonë se përkundër asaj që Ligji nuk ka pengesa të hyj në fuqi, por se efekti politik dhe reperkusione të mundshme nga VMRO do të ishin të pritshme në rast se Ligji do të dërgohet në Gaztën Zyrtare dhe Komisioni i Venedikut do të jepte vlerësim negativ. "Partitë në pushtet do të vlerësojnë më gjerësisht situatën rreth Ligjit për shqipen, meqë nuk është problemi që ai të përcillet deri tek Gazeta Zyrtare, por duhet pasur parasysh edhe atë se Qeveria siç është zotuar Ligjin mënjëherë ta dërgojë në Komisionin e Venedikut, dhe në rast vlerësimi negativ të mundshëm, janë të pritshme reperkusionet e VMRO-së në aspekt të reformave dhe zgjidhjes së çështjes së emrit”, thonë për gazetën KOHA burime të afërta me partitë në pushtet. Kryetari i Parlamentit, Talat Xhaferi, dje ka përsëritur se do ta lëshojë Ligjin e gjuhëve për shpallje në Gazetën Zyrtare, por nuk saktësoi se kur do ta bëjë këtë. "Nuk jam i ngarkuar për kohën kur do ta lëshoj Ligjin në Gazetën zyrtare", tha Xhaferi. Kushtetutën lidhur me mos nënshkrimin e dekretit për këtë ligj, sipas tij, e ka shkelur presidenti Gjorge Ivanov. I pyetur çfarë nëse ai thirret për përgjegjësi se pa nënshkrim të Ivanovit e ka dorëzuar ligjin në Gazetën zyrtare, kryetari i Parlamentit pohon se ai nuk do ta shkelë Kushtetutën dhe se dërgimi i Ligjit për shpallje nuk është vepër penale.

## XHAFERI DO TA DËRGOJË LIGJIN, POR PA DATË KONKRETE



Kryetari i Parlamentit, Talat Xhaferi, dje ka përsëritur se do ta lëshojë Ligjin e gjuhëve për shpallje në Gazetën Zyrtare, por nuk saktësoi se kur do ta bëjë këtë. "Nuk jam i ngarkuar për kohën kur do ta lëshoj Ligjin në Gazetën zyrtare", tha Xhaferi. Kushtetutën lidhur me mos nënshkrimin e dekretit për këtë ligj, sipas tij, e ka shkelur presidenti Gjorge Ivanov. I pyetur çfarë nëse ai thirret për përgjegjësi se pa nënshkrim të Ivanovit e ka dorëzuar ligjin në Gazetën zyrtare, kryetari i Parlamentit pohon se ai nuk do ta shkelë Kushtetutën dhe se dërgimi i Ligjit për shpallje nuk është vepër penale

## Nuk është e mundur zgjidhje pa ndryshim të Kushtetutës

*Athinë, 27 prill* - Zgjidhja nuk mund të ekzistojë pa e ndërruar paraprakisht vendi fqinj Kushtetutën e vet dhe në mënyrë komplete dhe të pakthyeshme t'i mënjanojë të gjitha elementet e irredentizmit, thotë Kirjakos Micotakis, lideri i partisë më të madhe opozitare greke, duke folur para përgjegjësve të sektorëve të ndryshëm në Demokracinë e Re. Micotakis konsideron se mënyra në të cilën qeveria menaxhon me negociatat, shkakton shqetësim dhe edhe njëherë përsëriti qëndrimin e tij se "nuk do t'i ndajnë grekët, për t'i bashkuar shkupjanët". "Shqetësim të veçantë shkakton situata në çështjen e Shkupit. Atje ku diplomacia e fshehtë, me mosdiije të askujt, përnjëherë solli në plan të parë një çështje, e cila siç duket, nuk ishte e pjekur për t'u zgjidhur. E edhe më keq, me çështjen e Shkupit, qeveria në fund arriti t'i bashkojë dhe t'i përforcojë fqinjët tanë dhe tentoi t'i ndajë grekët", thotë lideri i Demokracisë së Re opozitare. Siç lajmëroi korrespondentja e MIA-s nga Athina, Micotakis i adresoi kritika të ashpra qeverisë së kryeministrit Aleksis Cipras se është e rrezikshme për politikën e jashtme greke. "Kjo qeveri është e rrezikshme dhe e paralajmëroj që përfundimisht të bëhet serioze, së paku në çështjet nacionale. Meqenëse do të ishte kriminale nëse në politikën e jashtme të vendit e përsëritë dëmin që e shkaktoi në ekonominë nacionale", tha Micotakis. Duke folur për ekonominë e vendit dhe qëndrimin e qeverisë se pas 20 gushtit vendi del nga politika e memorandumit dhe programi për mbështetje financiare, Micotakis e porositi Ciprasin, nëse me të vërtetë është ashtu, atëherë të shpallë zgjedhje në shtator.

GALUP INTERNESHËNËL ME ANKETË TË RE

# Gati gjysma e qytetarëve të kënaqur nga Qeveria

*Shkup, 27 prill* - Pothuaj gjysma e qytetarëve të anketuar të Maqedonisë pozitivisht e vlerësojnë punën e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, tregon raporti i 41-të global i Galup Interneshënël me temë Indeks i qeverisë.

Hulumtimi u zbatua në periudhën nga fundi i nëntorit deri në fillim të dhjetorit të vitit 2017, dhe sipas tij, indeksi i Qeverisë së Maqedonisë është 48.

Se Qeveria e Maqedonisë është efikase vlerësojnë 47 për qind nga të anketuarit, 48 për qind vlerësuan se respekton vullnetin e popullit, ndërsa 50 për qind prej tyre vlerësojnë se e çon vendin në drejtimin e duhur. Në Maqedoni, Brima zbatoi anketë në terren, ballë përballë në shtëpinë e të anketuarit, tek 1210 të anketuar të moshës mbi 15 vjeçarë.

Nga fqinjët e Maqedonisë, më afër këtyre vlerësimeve janë qeveritë e Serbisë dhe Shqipërisë me indeks 41. Në raport me Maqedoninë, Serbinë dhe Shqipërinë, në numër dukshëm më të vogël pozitivisht janë vlerësuar Qeveria e Kosovës me indeks 28, Qeveria e Bullgarisë me indeks 27 dhe me notë më të ulët pozitive është vlerësuar Qeveria e Greqisë me indeks 20. Rezultatet e Barometrit më të ri botëror global në temë "Indeksi i votës së popullit për Qeverinë" tregojnë se vetëm një e treta e qytetarëve në nivel global, pozitivisht i vlerësojnë qeveritë e tyre.

Indeksi i Zërit të popullit për qeverinë tregon se lidhja mes politikanëve dhe qytetarëve të tyre është më e madhe në shtetet më të zhvilluara dhe demokratike. Pakënaqësia e tillë masive krijon kushte për lëvizje populiste dhe stuhi ekstreme të djathta/të majta, bëhet e ditur në raportin e Gallup Interneshënëll.



## Maqedonia t'i bashkohet Italisë

Shkup, 27 prill - Procesi eurointegrues i Maqedonisë, anëtarësimi në makro rajonin Adriatik - Jon, marrëdhëniet bilaterale mes Maqedonisë dhe Italisë, ishin pjesë e temave të bisedave në takimin e sotëm të zëvendëskryeministrit i obliguar për Çështje Evropiane, Bujar Osmani, me drejtorin e përgjithshëm të Drejtorisë për Bashkimin Evropian pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Italisë, Xhuzepe Buçino. Siç kumtoi Sekretariati për çështje evropiane, Osmani fillimisht u falënderua për mbështetjen e deritanishme të Italisë për integrimin euro- atlantik të Maqedonisë dhe përshëndeti qëndrimin e Italisë në procesin e zgjerimit të Bashkimit Evropian e cila nuk do të mbarojë deri sa të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor nuk do të kyçen në familjen e madhe Evropiane. "Tani, pasi Greqia edhe zyrtarisht konfirmoi se nuk do ta kontestojë hyrjen tonë , pres së shpejti ti bashkohemi Italisë dhe vendeve tjera të makro rajonit Adriatik- Jon", tha Osmani në takim, duke potencuar rëndësinë e bashkëpunimit të ndërsjellë të vendeve të Ballkanit Perëndimor, e cila edhe tani zhvillohet me një tempo të përforcuar nëpër iniciativa tjera, siç është Procesi i Berlinit. Gjatë bisedës, Osmani u përqendrua edhe në Raportin pozitiv të KE-së për gjendjen dhe progresin e Maqedonisë në rrugën drejt BE-së, i cili tregoi se Republika e Maqedonisë me sukses i adreson prioritetet urgjente, se është tejkaluar kriza politike, dhe se vendi është kthyer në binaret normale demokratike. Osmani theksoi, se rekomandimi i pastër për fillimin e negociatave, paraqet shtytje për shtetin të mbetet e fokusuar reformave dhe e përkushtuar agjendës euro- atlantike. Në takim u hapën edhe tema për marrëdhëniet bilaterale, gjatë së cilës bashkëbiseduesit konstatuan se Republika e Maqedonisë dhe Republika e Italisë nuk kanë çështje të hapura politike, dhe se ajo paraqet potencë për avancim të bashkëpunimit të ndërsjellë.

DONALD TUSK NË MAQEDONI

# QËNDROJMË PRANË JUSH

"Qëndruat me ne në rastin Solsberi dhe ne do të qëndrojmë afër jush. BE-ja është shpresa më e madhe për qytetarët tanë", tha njeriu i parë i Këshillit Evropian

Koha Evis HALILI



*Shkup, 27 prill* - Ndjej ndryshim në ambientin politik të Maqedonisë dhe vullnet të mirë për lëvizjen e integrimit euroatlantik. Shoh lidership të inkurajuar, të orientuar drejt së ardhmes. Rekomandimi i KE-së është dëshmia më e mirë se përpjekjet e Maqedonisë kanë impresionuar shumicën në Evropë, theksoi kryetari i Këshillit Evropian Donald Tusk në konferencën e përbashkët për shtyp me kryeministrin Zoran Zaev. Tusk tha se nuk ka vend më të mirë se Shkupi që ta përfundojë turneun ballkanik. "Shumë punë u ndryshuan nga viti 2015, kur erdha që të ndalet fluksi i emigrantëve. Prej atëherë Ruta Ballkanike është mbyllur dhe ashtu duhet të mbetet", tha Tusk. Ai i shprehu falënderim Maqedonisë për ndalimin e rutës së emigrantëve, por edhe për përkrahjen për rastin Skripal. "Qëndruat me ne në rastin Solsberi dhe ne do të qëndrojmë afër jush. BE-ja është shpresa më e madhe për qytetarët tanë", tha njeriu i parë i Këshillit Evropian.

Lidhur me rëndësinë e fqinjësisë së mirë, Tusk tha se me Marrëveshjen e nënshkruar me Bullgarinë, Maqedonia ka dëshmuar se kur ekziston vullnet të tejkalohen esencat e së kaluarës, ekziston edhe mënyrë të shkohet drejt së ardhmes. "Shpresoj se e njëjta do të arrihet edhe me Greqinë. E keni përkrahjen time të pakushtëzuar dhe besoj te ju", tha Tusk. Kryetari i Këshillit të Evropës theksoi se BE-ja do t'i ndihmojë Maqedonisë në përpjekjet për realizimin e reformave dhe se për këtë i ka të gjitha përbërjet e nevojshme për sukses - konsensus politik për anëtarësim në BE dhe në NATO, si dhe vendosmëria e qytetarëve.

"BE-ja është shpresa më e madhe për ardhmëri më të mirë për qytetarët tuaj. Këtë e them nga përvoja si polak. Sot në kuadër të BE-së, mund ta ruajmë identitetin tonë kombëtar, derisa jemi pjesë e bashkësisë më të madhe në të cilën të gjithë mund të prosperojmë", konkludoi Tusk. Kryetari i Këshillit Evropian shtoi se në Samitin e ardhshëm BE-Ballkani Perëndimor në Sofje duhet të vendoset energji e re në marrëdhëniet, të riafirmohet perspektiva evropiane në rajon dhe të përmirësohen lidhjet edhe në vetë rajonin. Theksoi se është e nevojshme edhe përballje e përbashkët me sfidat e sigurisë, siç janë trafikimi i emigrantëve, terrorizmi dhe krimi i organizuar. "BE-ja është dhe do të mbetet partner më i besueshëm i të tërë rajonit. Unioni është investitori më i madh, donator dhe partneri më i madh tregtar në tërë rajonin dhe kjo ka të bëjë edhe me Maqedoninë. Rreth 80 për qind e eksportit tuaj shkon në BE, 13 për qind nga eksporti bie tek fqinjët e Ballkanit Perëndimor dhe vetëm 1,5 për qind është me Turqinë, një për qind me Rusinë dhe një për qind me Kinën", tha Tusk.

Kryeministri Zaev, ndërkaq, tha se pas KE-së, Maqedonia dëshiron t'i bindë edhe vendet anëtare se meriton të marrë datë dhe t'i fillojë negociatat për anëtarësim, ndërsa në këtë nuk ka qenë asnjë më afër se tani. "Vazhdojmë me të njëjtin ritëm, reformat do të bëhen më të dukshme dhe më konkrete", tha Zaev, duke e paralajmëruar Planin 18, që po përgatitet në bashkëpunim me KE-në.

Ai tha se pas lajmit jashtëzakonisht të mirë nga KE-ja se për RM-në do të propozohet rekomandim pa kusht dhe i pastër për fillimin e negociatave parainkuadruese me BE-në, në këtë vizitë shikojmë si në një mirënjohje të madhe, inkurajim, por edhe përgjegjësi për vendin. "Me mirënjohjen për përparimin e Maqedonisë, njëkohësisht vjen edhe përgjegjësia që të vazhdojmë me intensitet të njëjtë me transferim të RM-së në shembullin e standardeve të BE-së. Nuk ka kohë për lëshime, në periudhën e ardhshme do t'i ndajmë përpjekjet tona. Reformat do të jenë më të qarta, më konkrete dhe më efikase", tha Zaev. Theksoi se Maqedonia doli nga kriza e thellë politike dhe nga shteti i robëruar, u kthye në rrugën në të cilën ecin të gjitha shtetet demokratike evropiane, janë përgatitur dhe implementuar planet fillestare reformuese, si plani 3-6-9 dhe mori rekomandim të pastër.

SHEKERINSKA NË UASHINGTON

## Anëtarësimi në NATO, shpresë të re për Ballkanin

*Uashington, 27 prill* - Kërkojmë përkrahje nga SHBA-ja që Maqedonia të marrë ftesë për anëtarësim në NATO këtë vit, pasi një depërtim i tillë mund të ketë ndikim pozitiv, i cili do të krijojë shpresë të re në Ballkan, tha zëvendëskryetarja e Qeverisë dhe ministrja e Mbrojtjes, Radmilla Shekerinska në tryezën e rrumbullakët në Uashington, të organizuar nga Këshilli atlantik amerikan, me çka e filloi vizitën zyrtare në SHBA. Në tryezën e rrumbullakët me temë "Ballkani dhe anëtarësimi në NATO përmes prizmit të Maqedonisë: Dispozita të larta në aspektin e sigurisë globale dhe fati i demokracisë në një vend të vogël", Shekerinska foli për Ballkanin dhe sfidat me të cilat u ballafaqua në të kaluarën, për krizën politike në Maqedoni dhe proceset e reja reformuese, si dhe kthimin e vendit në rrugën drejt integrimeve euroatlantike. "Këto 10 muaj seriozisht përqendrohemi në reformat e vendit dhe në përmirësimin e marrëdhënieve të mira fqinjësore. U orientuam në çështje të cilat ishin në thelbin e integrimit euroatlantik - media të lira, sundimin e së drejtës, marrëdhëniet ndëretnike, rezistimit të institucioneve", tha ministrja. Duke u kthyer në ngjarjet në Kuvend të cilat kanë ndodhur në datën e sotme të vitit të kaluar, Shekerinska tha se vitin e kaluar më 27 prill Maqedonia e ka prekur fundin.




"Ngjarja mundej tërësisht të dalë nga kontrolli dhe u kërcënua që ta dërgojë shtetin afër luftës civile. Ne formuam shumicë në Parlament dhe të gjithë prisnim të formohet qeveri e re, e orientuar për reforma, kur njerëzit që dëshironin gjithçka të mbetet e vjetër, panë se dhuna është rruga e vetme që u mbetet. Për fat tentimi ishte i pasuksesshëm", tha Shekerinska. Si shembull për realitetin e ri dhe ndryshimet demokratike, e përmendi peizazhin medial dhe përmirësimet e dukshme në këtë sferë. "Ne jemi ylli i ri i raportit të fundit të Fridom Haus, i cili thotë 'Maqedonia e ka mundësinë më të madhe për kthesë demokratike në Evropë'. Për herë të parë pas vitit 2010 ne shohim përmirësim në çdo kriter. Mediat janë të lira të zgjedhin kë do ta kritikojnë, duke përfshirë edhe Qeverinë, por kjo është si duhet demokracia të duket", tha ministrja. Shekerinska potencoi se Qeveria investon shumë në raportet me fqinjët, duke e përmendur marrëveshjen për fqinjësi të mirë me Bullgarinë, e cila u nënshkrua për më pak se dy muaj pas zgjedhjes së Qeverisë. "Kjo marrëveshje ka hapur mundësi të mëdha për të dy palët. Edhe Maqedonia edhe Bullgaria u prezantuan si vende të cilat janë të pjekura dhe të interesuara për ardhmërinë dhe vende të cilat sillen në mënyrë evropiane", tha ministrja. Ajo shtoi se kjo ka rezultuar me vetëbesim që Qeveria të kyçet në zgjidhjen e problemit kyç me Greqinë - emrin, me vendosmëri të qartë që të tentojë të gjejë zgjidhje për këtë çështje shumëvjeçare.

DEBAT PËR REFORMAT NË MINISTRINË E BRENDSHME



# MODELI PËR MBIKËQYRJEN E POLICISË, ËSHTË I DUHURI?

Sipas ndryshimeve në Ligjin për Avokatin e Popullit, të miratuara nga Parlamenti në muajin shkurt, mbikëqyrja mbi punën e efektivëve të policisë do të bëhet nga Avokati i Popullit, ndërsa në prokurori dhe gjykatë do të themelohen njësi të specializuara për hetimin e punonjësve të policisë në rastet e tejkalimit të kompetencave dhe ushtrimin e dhunës

Koha Evis HALILI

*Shkup, 27 prill* - A duhet kontroll i jashtëm qytetar mbi punën e policisë? Ngjarjet e dhunshme të 27 prillit të vitit të kaluar në Parlament treguan se nëse do të ekzistonte kontrolli i pavarur mbi Ministrinë e Punëve të Brendshme kjo situatë nuk do të kishte ndodhur. Sipas ndryshimeve në Ligjin për Avokatin e Popullit, të miratuara nga Parlamenti në muaji shkurt, mbikëqyrja mbi punën e efektivëve të policisë do të bëhet nga Avokati i Popullit, ndërsa në prokurori dhe gjykatë do të themelohen njësi të specializuara për hetimin e punonjësve të policisë në rastet e tejkalimit të kompetencave dhe ushtrimin e dhunës. Në debatin e organizuar të premten me temë "Avokati i Popullit mes kompetencave speciale dhe kapaciteteve: Kontrolli i jashtëm civil mbi punën e policisë", ka pasur vërejtje lidhur me modelin e propozuar, të kontrollit të jashtëm civil ndaj policisë. Kreu i Komitetit të Helsinkit, Gordan Kallajxhiev, ka thënë se ky nuk është modeli më i mirë, për vetë faktin që është miratuar në mbledhje me dyer të mbyllura brenda MPB, në një formë identike me modelin për ndjekjen e komunikimeve. Kallajxhiev ka vënë në dukje se fokusi i kësaj mbikëqyrje është vënë në lëndimet më të rënda, ndërsa nga ana tjetër me këtë sistem do të mbeten të paprekshme rastet me policinë me të cilat përballen çdo ditë qytetarët.

"Edhe pse kjo çështje u hap në mënyrë shumë cilësore, ne po e mbyllim shumë shpejt, me mangësi në vendimet ligjore", ka thënë Kallajxhiev. Avokati i Popullit, Ixhet Memeti ka pasur vërejte jo vetëm lidhur me abuzimet e punonjësve të policisë me detyrën, por edhe me procedurat e munguara për hetimin e këtyre rasteve nga prokuroria. Ai i ilustroi me rastet "Sopoti" dhe dy të tjera, ku efektivë të policisë kanë dhunuar një të burgosur dhe një rast kur kanë keqtrajtuar një nxënës për të trembur të tjerët që të mos protestojnë kundër testimit ekstern.

Ministri i Punëve të Brendshme, Oliver Spasovski, ka dhënë një pasqyrë të punës dhe organizimit të brendshëm të këtij institucioni. Ai ka bërë me dije se gjatë dhjetë muajve të kaluar 33 punonjës akuzohen për 36 vepra penale, mes të cilave edhe për keqpërdorimin e detyrës, dhunë dhe shantazh. Ndërsa ndaj 291 punonjësve janë marrë masa disiplinore. Sipas tij, në këtë institucion ka ekzistuar një grup politikisht i okupuar që merrej me fshirjen e gjurmëve.

"Dhe prandaj kemi pasur situata për të cilat nuk mund të gjejmë fakte dhe të kemi informacione relevante, pasi që faktet ose janë asgjësuar, ose më nuk janë të tilla, ashtu si në kohën kur është kryer vepra penale. Ky sistem më nuk mund të vihet në lojë", ka thënë ministri, duke iu referuar reformave që kanë nisur. Të pranishmit në debat i kanë apeluar për të miratuar sa më shpejt ndryshimet në Ligjin për Prokurorinë dhe gjyqësorin, aty ku edhe pritet të formohen njësitë e specializuara për të luftuar këto fenomene abuzive.

## Shkup, 12 aksidente me një të lënduar rëndë

*Shkup, 27 prill* - Një këmbësor ka marrë lëndime të rënda trupore, ndërsa katër persona me lëndime më të lehta në gjithsej 12 aksidente që kanë ndodhur dje në rajonin e SPB-së Shkup. Nga MPB informojnë se prej gjithsej 12 aksidenteve, katër janë me lëndime trupore, një me lëndime të rënda trupore dhe shtatë me dëm material. Policia rrugore ka zbuluar dhe sanksionuar një numër të madh të shkeljeve. Gjashtë shoferë kanë qarkulluar me shpejtësi më të madhe nga e lejuara, katër shoferë kanë kaluar në udhëkryq në dritë të kuqe dhe pesë shoferë të biçikletës me motor, mopedit dhe motoçikletës të cilët nuk kanë përdorur helmetë mbrojtëse. Nga komunikacioni janë përjashtuar 12 automjete. Njëmbëdhjetë prej tyre për shkak të automjetit të paregjistruar, ndërsa dy për shkak të automjetit të pakontrolluar teknikisht. Nga komunikacioni janë përjashtuar 20 shoferë prej të cilëve tetë për shkak të drejtimit të automjetit nën ndikim të alkoolit, 11 kanë drejtuar automjetin para se të marrin patentë shoferi dhe një shofer fillestar. Janë zënë edhe 79 automjete të parkuara në mënyrë të paligjshme. Me ndihmën e automjetit special të karrotrecit, janë mënjanuar 64 automjete.

# KRONIKË

## Njëvjeçari bie nga ballkoni, transferohet në Klinikën e Fëmijëve

Një fëmijë njëvjeçar në Kumanovë ka rënë nga ballkoni pas çka është transferuar në shtëpinë e shëndetit, ndërsa nga atje në klinikat e Shkupit. Ministria e Punëve të Brendshme informon se dje në orën 15:55 në SPB Kumanovë, nga Ndihma mjekësore urgjente ishte lajmëruar se në rr."Maqedonia e Egjeut" ka ndodhur një rast fatkeqësie në të cilin fëmija 13 muajsh ka rënë nga ballkoni. Fëmija është transferuar në Shtëpinë e Shëndetit Publik në Kumanovë dhe pas dhënies së ndihmës mjekësore ishte transferuar në Klinikën e fëmijëve pranë kompleksit të klinikave "Nëna Terezë" në Shkup. Po ndërmerren masa për zbardhjen e rastit.

## Mashtrohet 60 vjeçari

63 vjeçari Q.A të enjten ka denoncuar në Policinë e Gostivarit se rreth orës 8 e 45 minuta në afërsi të Spitalit të Gostivarit, është takuar me një njeri të panjohur i cili i ka thënë se është aksidentuar me një shtetas të Arabisë Saudite dhe se duhet ti paguajë dëmshpërblim. I panjohuri është larguar dhe i është afruar kinse është një shtetas i Arabisë, i cili i ka kërkuar para që të vërtetojë se a janë të njëjta me ato që i ka dhënë qytetari me të cilin është aksidentuar. Qytetari i Gostivarit i ka besuar dhe i ka dhënë 8000 denarë. Pas një kohe, ai ka kuptuar se është manipuluar dhe rastin e ka paraqitur në polici. Policia punon në zbardhjen e këtij rasti dhe gjetjen e manipulatorëve. Ky nuk është rasti i parë që ndodh në Gostivar me mashtrime të kësaj natyre.

## Helmohet duke konsumuar 40 tableta

Të enjten në mesnatë, në Spitalin e Gostivarit është sjellë 40 vjeçari N.A nga fshati Vrapçisht, i cili ka konsumuar 40 tableta dhe ka marrë helmim. Pas konsumimit të tabletave, ai ka humbur vetëdijen afër një lokali në këtë fshat. Më pas është dërguar në spital, ku i është dhënë ndihma e parë dhe është lëshuar për mjekim shtëpiak.

## Dhunë familjare në Dobrosht

Të enjten rreth orës 10 e 30 minuta, 67 vjeçari A.I nga fshati Dobrosht ka denoncuar dhunë që e ka ushtruar djali i tij, 29-vjeçari D.I. Sipas denoncimit, rreth orës 9 e 30 minuta, gjatë një zënke verbale, situata ka dalur jashtë kontrollit dhe djali ka filluar që me pllaka bekatoni të thyejë dritaret. Policia e ka ndaluar atë dhe punohet në zbardhjen e plotë të rastit. *(U.H)*

PARADOKSET E DIPLOMACISË SË MAQEDONISË



# DUKURIA E DIPLOMATËVE KINSE SHQIPTARË!

**Ka kohë që diplomacinë e Maqedonisë e përcjellin paradokse të karakterit të përfaqësimit nga ana e diplomatëve të ashtuquajtur shqiptarë, të cilët përzgjidhen jo sipas aftësive dhe standardeve profesionale, por sipas njëfarë lojaliteti, që në instancë të fundit - dëmton politikat e drejta kadrovike dhe lë jashtë angazhimit diplomatë të aftë, me formim të mirëfilltë intelektual dhe me integritet moral e qytetar**

Koha Zejnulla VESELI

*Shkup, 27 prill* - Nga gjithsejtë 50 ambasada që ka Maqedonia, 19 prej tyre janë pa ambasadorë, prej të cilave pa ambasador ose konsull janë në 14 vende anëtare të BE-së. Ky proces për nominim e ambasadorëve shqiptarë nga ana e BDI-së, si partnere plotë 10 vite me partinë e mëparshme VMRO dhe tani me LSDM-në, po ngelet i papërfunduar. Plotësimi i vendeve të zbrazura të ambasadorëve dhe konsujve, edhe përkundër realizmit të 95 për qind Planit për reforma 3-6-9, mbetet ende në suaza të premtimeve.

Të pyetur rreth qëndrimit që ka BDI për emërimin e ambasadorëve të rinj, nga kjo parti thonë se është përcaktuar grupi i parë i ambasadorëve prej tre shqiptarëve.

"Ne përputhje me planin reformues dhe pritshmërinë e Brukselit, partnerët e koalicionit tashmë kanë përcaktuar dinamiken e plotësimit te vendeve boshe ne përfaqësitë diplomatike jashtë vendit. Në dhjetor, Qeveria ishte përcaktuar për grupin e parë të ambasadoreve që do të dërgohen në Bruksel, Paris, Berlin, dhe në këtë grup janë të paraparë tre ambasador shqiptar në Berlin, Oslo dhe Bern. Ndërsa në vendet tjera ku nuk kemi ambasadorë si dhe në ato vende ku tani më dhjetë ambasadorëve ju përfundon mandati, do të shqyrtohen se shpejti", thonë nga BDI-ja.

### JO PARTITË, POR MPJ EMËRON AMBASADOR

Mirëpo nga Ministria e Punëve të Jashtme (MPJ) deklarojnë se emërimi i ambasadorëve nuk është më punë e partive në pushtet, por nominim e bënë vetë ministri dhe se lista e emrave të ambasadorëve të rinj është në përfundim, kurse emrat e rinj do të propozohen nga brenda ministrisë dhe do të jenë me përvojë - diplomat të profesionalizuar në karrierë.

"Është e vërtetë se jemi në fazën finale të raundit të parë të plotësimi të vendeve të zbrazura të ambasadorëve të Maqedonisë dhe në këtë raund është kyçur misioni pranë BE-së. Nuk mund të prononcohem për emra konkret nga se vazhdon procedura, megjithatë theksi është vendosur tek sistemi dhe tek profesionistët, respektivisht diplomat të karrierës që punojnë brenda ministrisë", thonë nga MPJ.

Burime brenda MPJ-së informojnë se të paktën 10 shqiptarë janë në këtë ministri që i plotësojnë të gjitha kriteret për të përfaqësuar diplomacinë e Maqedonisë kudo të botë.

"Partia shqiptare në pushtetin e mëparshëm dhe tani me qeverinë aktuale, asnjëherë nuk ka treguar interesim të duhur për favorizimin e kuadrove me kualifikim adekuat, gjë që i shkonte për shtati partisë VMRO-DPMNE e cila donte shqiptarët t'i mbante larg qendrave diplomatike me relevantë, përveç atyre personave të cilët i nominonte BDI-ja, që as për nga emrimbiemri, e as nga identiteti kombëtar asgjë të përbashkët nuk kishin me shqiptarët", thonë nga MPJ.

### KUR DIPLOMATI SHQIPTAR SKËNDERBEUN E QUAN KRIMINEL?

Mirëpo, shtrohet pyetja se sa ky kriter i MPJ është në frymën e nxitjes së kreativitetit profesional me bazë të gjerë shumetnike, apo është një kriter me dy tehe? Duke emëruar diplomatë me atribut kinse shqiptar, MPJ sikur do t'ua mbyll gojën partive politike se gjoja po plotësohet kriteri i përfaqësimit etnik, por në anën tjetër kuadrot e tilla shumë pak kanë lidhje me të qenit shqiptar, në aspektin kulturologjik e identitar, sepse ata ose nuk i dëgjon kush të komunikojnë shqip, ose nëse kryejnë ndonjë funksion diplomatik jashtë shtetit, nuk mbahen mend të kenë përfaqësuar ndonjë interes të vockël të shqiptarëve të Maqedonisë. Madje, siç thonë burimet tona brenda MPJ, mërgimtarët tanë në diasporë kanë shprehur në disa raste pakënaqësi ndaj kësaj kategorie të diplomatëve, të cilët jo vetëm që nuk janë dukur në mjediset ku zhvillojnë aktivitete mërgimtarët shqiptarë, por ata në raste të caktuara edhe janë munduar të mohojnë, apo disi të kamuflojnë, prejardhjen e tyre shqiptare.

Se çfarë përfaqëson kjo kategori diplomatësh, tregon edhe një rast skandaloz, kur njëri prej tyre e kishte tërhequr fëmijën e tij nga aktivitet e shkollës, diku këtu në Maqedoni, ku është përmendur figura e Gjegj Kastriotit Skenderbeut, mer arsyetimin se fëmija i tij nuk ka nevojë të edukohet me "pallavrat e kriminelit Skënderbe"(!)

### STANDARDET E DYFISHTA TË IVANOVIT

Presidenti Ivanov deri më tani ka qenë pengesa kryesore e mosdekretimit të ambasadorëve, si pasojë e një konflikti të heshtur që ka ekzistuar në mes të tij dhe BDI-së, qysh nga koha e zgjedhjeve të fundit presidenciale në vitin 2014.

Mirëpo, burimet tona në MPJ thonë se ka pasur edhe përjashtime për tre diplomatë që janë propozuar ambasadorë në emër të shqiptarëve, por që pa kurrfarë problemi janë dekretuar nga Ivanovi, veprim ky që ka shkaktuar revoltë në mesin e të punësuarve shqiptarë në MPJ, duke pyetur madje se si tolerohet ky qëndrim me dy standarde i Presidentit të shtetit. Apo ndoshta, thonë ata, ende jemi në kohën e një regjimi të kaluar në ish-Jugosllavi, kur disa kuadrot propozoheshin dhe dërgoheshin në Beograd dhe ata flisnin në emër të shqiptarëve, por kundër interesave të shqiptarëve!

"Kjo gjendje ka ndikuar dukshëm që shqiptarët e paktë në këtë ministri të lihen pas dore, të kenë role dytësore, të mos dërgohen në misione me relevantë, sepse në vend të tyre, me pajtimin e heshtur të BDI, edhe Presidenti i Maqedonisë pa asnjë problemi i dekreton këtë ambasadorë", thonë nga MPJ-ja. Pikërisht sipas këtij burimi pranë MPJ-së, kjo është për të u habitur se pse për këta ambasadorë që shumë pak kanë lidhje me shqiptarët, presidenti Ivanov nënshkruan dekretimin ndërsa për emrat tjerë që janë puro shqiptar të nominuar nga BDI-ja tash e 4 vite presidenti Ivanov nuk po ua jep nënshkrimin final.

"Opinioni shqiptar, ka të drejtë të mos e din se cili është roli i një diplomati në një vend tjetër. Por partitë politike gjithsesi do të duhet ta dinin këtë rol, sidomos në ato shtet të Evropës dhe botës ku kemi një numër të madh të diasporës shqiptare që do të kontribuonin shumë edhe për thithjen e ndonjë investimi të huaj edhe në trevat e banuara me shqiptarë sepse këtë roli e mbajnë ambasadat anekënd botës", thotë burimi nga MPJ-ja.

Numri i të punësuarve në MPJ aktualisht është 291 veta, prej të cilëve 64 janë shqiptarë. Ky është edhe kapaciteti kadrovik i MPJ sa i përket rekrutimit të ambasadorëve të ardhshëm, që pritet të emërohen në disa qendra të rëndësishme të botës. Ndërkaq, në 8 Misione, që ka Republika e Maqedonisë, për momentin nuk ka asnjë shqiptarë, ndërsa në 8 konsullatat gjenerale të Republikës së Maqedonisë, vetëm një është shqiptar, (në Çikago), të cilit, pa plotësuar asnjë kriter apo rregullore, i është vazhduar edhe mandati i tretë.

## Rritje në prodhimtarinë industriale

Shkup, 27 prill - Prodhimtaria industriale në tre muajt e parë të vitit shënon rritje prej 5,2 për qind në krahasim me të njëjtën periudhë gjatë vitit të kaluar, njoftoi Enti shtetëror për statistikë. Prodhimtaria industriale, ndërkaq, në muajin mars të këtij viti në krahasim me marsin e vitit të kaluar shënon rritje prej 4,6 për qind. Shikuar nëpër sektorë, prodhimtaria industriale në sektorin Minierë dhe nxjerrje të gurit në mars të vitit 2018, në lidhje me marsin e vitit 2017, shënon ulje prej 5,4 për qind në sektorin Industria e përpunimit shënon rritje prej 2,6 për qind, ndërsa në sektorin Furnizim me energji elektrike, gaz, avull dhe klimatizim rritje prej 33,1 për qind. Rritja në sektorin Përpunim i industrisë është rezultat, para së gjithash,, i prodhimtarisë së rritur në prodhimtarinë e prodhimeve të duhanit, të veshjeve, të prodhimeve themelore farmceutike dhe preparateve farmaceutike, të prodhimeve metale të fabrikuara, përveç makinave dhe pajisjeve, të pajisjes elektrike, Prodhimtarisë së automjeteve motorike, rimorkiove dhe gjysmë-rimorkiove dhe prodhimtari të mobiljeve.

## Vjet në vendet e tyre të punës kanë vdekur 24 persona

*Shkup, 27 prill* - Vendet e punës në Maqedoni edhe më tutje kanë viktima. Vetëm vitin e kaluar në vendin e tyre të punës kanë humbur jetën 24 persona. Duhet të ngrihet vetëdija për siguri dhe mbrojtje gjatë punës, por edhe të përparohet dakordimi kolektiv në këtë segment, ishte thënë para konferencës së djeshme në LSM, me rastin e Ditës Botërore për Siguri dhe Shëndet gjatë punës, 28 Prill. Më të rrezikshme, ende, janë vendet e punës në bujqësi, veçanërisht prodhuesit individualë, ndërsa pastaj punëtorët ndërtimorë dhe të punësuarit në metalurgjinë e zezë. "Më mirë është të bisedojmë për sigurinë dhe shëndetin, se sa t'i numërojmë të vdekurit në vendet e punës. Kushtet në punë duhet të jenë njerëzore, ndërsa vendet e punës të përshtatshme me njerëzit", deklaroi kryetari i Shoqatës së Maqedonisë për siguri dhe shëndet gjatë punës", Milan Petkovski. Sipas drejtorit të Inspektoratit të punës Alajdin Havziu, mesatarja e rasteve të vdekjes në vendin e punës është 10 deri në 17 në vit", ndërsa të lënduar rreth 400. "Inspektorati i punës gjatë vitit ka kryer të paktën 30.000 kontrolle", theksoi Havziu.

SKANDALI ME PUBLIKIMET SHKENCORE

# MAQEDONIA PJESË E REVISTAVE PSEUDOSHKENCORE

Pjesë e investigimit të dr.Mukës për revistat pseudoshkencore është edhe "BANTAO Jurnal" me seli në Shkup. Kjo revistë del dy herë në vit, në gjuhën angleze, ndërsa në ekipin redaktorial ka emra nga Maqedonia, Turqia, Serbia dhe Greqia, por që faktorin e impaktit e ka zero. Pavarësisht kësaj, një numër i madh i profesorëve dhe mjekëve shqiptarë kanë publikimet e tyre në revista të tilla




Koha Laura PAPRANIKU

*Shkup, 27 prill* - Investigimi i revistave gjoja shkencore, ku falë botimit të punimeve të tyre janë avancuar dhe kanë bërë karrierë akademike një numër i konsiderueshëm profesorësh, dekanësh por edhe rektorë të universiteteve të ndryshme, nuk ka lënë jashtë skandalit as Maqedoninë.

Në hulumtimin "Pseudoakademia dhe pazaret me tituj shkencorë në Mjekësi", që ka realizuar së fundmi dr.Taulant Muka në Shqipëri, demaskoi një numër të revistave shkencore, të cilat nuk kanë asgjë të përbashkët me shkencën. E keqja qëndron në atë se pavarësisht irelevancës shkencore të këtyre revistave, publikimet në to kanë shërbyer që shumë persona të marrin thirrjet akademike, pasi në ligjet e arsimit të lartë prej vitesh si në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi dhe gjetiu, kërkohet publikimi në revista shkencore i të paktën tre, pesë apo shtatë punimeve. Vendosja e këtij kriteri, natyrisht që është bërë me qëllim të dhënies peshë të komponentës kërkimore-shkencore në institucionet e arsimit të lartë, pra si një standard i ri, i cili nuk mund të arrihet aq lehtë. Por, ky kriter ligjor po u kthehet si "boomerang" sistemeve tona arsimore, pasi në ndërkohë kanë lindur edhe revista pa asnjë relevancë shkencore, të cilat do të shërbejnë për të manipuluar standardin.

Një prej këtyre revistave gjoja shkencore, por me karakter ndërkombëtar, pjesë e investigimit të dr. Mukës është edhe ajo me seli në Shkup. Bëhet fjalë për revistën "BANTAO Jurnal" e cila del dy herë në vit, në gjuhën angleze, kryeredaktor i së cilës është neurologu Goce Spasovski, i cili sikurse qëndron në vebfaqen e revistës në fjalë, është nga "University Department of Nephrology, Medical Faculty, Skopje, Macedonia". Redaktori menaxher është nga Bullgaria, në Bordin redaktorial ka emra Kroacia dhe Sllovenia, ndërsa ekipi redaktorial zgjerohet dhe me emra nga Turqia, Serbia e Greqia. "BANTAO Jurnal", sigurisht se nuk është e vetmja revistë me pretendime shkencore në Maqedoni, por ishte bërë pjesë e investigimit bashkë me revistat "International Journal of Medical Science and Clinical Intervention"dhe "Merit Research Journal of Medicine and Medical Sciences" me qendër në Indi dhe "Medical Archives" me qendër ne Bosnjë. Paralelisht këtyre revistave që rezultuan pseudoshkencore, investigimi i dr.Mukës ka përfshirë edhe revistën prestigjioze të Organizatës Evropiane të Diabetit "Diabetologia" me seli në Bristol të Anglisë. Dallimi është se derisa kjo e fundit kishte refuzuar publikimin brenda 24 orëve, revistat e Indisë, Bosnjës dhe Maqedonisë kanë pranuar pa asnjë hezitim të publikojnë punimin për të cilin vetë dr.Muka thotë se qëllimisht ka plasuar të dhëna kontradiktore, përqindje që asnjëherë nuk korrespondojnë në total me 100-shin dhe sajesa të ngjashme që nuk kanë lidhje me shkencën. Mirëpo, të gatshme të publikojnë gjithçka vetëm në llogari të shumave financiare, të cilat duhet të paguajnë autorët. Kuptohet duke mos qenë të vetmit që operojnë në tregun e nevojave dhe kërkesave akademike, është krijuar një hapësirë manipulimi dhe mashtrimi në nivele të larta akademike duke i paraqitur punimet e publikuara nëpër revista të këtilla shkencore si arritje të lartë, duke u pajisur në të njëjtën kohë me tituj dhe pozita të larta akademike. Publikimi i rezultateve të investigimit "Pseudoakademia dhe pazaret me tituj shkencorë në Mjekësi", ka hedhur dyshime të forta mbi vërtetësinë e shumë titujve akademikë të profesorëve shqiptarë në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni, nisur edhe nga fakti se jo pak herë këta të fundit paraqesin si dëshmi të arritjeve shkencore edhe publikime nëpër revista që menaxhohen nga individ/kompani, sikurse është "Medical Archives" e Bosnjës. Për më tepër, kjo revistë menaxhon edhe dy revista tjera: "Materia socio-medica" dhe "Acta Informatica Medica" dhe që të tria e kanë zero faktorin e impaktit, i cili shërben për matjen e rëndësisë dhe rangimit të revistave shkencore. Dr.Muka kishte investiguar vetëm në fushim e mjekësisë.

Ndërsa arsyeja që kishte në fokus të hulumtimit revistat e lartpërmendura kishte të bëjë me të dhënat se në ato revista ishin realizuar publikimet shkencore të pjesës më të madhe të profesorëve dhe mjekëve shqiptarë. Në listën e gjatë të emrave nuk mungojnë edhe mjekë nga Maqedonia.

## Vendimi për ekstradimin e Grujevskit dhe Boshkovskit më 18 maj

Athinë, 26 prill - Pas një ore pas dyerve të mbyllura dhe dëshmisë së dhënë, në Gjykatën Supreme në Athinë mbaroi gjykimi për ankesën e parashtruar për ekstradim të Goran Grujevskit dhe Nikolla Boshkovskit. Vendimi i gjykatës do të kumtohet më 18 maj, lajmëron korrespondentja e MIA-s. Me kërkesë të avokatëve, salla gjyqësore ishte zbrazur. Në sallë, mbetën vetëm Grujevski dhe Boshkovski, ekipi i avokatëve, dy përkthyesit dhe sigurimi policor, por edhe avokati nga Maqedonia, i cili është dëshmitar në këtë rast. Avokatët, si edhe në seancat e kaluara, kërkuan që gjykimi të jetë me dyer të mbyllura, sepse sipas tyre, bëhet fjalë për ndjekje politike, ndërsa Grujevski dhe Boshkovski janë të akuzuar për krim politik (gjë për të cilën ata si mbrojtje nuk pajtohen). Vlerësojnë se në dëshminë që do ta japin, ka çështje të cilat janë të besueshme, të cilat nuk janë për opinionin. Siguria e klientëve të tyre ishte edhe një nga argumentet e avokatëve. Për Grujevskin dhe Boshkovskin në Greqi, siç njoftoi MIA, zhvillohen tre procese të veçanta, të cilat nuk ndërlidhen me njëri-tjetrin. Njëri proces është për falsifikimin e pasaportave, me të cilat janë kapur në aeroportin e Selanikut, gjykimi pas tre shtyrjeve do të mbahet më 17 maj të këtij viti. Rasti tjetër është për kërkesën e parashtruar për azil më 29 nëntor të vitit të kaluar. Marrja në pyetje para komisionit për azil në Selanik u caktua për më 15 shkurt, por ishte shtyrë, për shkak se ata veçmë ishin në Athinë. Rasti i tretë është për kërkesën e Maqedonisë për ekstradim, për të cilin Këshilli i Gjykatësve në Selanik, më 5 janar vendosi që Nikolla Boshkovski dhe Goran Grujevskit të ekstradohen në Maqedoni dhe menjëherë më pas avokatët e tyre parashtruan ankesë kundër vendimit të gjykatës, që rastin ta shqyrtojë Gjykata Supreme në Athinë.

DITA BOTËRORE PËR SIGURI DHE SHËNDET GJATË PUNËS

## Bashkë për mjedis të shëndetshëm të punës

*Shkup, 27 prill* - Mbrojtja e fuqisë së re punëtore është motoja e sivjetme në shënimin e Ditës Botërore për Mbrojtje dhe Siguri në Punë, me qëllim që të sigurohet fuqi pune e shëndoshë dhe produktive. "Punojmë intensivisht në zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve lidhur me këtë çështje, por u bëj thirrje edhe punëtorëve edhe punëdhënësve të përmbahen ndaj atyre sepse nëse gjenerata e re nuk është e shëndoshë, atëherë ne nuk do të kemi fuqi të shëndoshë punëtore e cila do të jetë në interes edhe për punëdhënësit, por edhe për shtetin", ka thënë ministrja e Punës dhe Politikës Sociale, Mila Carovska në ngjarjen "Gjeneratë e sigurt dhe e shëndoshë" me rastin e Ditës Botërore për Siguri dhe Shëndet gjatë Punës. Të gjithë ne, shtoi Carovska, së bashku e krijuam këtë mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm të punës për të pasur punonjës më produktiv, sepse pa ta nuk mund të kemi rritje dhe zhvillim të këtij shteti. Informoi se për parandalimin e lëndimeve dhe vdekjes në vendet e punës janë bërë më shumë se 7.400 mbikëqyrje të rregullta inspektuese dhe 3.500 të jashtëzakonshme. Shënimin e Ditës Botërore për Siguri dhe Shëndet në Punë e organizon Këshilli kombëtar për siguri dhe shëndet në punë, si trup këshillëdhënës. Kryetarja e Këshillit, Jovanka Karaxhinska Bislimovska thekson se pjesëtarët e sektorëve, organizatave dhe institucioneve të ndryshme në domenin e të cilëve është kujdesi për shëndetin dhe sigurinë e punëtorëve sot do të bisedojnë për sigurinë e punonjësve të rinj nga mosha 15 deri në 24 vjeçare. "Do të bisedojmë si ta përmirësojmë dhe avancojmë sigurinë dhe shëndetin e punonjësve të rinj me qëllim edhe në të ardhmen të kemi fuqi të shëndoshë dhe produktive të punës, por edhe në çrrënjosjen e punës së fëmijëve", tha Karaxhinska Bislimovska. Shtoi se aktivitetet për realizimin e qëllimeve për mbrojtjen e punonjësve të rinj janë pjesë e Strategjisë të sjella vitin e kaluar në të cilën, theksoi, punëtorët e rinj kanë vend të veçantë. Sipas të dhënave zyrtare vjet ka pasur 14 raste të vdekjes, në vitin 2016 - 15 dhe në vitin 2015 - 24 raste të vdekjes në vendin e punës.

REPUBLIKA E MAQEDONISË
AGJENCIA E ADMINISTRATËS

Në bazë të nenit 35 të Ligjit të Nëpunësve Administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 27/14, 199/14, 48/15, 154/15, 5/16, 142/16 dhe 11/18) dhe Rregullores së mënyrës së zbatimit të procedurës për punësim të nëpunësve administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 27/18), lidhur me nenin 20-g të Ligjit të punësuarve në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 27/14, 199/14, 27/16 dhe 35/18) dhe Rregullores së elementeve të obligueshme të shpalljes publike të plotësimit të vendit të punës në sektorin publik përmes punësimit dhe fletëparaqitjes për punësim, si dhe të formës, përmbajtjes dhe mënyrës së mbajtjes së regjistrit të personave që kanë dhënë të dhëna të rrejshme gjatë punësimit në sektorin publik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 34/15), Agjencia e Administratës publikon

## SHPALLJE PUBLIKE NUMËR – 38/2018

për punësimin e 7 nëpunësve shtetëror nga grupi I, nëngrupi I në „Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës "për vendet e punës në vijim:

1. UPR0101B03000 Ndihmës udhëheqës i sektorit për arsim të mesëm, arsim të të rriturve dhe arsim të përjetshëm — 1 realizues(ë)

### Kushtet e përgjithshme:
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

### Kushtet e posaçme:
- niveli i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi, sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, matematikë, gjeografi ose informatikë
- më së paku 4 (katër) vjet përvojë pune në profesion, ku së paku 1 (një) vit në vend pune në sektorin publik, përkatësisht së paku 6 (gjashtë) vjet përvojë pune në profesion, prej të cilave së paku 2 (dy) vjet në vend pune udhëheqës në sektorin privat

**Kompetencat e përgjithshme:**
- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- punë me të tjerë/punë ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara
- udhëheqje; dhe
- menaxhim financiar

**Kompetenca të posaçme:**
- çertifikatë e dhënies së provimit të udhëheqjes administrative
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frengjisht, gjermanisht)
- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë

### Orari i punës :
- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 07:30 - 15:30
- Përshkrimi i orarit të punës: orari i punës duke filluar në mes orës 7:30 dhe 8:30 dhe përfundimi i të njëjtit në mes orës 15:30 dhe 16:30

Rroga neto: 31.331,00 denarë

**VËREJTJE:** Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.

2. UPR0101G04000 Referent i pavarur për organizim në arsimin e mesëm dhe zhvillimin e karrierës, Njësia për financim të arsimit të mesëm dhe zhvillimin e karrierës, Sektori për arsim të mesëm, arsim të të rriturve dhe arsim të përjetshëm — 1 realizues(ë)

### Kushtet e përgjithshme:
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

### Kushtet e posaçme:
- niveli i kualifikimeve VA ose niveli i kualifikimeve IV, sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 ose 240 kredi sipas ECVET ose SMKAP ose së paku arsim të lartë ose të mesëm, gjimnaz ose arsim i mesëm profesional:teknik ekonomik
- me ose pa përvojë pune

**Kompetencat e përgjithshme:**
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- puna me të tjerë/puna ekipore
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar

**Kompetenca të posaçme:**
- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frengjisht, gjermanisht)

### Orari i punës :
- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 07:30 - 15:30
- Përshkrimi i orarit të punës: orari i punës duke filluar në mes orës 7:30 dhe 8:30 dhe përfundimi i të njëjtit në mes orës 15:30 dhe 16:30

Rroga neto: 13.166,00 denarë

**VËREJTJE:** Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.

3. UPR0101B02000 Ndihmës i sektorit për shkencë dhe risitë — 1 realizues(ë)

### Kushtet e përgjithshme:
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

### Kushtet e posaçme:
- niveli i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi, sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, biologji, arsim dhe shkenca juridike
- më së paku 5 (pesë) vjet përvojë pune në profesion, ku së paku 2 (dy) vjet udhëheqës në vend pune në sektorin publik, përkatësisht së paku 8 (tetë) vjet përvojë pune në profesion, prej të cilave së paku 3 (tre) vjet në vend pune udhëheqës në sektorin privat

**Kompetencat e përgjithshme:**
- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- punë me të tjerë/punë ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara
- udhëheqje; dhe
- menaxhim financiar

**Kompetenca të posaçme:**
- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- çertifikatë e dhënies së provimit të udhëheqjes administrative
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frengjisht, gjermanisht)

### Orari i punës :
- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 07:30 - 15:30
- Përshkrimi i orarit të punës: orari i punës duke filluar në mes orës 7:30 dhe 8:30 dhe përfundimi i të njëjtit në mes orës 15:30 dhe 16:30

Rroga neto: 35.873,00 denarë

**VËREJTJE:** Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Shqiptar(e) 1.

4. UPR0101B04000 Udhëheqës i njësisë për koordinim të furnizimeve publike, Sektori për organizimin e punëve të ministrisë — 1 realizues(ë)

### Kushtet e përgjithshme:
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

### Kushtet e posaçme:
- niveli i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi, sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, shkenca juridike
- më së paku 4 (katër) vjet përvojë pune në profesion, ku së paku 1 (një) vit në vend pune në sektorin publik, përkatësisht së paku 6 (gjashtë) vjet përvojë pune në profesion, prej të cilave së paku 2 (dy) vjet në vend pune udhëheqës në sektorin privat

**Kompetencat e përgjithshme:**
- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- punë me të tjerë/punë ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara
- udhëheqje; dhe
- menaxhim financiar

**Kompetenca të posaçme:**
- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- çertifikatë e dhënies së provimit të udhëheqjes administrative
- njohjen aktive të një prej tre gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frengjisht, gjermanisht)

### Orari i punës :
- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 08:30 - 16:30
- Përshkrimi i orarit të punës: orari i punës duke filluar në mes orës 7:30 dhe 8:30 dhe përfundimi i të njëjtit në mes orës 15:30 dhe 16:30

Rroga neto: 28.303,00 denarë

**VËREJTJE:** Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.

5. UPR0101V02000 Bashkëpunëtor i lartë për çështje pronësore - juridike të ministrisë, Njësia për jurisprudencë, çështje pronësore - juridike dhe administrative, Sektori për çështje normative - juridike — 1 realizues(ë)

### Kushtet e përgjithshme:
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

### Kushtet e posaçme:
- niveli i kualifikimeve VI B sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, shkenca juridike
- së paku 2 (dy) vjet përvojë pune në profesion
- të dhënë provimin e jurisprudencës

**Kompetencat e përgjithshme:**
- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- puna me të tjerë/puna ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar

**Kompetenca të posaçme:**
- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frengjisht, gjermanisht)

### Orari i punës :
- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 07:30 - 15:30
- Përshkrimi i orarit të punës: orari i punës duke filluar në mes orës 7:30 dhe 8:30 dhe përfundimi i të njëjtit në mes orës 15:30 dhe 16:30

Rroga neto: 23.257,00 denarë

**VËREJTJE:** Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.

6. UPR0101B03000 Ndihmës udhëheqës i sektorit për libra dhe këshilla pedagogjike, Shërbimi pedagogjik — 1 realizues(ë)

### Kushtet e përgjithshme:
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

### Kushtet e posaçme:
- niveli i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi, sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, shkenca juridike, shkenca ekonomike ose psikologji
- më së paku 4 (katër) vjet përvojë pune në profesion, ku së paku 1 (një) vit në vend pune në sektorin publik, përkatësisht së paku 6 (gjashtë) vjet përvojë pune në profesion, prej të cilave së paku 2 (dy) vjet në vend pune udhëheqës në sektorin privat

**Kompetencat e përgjithshme:**
- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- punë me të tjerë/punë ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara
- udhëheqje; dhe
- menaxhim financiar

**Kompetenca të posaçme:**
- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- çertifikatë e dhënies së provimit të udhëheqjes administrative
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frengjisht, gjermanisht)

### Orari i punës :
- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 07:30 - 15:30
- Përshkrimi i orarit të punës: orari i punës duke filluar në mes orës 7:30 dhe 8:30 dhe përfundimi i të njëjtit në mes orës 15:30 dhe 16:30

Rroga neto: 31.331,00 denarë

**VËREJTJE:** Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Shqiptar(e) 1.

7. UPR0101B04000 Udhëheqës për miratimin e librave, Sektori për libra dhe këshilla pedagogjike, Shërbimi pedagogjik — 1 realizues(ë)

### Kushtet e përgjithshme:
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

### Kushtet e posaçme:
- niveli i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi, sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, shkenca juridike, shkenca ekonomike ose arsim
- më së paku 4 (katër) vjet përvojë pune në profesion, ku së paku 1 (një) vit në vend pune në sektorin publik, përkatësisht së paku 6 (gjashtë) vjet përvojë pune në profesion, prej të cilave së paku 2 (dy) vjet në vend pune udhëheqës në sektorin privat

**Kompetencat e përgjithshme:**
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara
- udhëheqje; dhe
- menaxhim financiar
- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- punë me të tjerë/punë ekipore

**Kompetenca të posaçme:**
- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- çertifikatë e dhënies së provimit të udhëheqjes administrative
- njohjen aktive të një prej tre gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frengjisht, gjermanisht)

### Orari i punës :
- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 07:30 - 15:30
- Përshkrimi i orarit të punës: orari i punës duke filluar në mes orës 7:30 dhe 8:30 dhe përfundimi i të njëjtit në mes orës 15:30 dhe 16:30

Rroga neto: 28.303,00 denarë

**VËREJTJE:** Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.

Kushtet e lartpërmendura në shpallje kandidatët duhet t'i plotësojnë në momentin e aplikimit në formë elektronike nëpërmjet profilit të përdoruesit të krijuar në faqen e internetit të Agjencisë së Administratës.

Afati i aplikimit zgjatë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e publikimit të shpalljes. Pas mbarimit të afatit për aplikim, shpallja do të jetë e larguar nga faqja e internetit e Agjencisë.

Pas kalimit të afatit të aplikimit, shpallja do të jetë e hequr nga faqja e internetit e Agjencisë.

Kandidatëve u kërkohet fletëparaqitjen ta plotësojnë në tërësi, të jenë precizë dhe të japin të dhëna të sakta. Kandidatët e paraqitur në shpalljen publike në faqen e internetit të Agjencisë së administratës do të informohen, për kohën dhe vendin e mbajtjes së çdo faze të ardhshme të procedurës për selektim të nëpunësit administrativ.

Faza e 1 – të: selektimi administrativ realizohet në një afat prej 15 ditësh pas mbarimit të shpalljes së publikuar.

Faza e 2 – të: provimi i nëpunësit administrativ realizohet në një afat jo më të shkurtër se 10, dhe jo më të gjatë se 30 ditë pas mbarimit të fazës së 1 – rë. Ai incizohet dhe emetohet drejtpërdrejtë në faqen e internetit të Agjencisë së administratës.

Faza e 3 – të: kontrollimi i vërtetësisë së provave dhe intervista realizohet në një afat prej 10 ditësh pas mbarimit të fazës së 2 – të.

PROBLEMET E INSTITUCIONEVE SHËNDETËSORE

# "TERAPI" QË MUNGON JANË SPECIALISTËT

**Spitalet dhe ordinancat në Maqedoni vuajnë mungesën kadrovike të specializuar, ndërkohë që Ministria e Shëndetësisë në bazë të analizës dhe nevojave, siguron se do të planifikojë punësime të reja. Kërkohet edhe një Odë e motrave medicianale**



Koha Delvina KËRLUKU

*Shkup, 27 prill* -Nuk është i paktë numri i infermierëve dhe mjekëve, të cilët në mungesë të perspektivës në vendlindje, po detyrohen të dalin jashtë vendit, ku edhe po gjejnë perspektivë dhe trajtim më dinjitoz. Për rrjedhojë shumë spitale dhe klinika në Maqedoni nuk po arrijnë të plotësojnë vendet e zbrazëta me kuadro të përgatitur. Njëri prej tyre është edhe Spitali i sëmundjeve të mushkërive tek fëmijët në Kozle, Shkup, i cili ka nevojën për specialistë të pediatrisë, për infermierë, laborantë, teknikë medicinal etj.

"Për momentin ne kemi nevojë për punësimin e 20 infermiereve, tre mjekëve pediatër, tre mjekëve të praktikës së përgjithshëm, disa teknikëve mjekësorë, laborantëve dhe të punonjësve administrativë. Meqë spitali ynë ka specifikat e veta, ne kemi nevojë edhe për pajisje moderne, dhe këtë arritëm ta sigurojmë përmes donacioneve", thotë për gazetën KOHA, Angelço Andonovski, drejtor i Spitalit të sëmundjeve të mushkërive të fëmijëve, në Kozle.

Po ashtu, edhe spitali i Tetovës ka mungesë të kuadrit të mjekëve, ndërkohë që këtë shqetësim e ngrenë edhe klinika të tjera brenda vendit, por, edhe shoqatat e motrave medicinale, teknikëve, mamive dhe stomatologeve.

Drejtori i spitalit të Tetovës, dr. Florim Besimi, thotë për gazetën tonë se ka mungesë të kuadrit mjekësor në këtë spital dhe se janë në pritje të lejes nga Ministria e Shëndetësisë, e Financave dhe Fondi i Sigurimit shëndetësor, për hapjen e konkursit për pranimin e kuadrove të munguar.

"Në spitalin tonë kemi nevojë për motra medicinal dhe për mjek, kurse ndërkohë presim kthimin e 70 specialistëve, të cilët do të plotësojnë boshllëkun në disa reparte të spitalit, sidomos në disa drejtime që kanë munguar deri më tani", shprehet dr. Besimi, i cili është optimist se ky problem do të tejkalohet pasi të hapet konkursi.

Një fokusim mbi problemet që kanë punonjësit e shëndetësisë, vjen edhe nga Gostivari. Shoqata e motrave medicinale, teknikëve, mamive dhe stomatologeve të këtij qyteti ka ngritur zërin për rritjen e pagave te mjekët dhe infermierët, por edhe për ngritjen e cilësisë në punë. Nga kjo shoqatë kërkojnë që në Maqedoni të ketë një odë të motrave medicianale në suaza ligjore.

"Problemi kyç sipas mendimit tim është çështja financiare, si dhe rregullimit jo adekuat të kualifikimit të kuadrit mjekësor, pra të shkollimit të mesëm dhe atij të lartë. Ne si shoqatë bëjmë përpjekje që të mos na ikin infermierët jashtë vendi, duke favorizuar koeficientin e personelit. Është më se e natyrshme që 300 euro page mujore s'janë asgjë për infermierët ose 500 euro - për mjekët. Ne kemi arrit që në nivel republikan të mblidhemi 7 shoqata, duke përfshirë Shkupin, Tetovën, Gostivarin, Strugën, Dibrën e me radhë dhe të formojmë unionin e shoqatave, me ç'rast kemi mbajtur takime edhe me sindikatën e mjekëve. Kërkesat tona janë: rritja e pagave dhe rritja e cilësisë ose profesionalizmit", thotë për gazetën KOHA, dr.Xhevat Saliu, nga Shoqata e motrave medicinale, teknikëve, mamive dhe stomatologeve, për gazetën "Koha". Edhe në Ministrinë e Shëndetësisë, vërehen mungesa të kuadrit, ku sipas kësaj ministrie planifikohen të punësohen punëtorë të rinj.

Sa i përket punësimeve dhe angazhimeve të reja, Ministria e Shëndetësisë bën të ditur se është në proces procedura për përgatitjen e sistematizimit të ri të vendeve të punës dhe në bazë të analizës dhe nevojave do të planifikohen punësime të reja.

HULUMTIM I RI PËR MALIN E FAMSHËM TË POLLOGUT

# Mali Sharr të shpallet Park Kombëtar

Koha Urim HASIPI

*Tetovë, 27 prill* - Krijimi i një vizioni të përbashkët për Malin Sharr ishte tema e takimit të radhës të platformës "Miqtë e Sharrit" që u mbajt në Tearcë. Në tribunën në Tearcë është theksuar nevoja për krijimin e një trupi këshillues për Malin Sharr, që duhet të përfshijë të gjitha palët e interesuara nga gjashtë komunat e Pollogut. Ky ishte takimi i pestë nga gjashtë gjithsej që mbahen në rajonin e Malit Sharr, ndërsa mbahen në kuadër të projektit dhe aktiviteteve të Platformës Miqtë e Sharrit, të përkrahur nga Mekanizmi IPA - 2 dhe zyra e GIZ-it në Shkup. Të pranishëm ishin përfaqësues të komunës, nga bashkësitë lokale, shoqata joqeveritare, mbledhës të frutave të malit, blegtorë, gjuetarë, nga sektori I biznesit dhe shoqata malore. Përndryshe Shoqata Ekologjike Maqedonase dhe platforma "Miqtë e Sharrit" gjatë vitit 2015 kishte realizuar një anketë me qytetarët për shpalljen e Malit Sharr park kombëtar. Sipas kësaj ankete,



**Mali Sharr pothuajse në të gjithë pjesët pritet në mënyrë të pamëshirshme, ndërsa kjo, sipas ekspertëve të ekologjisë, do të ndikojë keq në të ardhmen, pasi vetë fshatrat do të jenë në rrezik nga erozioni i dheut**

83 për qind e banorëve të cilët jetojnë në komunat përgjatë Malit Sharr dëshirojnë që i njëjti të shpallet Park Kombëtarë. Hulumtimi është bërë në 30 vendbanime në Komunat Jegunocë, Tearcë, Tetovë, Gostivar, Bogovinë dhe Vrapçisht me 410 anketues të moshës 18 deri në 60 vjeçare. Sipas anëtarëve të platformës "Miqtë e Sharrit", ky hulumtim ka vërtetuar edhe një nga problemet më të mëdha që është prerja ilegale e druve.

"Në pjesën më të madhe të pyjeve qytetarët janë përgjigjur me shqetësim për shfrytëzimin e pyjeve. Sipas hulumtimit, rreth 63 për qind e të anketuarve vlerësojnë se drunjtë në Malin Sharr shfrytëzohen në masë të madhe. Natyra e pyjeve nuk është mbrojtur janë shprehur rreth 79 për qind e atyre që janë anketuar", thonë organizatorët e kyçur në aktivitetet për shpalljen e Malit Sharr si Park Kombëtar. Nga Shoqata Ekologjike maqedonase theksojnë se nëse Mali Sharr shpallet park kombëtar, atëherë kjo do të ndikojë edhe në rritjen e numrit të turizmit. "Bashkërisht me parkun ekzistues kombëtar në pjesën e Kosovës, në këtë mënyrë mund të arrijmë që të krijojmë një rajon të mbrojtur nga i cili mund të përfitojë popullata vendore përmes zhvillimit të turizmit dhe në këtë drejtim mund të mbrohet Flora dhe Fauna që është unikate në Malin Sharr", thonë nga Shoqata Ekologjike maqedonase. Vendimin përfundimtar do ta sjell Qeveria pasi të jenë bërë të gjitha studimet dhe përgatitjet e nevojshme.

Ndryshe, Mali Sharr pothuajse në të gjithë pjesët pritet në mënyrë të pamëshirshme, ndërsa kjo sipas ekspertëve të Ekologjisë do të ndikojë keq në të ardhmen, pasi që vetë fshatrat do të jenë në rrezik nga erozioni i dheut dhe në këtë drejtim vetëm Parku Kombëtar do të shpëtonte Sharrin nga shkatërrimi i tij. Pas shpalljes së Malit Sharr si park nacional, ky rajon do të ketë shumë beneficione pohojnë njerëz të cilët janë të kyçur në iniciativën për shpalljen Park nacional të Malit Sharr.



# Na e ktheni 2 Majin!

*Nga*
**Daut DAUTI**

Ky vikend rastis të jetë para Një Majit, festës së madhe punëtore. Ditës kur punëtorët e Çikagos, para më shumë se një shekulli(1886), kanë kërkuar të drejtat e tyre, orar të caktuar, status social(siguri) në kushte të një kapitalizmi të egër ku në mënyrë të vrazhdë është eksploatuar djersa e punëtorëve. Greva dhe protestat e organizuara nga sindikatat kanë zgjatur me muaj dhe janë përshkallëzuar ato katër-pesë ditë të fillimit të majit, sepse janë shfrytëzuar nga shumë elemente anarkiste, gjë që për pasojë ka pasur që një kauzë e drejtë është shndërruar në përleshje të përgjakshme. Së pari kanë rënë viktimë disa punëtorë, e më pas, anarkistët i kanë thirr punëtorët që të armatosen dhe gjatë përleshjeve janë vrarë shumë policë. Katër anarkistë të dyshuar për dhunën, një vit më vonë janë dënuar me vdekje dhe ekzekutuar...

Me pak fjalë, kjo është ajo që e lidhë ditën që punëtorët e festojnë në gjithë botën dhe pas kongresit të parë të Internacionales së dytë, më 1989, vendoset që Një Maji të jetë festë e përbashkët në të gjitha vendet që klasa punëtore do të manifestojë unitet për kërkesat e veta dhe solidaritetit klasor. Në kujtim të viktimave që ranë për më shumë të drejta, në shumë vende të botës bëhen marshime tradicionale ose protesta të sindikatave punëtore. Sivjet, pas një heshtje disa vjeçare, edhe sindikatat e Maqedonisë do t'u rikthehen protestave të 1 Majit, si akt simbolik.

Të drejtat e klasës punëtore do të jenë edhe strumbullari i çdo lëvizjeje masash ose çdo revolucioni të nxitur nga forcat e majta në gjithë botën. Lufta për të drejta të punëtorëve, ka mbetur si një parim universal gjer në ditët e sodit. Por, kur e festojmë 1 Majin, kontekstet historike për shumëkënd janë të largëta dhe na ka mbetur vetëm festimi, pushimi si "një dhuratë e merituar" shoqërore për punëtorët, por dhe për të gjithë qytetarët. Dhe këtu, pra, desha të ndërlidhem, me atë që si gjë të bukur e kujtojmë nga sistemi i kaluar, sepse më shumë se Një Majin, e kujtojmë Dy Majin, ditën tradicionale për piknik, që ishte pjesë e festimit, e të cilin, ndërkohë, VMRO-DPMNE-ja na e hoqi duke e kompensuar atë me festa të tjera, kryesisht fetare ose kombëtare të dyshimta, duke e ngarkuar kalendarin e festave si në rrallë vend tjetër. Kuptohet, respektimi i ndjenjave të besimtarëve dhe të ditëve të rëndësishme nga kalendari fetar nuk është gjë e keqe, përkundrazi. Mirëpo, sikur u humbën kriteret dhe u bënë zgjidhje jo të duhura, të cilat gjenerojnë probleme praktike. Një nga përfitimet e demokracisë është pikërisht respektimi i lirive të predikimit fetar, i cili në ish-shtetin e përbashkët të Jugosllavisë së Titos, nuk ka qenë aq i rrezikuar(në dallim nga vende socialiste të tjera, si në rastin më drastik të Shqipërisë ku ka qenë e ndaluar feja), mirëpo, "feja ka qenë e ndarë prej shtetit" dhe asnjë festë fetare nuk ka qenë festë shtetërore dhe me rënien e sistemit komunist, kjo padrejtësi u korrigjua. Kërshëndellat, Pashkët (ortodokse e katolike) dhe Fitër Barjami e Kurban Bajrami i myslimanëve, ose festat kryesore të romëve(Shëngjergji), hebrenjve...etj, u bënë festa. Mirëpo, këtu u bë një mishmash, sepse përveç festave kryesore fetare, të cilat u bënë festa shtetërore, në kalendar u futën edhe të tjera, "më të vogla". Që t'i iket ditëve të shumta të pushimit, ishte vendosur që disa nga këto festa të vlejnë vetëm për pjesëtarët e një komuniteti fetar. Kësisoj, fituam festa fetare që vlenin për të gjithë qytetarët si ditë jo pune(Pashkët, Kërshëndellat dhe Fitër Bajrami) dhe festat tjera, vetëm për pjesëtarët e një komuniteti fetar, shumicës së të cilave shumëkush as ua di emrin e kuptimin dhe rëndësinë.

Praktika shumë vjeçare e festimit ka nxjerrë në pah gjithë defektin e këtij festimi asimetrik. Më saktë, janë shkaktuar çrregullime në punën e administratës dhe subjekteve ekonomike, sepse, përderisa besimtarët e krishterë festojnë dhe nuk dalin në punë, punët e tyre duhet t'i kryejnë pjesëtarë të komunitetit tjetër. Ose, edhe në rast kur festojnë myslimanët, që janë komuniteti fetar pothuajse i madh aq sa ai ortodoks, punët e tyre duhet t'i kryejnë besimtarët ortodoksë dhe të tjerë. Çka do të thotë kjo, mjafton të shkoni ato ditë nëpër institucione që të shihet sa të punësuarit vërtet i kryejnë obligimet, sa është motivi dhe kapaciteti i tyre që të kompensojnë mungesën e atyre që shteti u ka lejuar të pushojnë. Për kompanitë të mos flasim, sepse në shumë prej tyre ndoshta dhe nuk respektohen këto festa që vlejnë vetëm për një komunitet, sepse kështu prishet ritmi i punës, pëson procesi prodhues, i tregtisë etj.

Është rast i mirë tash në prag të 1 Majit, t'ia përkujtojmë kësaj qeverie se ka nevojë për ta rishikuar kalendarin e festave, dhe jo vetëm për atë që do të parapëlqeja unë dhe shumë qytetarë të tjerë, që të kthehet 2 maji, ajo ditë tradicionale e piknikëve në natyrë dhe nëpër qendra rekreative e turistike, por më tepër, për të gjetur zgjidhje për këto festimet gjysmake që vlejnë vetëm për një komunitet fetar. Unë jam ithtar i zgjidhjes në stilin "ose-ose": ose të hiqen krejtësisht festat fetare më pak të rëndësishme, ose festat fetare ortodokse dhe myslimane nga kalendari aktual i festave të vlejnë për të gjithë qytetarët, për shkak se me to përfshihen përqindje e madhe e qytetarëve, mungesa e të cilëve ndikon në punën e administratës ose subjekteve ekonomike, ndërkaq, festat e komuniteteve më të vogla fetare(bektashiane, hebraike, katolike...), të vlejnë vetëm për ta, pasi mungesa e pjesëtarëve të këtyre komuniteteve nuk do të ndihej gjithaq, për shkak të numrit të tyre të vogël. Po kështu, do të duhej që të rishikohet edhe dita e VMRO-së si festë shtetërore, pasi po aq sa themelimi i saj ka karakter kombëtar(ajo ka qenë njëra nga lëvizjet kombëtare maqedonase), aq rëndësi ka edhe themelimi i Partisë Komuniste të Maqedonisë, që nuk shënohet, edhe pse veprimi i kësaj të dytës ka luajtur rol më të madh historik për shtetësinë e Maqedonisë! Duket paradoksale, por ashtu është nëse e shikojmë historinë e këtyre dy lëvizjeve.

Racionalizimi i festave shtetërore, është një nevojë e kahershme, sepse Maqedonia është nga vendet me numër më të madh sish dhe me model problematik për çka u fol më lartë. Më mirë të na kthehet 2 Maji dhe kur të vijë dita, të dimë ta shijojmë, pavarësisht nga fakti se atë e kanë imponuar ideologjitë majtiste(kauza e punëtorëve i përket edhe shoqërisë moderne e cila nuk është ideale në çdo gjë), se sa të kemi festa shtetërore që vlejnë vetëm për komunitete të caktuare fetare.

*(Autori është kolumnist i rregullt i gazetës KOHA)*

**Unë jam ithtar i zgjidhjes në stilin "ose-ose": ose të hiqen festat fetare (më pak të rëndësishme) krejtësisht, ose festat fetare ortodokse dhe myslimane të vlejnë për të gjithë qytetarët, për shkak se me to përfshihen përqindje e madhe e qytetarëve, mungesa e të cilëve ndikon në punën e administratës ose subjekteve ekonomike, ndërkaq, festat e komuniteteve më të vogla fetare (bektashiane, hebraike, katolike...), të vlejnë vetëm për ta, pasi mungesa e pjesëtarëve të këtyre komuniteteve nuk do të ndihej gjithaq, për shkak të numrit të tyre të vogël**

## KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS




Koha
E përditshme informative
www.koha.mk
Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi
Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovasja lok.14 - përdhesë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi:"Adria Media Ballkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e premte 27 prill | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006
Drejtor: **Lirim DULLOVI** | Kryeredaktor: **Vedat MEMEDALIU** | Redaktor përgjegjës: **Emin AZEMI** | Ndihmëskryeredaktor: **Evis HALILI** | Redaktor teknik: **Halil BERISHA**
**E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222** | Përgjegjës për distribuim: **Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221**
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve **Inter Partes** - Shkup
NPK "Koha Production" Num. i xhirollogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

# 27 Prilli, një vit më vonë...



*Nga*
Dr.Arben TARAVARI

Dje ishte data 27 prill. Si dje para 1 viti Maqedonia kaloi një ditë të rëndë, një ditë e cila ishte edhe më e vështirë për një familje dhe për një njeri, padyshim që po flas për Ziadin Selën dhe të afërmit e tij. Por duke lënë kontekstin personal të kësaj dite do të fokusohem tek rëndësia historike që 27 prilli pati për Maqedoninë dhe do guxoja të thosha gjithë Ballkanin.

Në 27 prilli para një viti rà gjysma e regjimit. Parlamenti vlonte nga britmat e protestuesve që në fakt kishin një detyrë të qartë, të sulmonin deri në eliminim fizik disa syresh nga të politikanët e ndodhur në sallën e parlamentit. Dukej se qeveria grueviste kishte vizatuar skenarin e një gjendjeje të jashtëzakonshme e cila do të paralizonte çdo lëvizje politike eventuale.

Në atë kohë ishte z.Zoran Zaev që kishte dalë në krye të grupit "poshtë qeveria" dhe ai ishte një nga të sulmuarit e 27 prillit, por dora më e rëndë e dhunës rà mbi z.Ziadin Sela, i cili në një moment të asaj maratone ankthi u shpall si i vdekur...dhe po, ai ishte shumë afër vdekjes. Pothuajse vizioni i gruevistëve po merrte jetë, Sela do të vdiste, populli do të shkonte në përleshje etnike, do kishte rast ideal për të vendosur Gjendje të Jashtëzakonshme! Por Zoti vendosi ta shpëtonte Selën dhe prej tij të vinte Zaevi sot në qeveri, të zgjidhej z.Talat Xhaferri kryeparlamentar, të futej në përdorim ligji i gjuhës shqipe, të jepej leksioni se si punohet me përkushtim në qeveri dhe se si hiqet dorë po nga kjo qeveri kur cenohet dinjiteti i popullit! Pasi nëse ditën e 27 prillit, Ziadin Sela, në një gjendje të vështirë mbijetese, do të kishte dhënë edhe më të voglin kushtrim, populli shqiptar pa dallim partie, atë natë do të hidhej në luftë!

Megjithëse në një gjendje agravante shëndetësore tek dilte nga Tempulli i Ligjeve që e kishte rrëmbyer Ziadin Selën për ta vdekur, ai porositi: edhe sikur të vdes dua që populli të rri i qetë!

Ishin këto fjalë që me shpejtësi dhe me forcën e amanetit u përhapën atë natë nga partia e Aleancës për Shqiptarët! Ziadini po ndalonte luftën! Ziadini bashkë me të gjithë mjekët, duke më përfshirë edhe mua, nuk e dinte nëse do të mbijetonte, por ai po zgjidhte Paqen për popullin e tij të lodhur nga skamja, nga urrejtja, nga konfliktet!

Ai po shembte skenarin e Gruevskit që do çonte popullin në plumb, ai po kursente gjakun e pafajshëm të shqiptarëve, maqedonasve, turqve, bullgarëve e çdokujt që jeton sot në paqe!

Nëse atë natë do të kishte pasur përleshje të cilin Sela e ndaloi, jam i sigurt që z.Zaev nuk do të ishte sot kryeministër. Meqë jemi tek z.Zaev, edhe ai në 27 prillin e një viti më parë u sulmua në parlament, atij dhe çdokujt që u godit, në mënyrë të veçantë znj.Sheqerinska që ishte prè e një gjesti të shëmtuar e të dhimbshëm të çmendurisë politike, ju uroj mos qofshin më kurrë në rrethana dhune! Kurse Ziadinit që mbeti gjallë...është edhe Heroi i Gjallë jo vetëm i shqiptarëve, por padyshim dhe i maqedonasve!

**Nuk dua të flas më se si rrodhën ngjarjet, nuk dua të tregoj se ndodhi që Ali Ahmeti u gjend prapë në krah të Zaevit, dua vetëm të përqendrohem tek 27 prilli i një viti më parë! Të gjithë e dimë se cilat ishin rrethanat që e sollën! Duket se për fat të keq asgjë nuk ndryshoi... krimi i vjetër mbyti reformistët e rinj - fatkeqësisht!**

Fakti që Ziadini atë natë qëndroi krah Zaevit për të shpallur rënien e regjimit dhe u sulmua brutalisht, nuk përbën ndonjë heroizëm të veçantë, por fakti që Ziadini u dhunua më shumë dhe gjeti forcën të ndalonte popullin të nxehur për përleshje, e bën Selën absolutisht politikanin më demokratik dhe evropian të momentit!

Nuk dua të flas më se si rrodhën ngjarjet, nuk dua të tregoj se ndodhi që Ali Ahmeti u gjend prapë në krah të Zaevit, dua vetëm të përqendrohem tek 27 prilli i një viti më parë!

Të gjithë e dimë se cilat ishin rrethanat që e sollën! Duket se për fat të keq asgjë nuk ndryshoi... krimi i vjetër mbyti reformistët e rinj - fatkeqësisht!

*(Autori është kolumnist i rregullt i gazetës KOHA)*

# Jetojmë në qytetërimin e mijëra gjërave



*Nga*
Martín CAPARRÓS

Emendova dje, pothuajse pa dashur, kur vendosa në murin e banjës së shtëpisë një varëse me autoadeziv, kallaj i pastër: as nuk e kisha idenë, as mundësinë për të patur një ide, mbi origjinën e saj. Nuk kisha mënyrë si ta dija se kush e kishte bërë, ku ishte prodhuar, si kish qenë puna dhe rrugëtimi i saj nga ndonjë qoshe e Kinës, deri tek kinezi në dyqanin tek cepi i rrugës. Ashtu sikurse pothuaj gjithçka që përdorim, ajo varëse vinte nga asgjëja, dhe kjo është diçka që as nuk na habit.

Për mijëra vite, gjërat që ne zotëronim kanë patur një histori - pak a shumë - të njohshme. Zotëruesi i një çekiçi e dinte që e kish bërë Lope, ai i dyqanit në krah, djali i Trinit, kushërirës së dajë Pedros. Tani jo: dhe pastaj, kemi kaq shumë gjëra, saqë po të njihnim historinë e secilës, nuk do të kishim kohë për të bërë gjëra të tjera.

Jetojmë në qytetërimin e mijëra gjërave. Në SHBA (ku bëjnë llogari të tilla), një studim i kohëve të fundit ka nxjerrë se në një shtëpi ka mesatarisht 300 mijë objekte, "që nga kapëset, deri tek hekuri i hekurosjes". Në Mbretërinë e Bashkuar, një fëmijë 10 vjeç ka mesatarisht 238 lodra, edhe pse luan me 10 apo 12 prej tyre. Dhe kërkimi i një kompanie sigurimesh britanike, thotë se kalojmë mesatarisht 10 minuta



në ditë duke kërkuar gjëra që humbasim: në jetë mund të jenë 200 ditë të humbura në kërkim të diçkaje. Pothuaj hiçgjë, nëse i krahasojmë me 2 mijë minutat që kalojmë duke blerë gjëra.

Kemi mijëra gjëra dhe ka miliarda njerëz që nuk kanë pothuaj asgjë: ne, 12 % e popullsisë që jeton në Evropë dhe SHBA, konsumojmë 60% të mallrave të botës, ndërkohë që 33% më të varfrit, afrikanë dhe aziatikë, konsumojnë 3%. Disa vite më parë, shkova të shkruaj për Lëvizjen "Jemi Toka", në një qoshe të Amazonës. Një grua me emrin Gorette më huazoi kasollen e saj, dhe unë besova se përshkrimi më i mirë i varfërisë, është ndoshta të rrëfesh atë që mungon. "Në kasollen e Gorettes ndodhet një thikë, katër pjata alumini, tre shishe, pesë lugë, pesë vazo tunxhi, dy enë të mbushura me ujë, tre kanaçe me qumësht pluhur, kripë dhe sheqer, një kanaçe me vaj e mbushur plot, dy të tjera të boshatisura, tre peshqirë, një kuti kartoni me ndonjë veshje, dy kalendarë me peizazhe, një copë pasqyre, dy furça, një garuzhdë, një gjysmë thesi oriz, një radio që nuk kap pothuaj asgjë, dy gazeta të lëvizjes, fletorja e shkollës, një enë plastike për të marrë ujë tek pusi, një legen plastike për të larë pjatat dhe një kukull prej rrobe me një fustan të kuq dhe kësulë të çuditshme. Këto janë zotërimet e saj në botë, bashkë me tre stola për t'u ulur, një palë sandale me gisht, një llambë vajguri dhe asgjë më shumë". *(El País)*

**Në Mbretërinë e Bashkuar, një fëmijë 10 vjeç ka mesatarisht 238 lodra, edhe pse luan me 10 apo 12 prej tyre. Dhe kërkimi i një kompanie sigurimesh britanike, thotë se kalojmë mesatarisht 10 minuta në ditë duke kërkuar gjëra që humbasim: në jetë mund të jenë 200 ditë të humbura në kërkim të diçkaje**

# HISTORIA E PANJOHUR

A mund ta kishte jetën e sigurt njeriu që vrau Esad Pashë Toptanin? Ky ankth për Avni Rustemin zgjati 3 vjet, 9 muaj e 7 ditë, kur Isuf Reçi bëri ndaj tij atë që ai vetë kishte bërë ndaj Esad Pashë Toptanit

## PSE U QËLLUA AVNI RUSTEMI DITËN KUR DO MERRTE VIZËN AMERIKANE

**Në librin "100 vrasjet më të bujshme në historinë e shtetit shqiptar 1912-2017" të Roland Qafokut listohen edhe 10 fakte për vrasjen e Avni Rustemit, por edhe 10 mistere që e shoqërojnë atë**

**10 FAKTE**

1. Avni Rustemi është i pari deputet i Parlamentit shqiptar që u vra ndërsa ushtronte mandatin
2. Të dhënat janë se autori i vrasjes, Isuf Reçi, ishte shtyrë nga Osman Bali për të kryer vrasjen e Avni Rustemit në shenjë hakmarrjeje për vrasjen e Esad Pashë Toptanit
3. Isuf Reçi kishte qenë dikur një nga shërbëtorët e Esad Pashë Toptanit dhe më pas kishte marrë një mulli në të cilin punonte për të mbajtur familjen
4. Vdekja Avni Rustemit i është shkaktuar nga një plumb i vetëm i cili i shkaktoi gjakderdhje, ndërsa plumbi i dytë nuk i shkaktoi ndonjë pasojë
5. Zemra i'u nxor nga trupi dhe u ruajt për shumë vite e balsamosur në një farmaci të Vlorës
6. Për gjashtë ditë në Tiranë u kryen homazhe në nder të Avni Rustemit dhe u mbajtën fjalime nga deputetë të opozitës, të cilët akuzonin Ahmet Zogun si ideator të kësaj vrasjeje.
7. Pasi trupi u dërgua në Vlorë, atje u kryen edhe tri ditë të tjera homazhe për ta varrosur më pas pranë varrit të Ismail Qemalit
8. Sipas kujtimeve të Mustafa Krujës, autori i vrasjes, Isuf Reçi, kishte dashur të vriste më parë Ahmet Zogun, por kishte ndërruar mendim
9. Vrasja e Avni Rustemit ishte shkëndija që ndezi Lëvizjen e Qershorit, ose atë që historiografia komuniste e quajti revolucioni demokratiko-borgjez, por që në fakt ishte kryengritje me armë për marrjen e pushtetit
10. Pas më shumë se 45 vjetësh, më 22 nëntor 1969, me dekret të Presidumit të Kuvendit Popullor Numër 4600 dt.22 nëntor 1969, Avni Rustemi u dekorua me titulliun e lartë "Hero i Popullit"



# SI U VRA AVNI RUSTEMI NGA NJË MULLIXHI, ISH-SHËRBËTOR I AHMET ZOGUT

5 minuta përpara se të shkonte ora 16.00 të dielën e 20 prillit të vitit 1924 në Tiranë, dy plumba të dalë nga e shtëna e pistoletës e lanë të plagosur për të ndërruar jetë dy ditë më vonë. Ishte vrarë vrasësi i Esad Toptanit.

### SKENA E KRIMIT

Me hap të shpejtë, i shkujdesur dhe pa asnjë interes për këdo që kalonte në rrugën e varrezave, Avni Rustemi dukej i sigurt teksa pranë ishin dy miqtë e tij, një prej të cilëve deputeti Hoxhë Kadriu. Atë pasdite të së dielës nuk duhet t'i ketë bërë përshtypje në mes të turmës një njeri i zakonshëm por i panjohur për të. Quhej Isuf Reçi dhe kur akrepat shënonin 15:55. pa i thënë asnjë fjalë, nxori pistoletën nga brezi, ia drejtoi dhe dy krisma të thata e lëkundën Avni Rustemin. Duke u mbajtur në objekte aty pranë, Avniu arriti të nxirrte nga brezi pistoletën e vet dhe të qëllojë katër herë drejt tij, por asnjë plumb nuk e preku atentatorin. Rrëmuja, klithmat dhe urdhri pa objekt i dëshmitarëve "kapeni vrasësin" ishte skena e dytë e ngjarjes. Një pellg gjaku përreth trupit të plagosur dhe zhdukja e atentatorit përbënin skenën e tretë, e cila pati si epilog vdekjen pas dy ditësh të të plagosurit.

### VDEKJA PAS DY DITËSH

Ndonëse atentati ndodhi afër 1 shekull përpara shpikjes së internetit, lajmi u perhaps pothuajse me shpejtësinë e tij në Tiranë dhe në të gjithë Shqipërinë. Politikanët ishin ata që morën në kohë rekord të parët informacionin e saktë se çfarë kishte ndodhur.



Sejfi Vllamasi kujton: "Avni Rustemi plagoset rëndë nga një kriminel profesionist. Jusuf Reçi në vorrezat e asaj kohe, në rrugën e sotme "Hoxha Tahsin". Vrasësi alkoolik e qëlloi Avninë pas shpine e nën shpatull të majtë, duke ia ulur grykën e pushkës me qëllim që të shkaktonte një plagë të rëndë e të çrregullt, me një fjalë vdekjeprurëse. Avniu menjëherë i përgjigjet me pushkë kriminelit, por ai ishte larguar mjaft dhe mbeti i paprekur. Avniu shtrohet në spital të asaj kohe pranë Sahatit".

Avni Rustemi qëndroi në jetë 47 orë e 25 minuta pasi u plagos. Dëmtimi i disa organeve jetësore dhe hemorragjia e madhe i shkaktuan vdekjen. Në autopsinë e kryer nga mjekët shkruhet: "Zotni Avni Rustemi që asht plagos me revolver, plumbi i ka hyrë nga prapa me të tetin e brinjës, në të mëngjërët, 2 gisht afër peshkut të kurrizit, tue shpue majën e mëlçisë, diaphgramin, pankreas dhe duke shpuar stomakun, plumbi ka mbetë përpara nën lëkurë dhe rrjedhja e gjakut ka shkaktue vdekjen. Tiranë 29 qershor 1924".

### VARRIMI DHE ODISEA E ZEMRËS

Ceremonia e varrimit të Avni Rustemit u krye 6 ditë më vonë në Tiranë. Më 28 prill trupi i tij u vendos në qendër të kryeqytetit, banorët e të cilit nuk kishte parë kurrë kryeqyteti një masë aq të madhe njerëzish që nderonin në një vdekje. Në krye të procesionit qëndronin politikanët e opozitës për të cilët vrasja e tij kishte zemëruar të madh e të vogël. Revolucioni kishte filluar. Atmosferën e këtij procesioni na e sjell me plot detaje dhe me nota therëse Eqrem bej Vlora. "Një komedi e ngjashme ishte edhe ceremonia e nderimit para arkivolit të hapur të Avni Rrustemit në spitalin e Tiranës. Të gjithë ata që e quanin veten "popull" dhe "demokratë" kaluan përpara arkivolit të këtij karagjozi kriminel të cilin donin, me doemos, ta ngrinin në piedestalin e heroit kombëtar dhe të martirit. Me radhë, udhëheqësit e Partisë Demokratike ngjiteshin pranë arkivolit dhe zbraznin rrëketë e fjalëve të tyre, pa dashur t'ia dinë se për popullin këto poza janë krejt të huaja, sepse ato shkelin zakonet dhe kuptimin e tij për dinjitetin njerëzor. Kjo shfaqje u zhvillua për një javë të tërë në Tiranë dhe pastaj në Vlorë, për gazin e gjithë kalamajve. Gjithë kjo shfaqje hipokrite ndiqte vetëm një qëllim: të ngrinte peshë zemrat e njerëzve dhe nga trazira e përgjithshme, të fitonte kapital politik. Në këtë vazhdë befas, Partia Demokratike vendosi ta transportojë të vdekurin në Vlorë, ta varrosë në një lëndinë të vogël trekëndëshe para barakës së teatrit dhe kinemasë në kryqëzimin e rrugës Skelë-Kaninë-Vlorë dhe përmbi të, të ngrejë një përmendore. Me qëllim gjoja, që ta përjetësojë.

Në të vërtetë, pas tre muajsh grumbulli i dheut dukej krejt i lënë pas dore, ndërsa pas tre vjetësh ishte zhdukur fare me vjegë se po përcjellin trupin vdekatar të atdhetarit të madh, shumë politikanë të mirëfilltë dhe asish të improvizuar






LES CRISES MINISTÉRIELLES A ROME, A BERLIN ET A VIENNE

PHOTOGRAPHIES DES FÊTES CÉLÉBRÉES HIER A ROUEN EN L'HONNEUR DE JEANNE D'ARC

EXCELSIOR

LUNDI 14 JUIN 1920

ESSAD PACHA, PRÉSIDENT DU GOUVERNEMENT D'ALBANIE, A ÉTÉ ASSASSINÉ, HIER, A PARIS

u vunë në lëvizje nga Tirana dhe përmbytën Vlorën, si një luzmë karkalecash". Por varrimi i Avni Rustemit nuk u bë as në Tiranë, e as në vendlindjen e tij Libohovë. Për të plotësuar amanetin që kishte lënë, trupi i tij u dërgua më 29 prill në Vlorë dhe më 1 maj u krye varrimi.

Ceremonia u bë aty, pranë varrit të Ismail Qemalit, në lulishten në qendër të qytetit. Ishte amaneti i Avni Rustemit dhe aty u ndërtua një varr si bodrum me dy kate nën tokë. Por ky nuk do të ishte varrimi i fundit. Më 8 tetor 1982 në orën 15.00 u zhvarros për t'u ndërtuar një varr i ri. Mbi këtë varr u ndërtua edhe monumenti i Avni Rustemit, autor i të cilit ishte skulptori Kristaq Rama. Avni Rustemi quhej në Vlorë si shqiptar me zemër të fortë. Vrasja që i bëri Esad Pashës ia kishte ngritur në zenit famën dhe kjo lidhej me organin më jetësor të trupit të tij, zemrën.

Idhujt dhe mbështetësit e tij duket se nuk ndaheshin dot fizikisht me Avni Rustemin. Ndonëse ai kishte vdekur, donin të kishin diçka nga trupi i tij. Në ndihmë u erdhi doktor Shezai Çomo, daja i Avni Rustemit, që kreu balsamosjen e trupit. Ishte më se normale në atë kohë që trupi i një të vdekuri të balsamosej. Por kjo procedurë kërkonte që organet e brendshme të nxirreshin nga trupi dhe me to kryheshin procedura të tjera. Mjekët vendosën që ta ruanin zemrën e Avni Rustemit dhe Zyma, doktori i njohur i asaj kohe, kreu të gjithë procesin e balsamosjes së trupit, por edhe të ruajtjes së zemrës në kushte optimale. I pari që flet për këtë veprim të rrallë është Sejfi Vllamasi. "Avniu vdiq pas dy ditësh nga hemoragjia. Zemrën ia nxorën për ta ruajtur dhe tru pin ia balsamosën për ta transportuar në Vlorë për varrim".

Si një objekt trofe zemra e Avni Rustemit u vendos në kushte ruajtjeje në një vazo, e zhytyr në një solucion që e ruante përjetësisht dhe iu dorëzua farmacistit të Vlorës Nasho Qirko, që shërbente në farmacinë numër 1 të qytetit. Për 39 vjet zemra u ekspozua në farmaci, e vetmja farmaci në Shqipëri që shërbente për dy funksione; për të blerë ilaçe, por edhe si një ekspozitë për të parë zemrën e Avni Rustemit. Pas vitit 1963 nuk ka asnjë të dhënë se ku përfundoi zemra. Ekziston një kërkesë që zemra të kthehej në vendlindjen e Avniut në Libohovë, por nuk nuk është konfirmuar kurrë që zemra të ketë shkuar atje. Pas afro një shekulli nga vrasja jemi të qartë se si e vrau Esad Pashën në Paris dhe si e vranë Avni Rustemin në Tiranë. Por nuk e kemi të qartë se cili ishte fati i zemrën së tij, ajo zemër që i dha atij famë, emër, por edhe guxim për t'u futur në histori.

### SI U ORGANIZUA VRASJA?

Vetëm disa orë pas atentatit ndaj Avni Rustemit, fjalënaja mbi autorin e krimit qe bërë ortek. Si fillim u akuzua direkt Ahmet Zogu që kishte vënë Isuf Reçin të kryente vrasjen. Dikur Isufi kishte qenë shërbëtor te familja e Zogut dhe ky ishte një fakt për të besuar dorën e Zogut në këtë ngjarje. Por më pas akuzat ndaj Zogut nisën të zvogëlohen si intriguesi kryesor u përmend Osman Bali, njeriu i besuar i Esad Pashë Toptanit. Sipas të dhënave, një ditë më parë nga ngjarja, ai planifikoi dy atentate. Të parin do ta bënte vetë Osmani, në Elbasan, duke vrarë Aqif Pashën, një nga njerëzit më të rëndësishëm të opozitës së asaj kohe, ndërsa të dytin ia kishte lënë detyrë Isuf Reçit të vriste në Tiranë Avni Rustemin. Isuf Reçi ishte një njeri i thjeshtë, që prej vitesh kishte marrë tek sarajet e Esadit një mulli dhe duke bluar ushqente familjen e tij. Historia mori trajtën e një legjende teksa përmendej se Osman Bali nuk donte të ishte ai vrasësi i Avni Rustemit.

"Nuk e ndyj koburen me të", përflitej, se kishte thënë Osman Bali, tek i ngjeshte në dorë revolverin të punësuarit tek Pasha. Plani i Osman Balit u realizua përgjysmë. Vetë ai nuk e gjeti në Elbasan Aqif Pashën dhe kështu ai u shpëtoi. Isuf Reçi, mirënjohës, por edhe besnik i kujtimit të Esadit, mjaft i pikëlluar kur në pranverë 1920 i patën vrarë idhullin e tij, nuk e humbi orientimin dhe pasi i çuan fjalë se Avni Rustemi sapo kishte zënë një dhomë në Hotel International, e priti të dilte. Për orë të tëra iu vu pas Avni Rustemit. Pastaj e ndoqi pa rënë fare në sy. Do t'i kishte shtënë më shpejt nga sa ndodhi, sepse qe fare vetëm, por që në minutat e para të lëvizjes iu shfaqën dy mbështetës dhe e vunë në mes, në një mënyrë të tillë si të ishin truproja. Por ai megjithatë e pati gjetur çastin kur nëpër kapërcyell të kalimit të rrugës Avni Rustemi u shkëput prej mbrojtësve të tij. Nxori pistoletën dhe qëlloi disa herë ndaj tij, duke zbatuar planin e Osman Balit, por edhe dëshirën që e digjte prej kohësh. Isuf Reçi hyri kështu në histori si vrasësi i vrasësit të Esad Pashë Toptanit, shefit të tij.

### PËRSE E VRANË AVNI RUSTEMIN?

Më shumë se një herë në jetën e tij ai kishte bërë thirrje për dy mundësi: ose arritje e qëllimit, ose vdekje. Në fakt atij iu plotësuan të dyja. Avni Rustemi ishte rritur me pistoletë nën jastëk. Se sa gjaknxehtë, se sa i manipulueshëm dhe se sa lehtë mund të futej Avni Rustemi në aksion për të vrarë dikë e tregon më mirë Mehdi Frashëri: "Kur ndodhesha në Vlorë Avni Rustemi më çoi haber se më kishte ftuar në një duel... kisha thënë në fjalim në parlament se Shqipëria e Jugut nga rendi popullor ka nxjerrë Avni Rustemin, Shqipëria e Mesme nxori Xhiun e Fajes. Mustafa Kruja duke përfituar nga thjeshtësia e Avni Rustemit, fjalimin tim atij ia kishte kallëzuar si ofendues, me qëllim të keq, ta shtynte atë kundër meje... Mbasi ia shpjegova çështjen Avniut, u pendua dhe kërkoi ndjesë".

Por ky incident me Mehdi Frashërin ngjan si lojë luftash për fëmijët përballë impikimet e tij në vrasje të drejtpërdrejta. Vrasja e Esad Pashë Toptanit dhe atentati i Ahmet Zogut në Parlament në 1923, kishin vetëm një emër, Avni Rustemi. Ndërsa i pari ishte një ekzekutim direkt, i dyti ishte se Beqir Valterin e kishte shtyrë Avni Rustemi. Këto e kishin bërë Avni Rustemin pothuajse një hero të gjallë dhe kishte pothuajse 4 vjet që ai ishte kthyer në një personazh magnetik. Nipi i Esad Pashë Toptanit dhe një nga politikanët më aktivë të asaj kohe, Eqrem bej Vlora, është më i drejtpërdrejtë në arsyet përse e vranë Avni Rustemin. "Avni Rustemi ishte një kriminel dhe karagjoz. Me vrasjen e tij drejtësia u vu në vend. Ahmet Zogu e dinte cilët ishin organizatorët. Ai pajtoi një njeri në Tiranë që kishte marrë prej vitesh me qira një mulli bloje nga Esat pasha (njëherësh edhe vetë Esatist i njohur), i cili qëlloi me revolver dhe plagosi rëndë Avni Rustemin, vrasësin e Esat Pashë Toptanit dhe nxitësin kryesor të atentatit kundër Zogut. I plagosuri vdiq dy ditë më vonë në spitalin e Tiranës. Ky kishte qenë një akt i shkëlqyer hakmarrjeje, që jo vetëm përputhej me rregullat e kodit të vendetës shqiptare, por bënte edhe një shërbim tjetër: pajtonte dy rryma politike: esatizmin dhe ahmetizmin, deri atëherë të ndara".

Studiuesi Ylli Polovina i rendit faktet në mënyrë të tillë që shërbimi sekret jugosllav në rastin më të mirë ishte i interesuar që shqiptarët të hanin kokat e njëri-tjetrit.




## 10 MISTERE

1. Nga cilët ruhej Avni Rustemi meqenëse dy persona e ruanin në çdo lëvizje të tij?
2. Përse Myfit Libohova u largua jashtë Shqipërisë pas vrasjes së Avni Rustemit?
3. Si ka mundësi që ditën e vrasjes dy truprojat e Avni Rustemit ishin në Durrës dhe ai lëvizte i vetëm në Tiranë?
4. Përse Avni Rustemi u qëllua për vdekje pikërisht ditën që do të paraqitej në ambasadën amerikane për të marrë vizë, sepse do të takonte diasporën?
5. A ka gisht vetë opozita e asaj kohe në këtë vrasje që i shërbeu politikisht për të shpërthyer revolucionin?
6. Sa kanë pasur gisht shërbimet sekrete të huaja në vrasjen e Avni Rustemit?
7. A ka lidhje vrasja e Avni Rustemit me atentatin që Beqir Valteri i bëri Ahmet Zogut në Parlament, për të cilin tregoi se e kishte shtyrë Avni Rustemi?
8. Përse varrimi i Avni Rustemit u bë në Vlorë dhe jo në vendlindjen e tij Libohovë e as në Tiranë ku ai ushtronte aktivitetin si politikan?
9. Çfarë kuptimi ka që 3 vjet pas vrasjes, Ahmet Zogu i lidhi pension nga fondi sekret i Ministrisë së Brendshme Neim Rustemit, babait të Avni Rustemit, dhe përse pensioni ndaj të atit të Rustemit ishte i fshehtë dhe jo publik?
10. Përse Neim Rustemi që kishte akuzuar publikisht direkt ministrin Mufit Libohova e pranoi këtë.

### PENSIONI I ÇUDITSHËM BABAIT TË RUSTEMIT

Misterit të vrasjes dhe atij të zhdukjes së zemrës së Avni Rustemit i shtohet dhe një mister tjetër: në kulmin e pushtetit të vet, dy vjet që nga koha që ishte zgjedhur president, Ahmet Zogu i lidhi një pension të majmë për kohën familjes së Avniut, më saktë babait të tij. Më 1 korrik 1930, prefekti i Gjirokastrës Kolë Rodhe, njofton Zyrën Sekrete: "Bashkëngjitun, kemi nderin t'ju paraqisim dëftesën mbi marrjen në dorëzim të 400 fr. ari, nga ati i të ndjerit Avni Rustemit, përcjellë prej kësaj prefekture me shkresën nr. 62. res., date 23 qershor 1930 të N/prefekturës Libohovës..."

Pra me një llogari çdo muaj ai merrte pension 100 franga ari. Kur vetë Neim Rustemi kishte akuzuar Ahmet Zogun si vrasës përse i pranoi? A kishte ndërruar ai mendim se autori nuk ishte Zogu, apo kjo ishte një blerje e formës alla shqiptarçe e gjakut të të birit? Është e vështirë që pas kaq vjetësh të hamendësosh dhe të përgjigjesh saktë për atë që ka bërë babai i Avni Rustemit. Por fakti që vendimi ka qenë sekret dhe që Neim Rustemi ka heshtur tregojnë shumë.

*(Marrë nga libri "100 vrasjet më të bujshme në historinë e shtetit shqiptar 1912-2017" i Roland Qafokut)*

Deputetja e Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lirie Kajtazi, theksoi se Kosova vazhdon të jetë dosja e krimit të pandëshkuar në Ballkanin Perëndimor dhe vazhdon të lëngojë nga plaga e hapur me rrëmbimin e qytetarëve të saj. Kajtazi në Kuvendin e Kosovës tha se familjeve kosovare vazhdon t'iu mungojnë 1652 njerëz.

# PERSONAT E PAGJETUR, PENGU I KOSOVËS



Në Mejë na ruajnë varret dhe gjaku i martirëve, të cilët janë nderi ynë. Kështu tha kryeministri Ramush Haradinaj në Tubimin Qendror Përkujtimor në Kompleksin Memorial në Mejë i organizuar nën patronatin e kryeministrit Haradinaj.

Kryeministri Haradinaj bëri edhe homazhe në nderim të viktimave të Mejës duke vënë kurora lulesh.

Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës, Andin Hoti, i cili bashkë me deputeten Saranda Bogujevci e kanë iniciuar debatin parlamentar për të pagjeturit kërkoi nga shteti që të bëjë më shumë për zbardhjen e fatit të personave të të pagjetur.

Ai përmendi edhe fatin e babait të tij, Ukshin Hoti, duke thënë se si djalë i tij e ka obligim të ngre zërin për drejtësi në kërkim të zbardhjes së gjithë personave të pagjetur për hir të paqes dhe mos mbajtjes peng së ardhmes.

Në ditën kur Kosova e shënon Ditën Kombëtare të Personave të Pagjetur, misioni i EULEX-it, ka shprehur përkushtim për ta vazhduar rrugëtimin drejt zbardhjes se vendndodhjes së personave të pagjetur në Kosovë.

"Është një realitet që të copëton shpirtin kur nuk e din vendndodhjen e ndonjë të dashuri. Në angazhimin e tij me vendosmëri për të ndihmuar në zgjidhjen e çështjes së të pagjeturve, EULEX-i u bën thirrje komuniteteve shqiptare dhe serbe që të paraqiten për t'i dhënë mostrat e gjakut për analizën e ADN-së në mënyrë që të lehtësohet ky proces i rëndësishëm ", tha Shefja e Misionit EULEX, Alexandra Papadopoulou.

Përfaqësuesi i familjes së personave të pagjetur, Bajram Qerkini, shprehet i zhgënjyer me premtimet e institucioneve kosovare se, shumë shpejt, do të zbardhet fati i të pagjeturve në Kosovë.Qerkini, në një bisedë për "GazetaBlic", tha se, tashmë, ka kaluar shumë kohë duke pritur të zgjidhet kjo çështje. Kjo pritje vetëm sa po i mundon më shumë familjarët e të pagjeturve."Neve na shkoi shumë kohë duke besu, ne familjarët jemi në përfundim e sipër të jetës, ne ju kemi besu gjithmonë premtimeve të Institucioneve kosovare, premtime këto që nuk kanë fund. Dhe, lojnave të Serbisë, Institucionet kosovare nuk po janë në gjendje më i'u dhanë fund. Po na mbajnë peng edhe neve që jemi gjallë, deri kur me besu më", thotë Qerkini.

Edhe kryetari i Komisionit Qeveritar për të Pagjeturit, Prenk Gjetaj, tha për "GazetaBlic", se dialogu me Serbinë, nuk do të mund ta zbardhe fatin e të pagjeturve, pasi që, kjo temë, as nuk është në kuadër të bisedimeve me palën serbe.

Abelard Tahiri në debatin parlamentar për personat e zhdukur ka thënë se kjo është tema më e dhimbshme për të cilën diskutohet.Tahiri ka thënë se familjaret duhet të dinë për fatin e të zhdukurve.Ai ka thënë se adresa ku duhet kërkuar për fatin e të pagjetheve është Serbia.

"Jemi duke përgatitur një sërë notash verbale në shtetet më të fuqishme, që çështja e të zhdukurve të bëhet temë në të gjitha takimet ndërkombëtare, në mënyrë që t'i bëhet presion Serbisë për fatin e të pagjeturve", ka thënë Tahiri në fjalimin e tij në Kuvend.

Por, Nusrete Kumnova, familjare dhe aktiviste e zbardhjes së fatit të të pagjeturve, shprehu pakënaqësinë e saj pse deri tash nuk dihet asgjë për 1600 personat e zhdukur gjatë luftës në Kosovë.Për "GazetaBlic", Kumnova tha se nuk pret as që përmes dialogut Kosovë-Serbi të zbardhet fati i të pagjeturve.Edhe ajo, po ashtu, beson që vetëm bashkësia ndërkombëtare mund ta zbardh këtë çështje, kurse ata që kanë kryer vrasje dhe veprime tjera gjatë luftës, të dalin para drejtësisë, tranmseton gazeta KOHA.

Deputetja e Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lirie Kajtazi, theksoi se Kosova vazhdon të jetë dosja e krimit të pandëshkuar në Ballkanin Perëndimor dhe vazhdon të lëngojë nga plaga e hapur me rrëmbimin e qytetarëve të saj. Kajtazi në Kuvendin e Kosovës tha se familjeve kosovare vazhdon t'iu mungojnë 1652 njerëz.



## Kroacia do ta tërheq urgjentisht ambasadorin e saj nga Beogradi?

Qeveria Kroate kërkon që Zagrebi t'i përgjigjet sa më ashpër Serbisë, e cila e ka shpallur persona non grata zëvendëskryeministrin kroat dhe njëkohësisht ministrin e mbrojtjes Damir Krstiçeviq, me masa të reciprocitetit si për shembull, ngrirje të negociatave të Serbisë me BE apo ngritjen e çështjes së kufirit në Danub, shkruan Vecernji list i Zagrebit.

Të premten, qeveria e Serbisë ka vendosur që ta shpallë të padëshiruar zëvendëskryeministrin kroat Krstiçeviq, si përgjigje në vendimin kroat për moslejimin e hyrjes së ministrit të mbrojtjes serbe Aleksandar Vulin në Kroaci. Ai kishte deklaruar që do të shkojë në Jasenovac ku do "të ballafaqohet me nacionalistët kroat". Gazeta, duke u thirrur në burimet e veta, pretendon se hapi i ardhshëm diplomatik i Kroacisë do të jetë tërheqje urgjente e ambasadorit të vet në Beograd, Gordan Bakota.

"Derisa Serbia nuk ndërpret riafirmimin e politikës serbomadhe ndaj Kroacisë dhe derisa nuk e largojnë Sheshelin nga parlamenti, do të ketë masa ndaj Serbisë. Në fund të fundit, ata duhet t'i respektojnë ligjet e veta të cilët nuk i lejojnë status të deputetit një krimineli të luftës", ka thënë për gazetën një anëtar anonim i qeverisë.

# VETTINGU NË POLICI, HAPET GARA PËR KOMISIONIN E GJYQTARËVE

Ministria e Brendshme shpall vendet vakante për Komisionin e Jashtëm të Vlerësimit, sa i takon vettingut në polici.

Bordi i Përzgjedhjes së Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit Kalimtar dhe Periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, (SHÇBA) në Ministrinë e Brendshme ka zhvilluar mbledhjen e konstituimit, në zbatim të ligjit.

Vendimi i parë i Bordit ishte shpallja e vendeve të lira për 5 anëtarë të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit dhe 15 anëtarëve të Sekretariatit Teknik.




Afati për dorëzimin e dokumenteve të kërkuara për personat e interesuar për t'u bërë pjesë e Komisionit është 15 ditë nga shpallja.

Bordi i Përzgjedhjes rezervon të drejtën për të kryer verifikimin e të dhënave të deklaruara nga kandidatët në aplikimin e kryer.

Për anëtarë të Komisionit mund të aplikojnë personat që kanë përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare, kanë 10 vite përvojë në profesion, nuk janë angazhuar në funksione drejtuese në parti politike në tre vitet e fundit, nuk janë të dënuar apo nuk janë në proces hetimi, nuk janë subjekt i vettingut në drejtësi, nuk kanë marrë masë disiplinore dhe nuk ka qenë bashkëpuntor i ish-sigurimit të shtetit.

Ndërkohë, për Sekretariatin Teknik kërkohet një përvojë pune 5-vjeçare dhe kriteret e lartpërmendura

Afati për dorëzimin e dokumenteve të kërkuara për personat e interesuar për t'u bërë pjesë e Komisionit është 15 ditë. Ministria e Brendshme thotë se Bordi i Përzgjedhjes rezervon të drejtën për të kryer verifikimin e të dhënave të deklaruara nga kandidatët në aplikimin e kryer, shkruan gazeta Shqip.

# LIDERËT E KOREVE PAJTOHEN PËR LARGIMIN E ARMËVE NUKLEARE

Detajet se si do të realizohet plani për de-nuklearizim nuk janë bërë të qarta, përderisa shumë analistë janë skeptik për entuziazmin për bashkëpunim të shfaqur nga Koreje e Veriut



Kim Jong-un ka kaluar kufirin të premten në mëngjes, duke u bërë udhëheqësi i parë i Koresë së Veriut që ka vizituar Korenë e Jugut duke kaluar vijën ushtarake që ka ndarë gadishullin që nga fundi i Luftës së Koresë në vitin 1953. Teksa Kim ishte në makinën e tij, 12 truproja e kishin rrethuar automjetin dhe vraponin për të mbrojtur liderin e tyre.



Liderët e të dy Koreve janë pajtuar që të punojnë në drejtim të largimit të armëve nukleare nga gadishulli. Lajmërimi për këtë dakordim është bërë nga lideri i Koresë së Veriut Kim Jong-un dhe Moon Jae-in i Koresë së Jugut, pasi dyshja zhvilloi të premten një takim në kufi.

Palët gjithashtu janë pajtuar që të shndërrojnë armëpushimin që i dha fund luftës në mes të Koreve më 1953, në një traktat të paqes gjatë këtij viti.

Këto zhvillime vijnë disa muaj pas një retorike të ashpër nga Koreja e Veriut.

Detajet se si do të realizohet plani për de-nuklearizim nuk janë bërë të qarta, përderisa shumë analistë janë skeptik për entuziazmin për bashkëpunim të shfaqur nga Koreje e Veriut.

Marrëveshjet paraprake që kishin përfshirë premtime të ngjashme në lidhje me çështjet e armëve janë braktisur pasi Koreja e Veriut filloi testimet nukleare ndërsa ajo e jugut zgjodhi president më konservativ.

Kim Jong-un u bë lideri i parë i Koresë së Veriut që shkel në Korenë e Jugut, duke kaluar vijën ushtarake që ka ndarë gadishullin që prej fundit të Luftës Koreane, në vitin 1953.

Në një moment plot simbolikë, lideri koreano-jugor Moon Jae-in dhe Kim shtrënguan duart në kufi, në të dyja anët e tij për të qenë të saktë, pasi Kim e ftoi Presidentin e Koresë së Jugut që për pak çaste të kalonte kufirin drejt Veriut. Ndryshimi i situatës është kolosal, pasi vetëm pak muaj më parë diskutimi mes vendeve ishte luftarak, ndërsa tani ata mund të diskutojnë paqen dhe armët bërthamore.

Pjesa më e medhe e temave të samitit janë dakorduar mes palëve, megjithëse shumë ekspertë janë skeptikë për entuziazmin e Veriut për një marrëveshje. Pas ceremonive zyrtare, dy liderët hynë në Shtëpinë e Paqes në Panmunjom, një ndërtesë ushtarake në zonën e çmilitarizuar në kufi, ku Kim firmosi Librin e Miqve.

“Tani fillon historia e re dhe epoka e paqes”, shkroi Kim Jong-un. Ulja e parë në tryezë me distancë të saktë prej 2018 milimetrash nga njëri-tjetri ishte pjesë e ceremonive formale, ndërsa liderët shkëmbyen fjalët e bukura të momentit, pasi samiti i vërtetë nis më vonë. Në takimin e shkurtër, dy liderët shprehën shpresën e tyre për një diskutim të sinqertë dhe shkëmbim të ngrohtë idesh gjatë samitit.

Një pjesë e këtij të fundit padyshim që do të zhvillohet larg syve kureshtarë dhe do të shërbejë si një prelud për takimin e Kim Jong-un me Donald Trump.

# Norvegji, iniciativë për pengimin e ezanit



Partia e Progresit (Fremskrittspartiet-FrP), e cila njihet për retorikën raciste, ka kërkuar që ezani që thirret brenda xhamive të mos dëgjohet jashtë

Partia e koalicionit trepalësh qeveritar në Norvegji, Partia e Progresit (Fremskrittspartiet-FrP), e cila njihet për retorikën raciste, ka kërkuar që ezani që thirret brenda xhamive të mos dëgjohet jashtë. Zëdhënësi i partisë përgjegjës për Politikat rreth Migrantëve, Jon Helgheim, në një deklaratë për shtypin e Norvegjisë ka thënë se propozimet për pengimin e dëgjimit të ezanit jashtë xhamive do të diskutohen në kongresin e partisë që do të mbahet në fundjavë.

"Nuk më bëhet vonë se çfarë thonë ligjet për të drejtat e njeriut në këtë drejtim. Ajo që është me rëndësi për mua është që personat që banojnë afër xhamive të jetojnë në paqe dhe qetësi dhe të mos shqetësohen nga ezani. Nuk më interesojnë rregullat kundër ndalimit të ezanit në konventat e të drejtave të njeriut", ka deklaruar Helgheim. Ndryshe, ezani në xhamitë në Norvegji nuk thirret nga minaret, ndërsa zëri gjatë thirrjes brenda xhamive me altoparlantë mund të dëgjohet edhe jashtë.

Pengimi i ezanit është aktualizuar edhe në të kaluarën nga ana e Partisë së Progresit. Atëbotë, Ministria e Drejtësisë e Norvegjisë kishte deklaruar se ezani bën pjesë në kuadër të lirisë fetare dhe pengimi i tij është në kundërshtim me Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

# Somali, mbi 427 mijë njerëz të prekur nga përmbytjet

Të paktën 427 mijë njerëz janë prekur nga përmbytjet për shkak të shirave të dendura anembanë Somalisë në muajin prill, njoftoi Këshilli Norvegjez i Refugjatëve (NRC). "Stafi ynë në terren ka parë të moshuar, gra dhe fëmijë që përpiqen të mbijetojnë, ndërsa strehët e tyre të brishta janë të mbushur me ujë të ndenjur", tha drejtori i NRC-së Victor Moses në një deklaratë. "Komunitete të shumta të zhvendosura po strehohen në zona që mund të ndikohen nga përmbytjet. Qasja e kufizuar në tualete të duhura dhe ujë të pastër në çdo çast mund të shkaktojë shpërthimin e sëmundjeve si kolera dhe malaria", paralajmëroi Moses. Të enjten, Zyra e OKB-së për Koordinimin e Çështjeve Humanitare tha se "afro 175 mijë njerëz janë zhvendosur si pasojë e përmbytjeve të lumenjve në shtetet Hirshabelle, Jugperëndim dhe Jubaland si dhe në rajonin Banadir. "Nuk janë raportuar viktima të reja njerëzore që nga përditësimi i fundit, kur u gjetën tre persona të mbytur", shtoi zyra e OKB-së. OKB tha se "reshjet e dendura do të vazhdojnë gjatë javës së ardhshme si brenda Somalisë, ashtu edhe brenda maleve të Etiopisë".



REPUBLIKA E MAQEDONISË
AGJENCIA E ADMINISTRATËS

Në bazë të nenit 35 të Ligjit të Nëpunësve Administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 27/14, 199/14, 48/15, 154/15, 5/16, 142/16 dhe 11/18) dhe Rregullores së mënyrës së zbatimit të procedurës për punësim të nëpunësve administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 27/18), lidhur me nenin 20-g të Ligjit të punësuarve në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 27/14, 199/14, 27/16 dhe 35/18) dhe Rregullores së elementeve të obligueshme të shpalljes publike të plotësimit të vendit të punës në sektorin publik përmes punësimit dhe fletëparaqitjes për punësim, si dhe të formës, përmbajtjes dhe mënyrës së mbajtjes së regjistrit të personave që kanë dhënë të dhëna të rrejshme gjatë punësimit në sektorin publik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 34/15), Agjencia e Administratës publikon

## SHPALLJE PUBLIKE NUMËR – 30/2018

për punësimin e 7 nëpunësve shtetëror nga grupi I, nëngrupi I në „Kuvendin e Republikës së Maqedonisë "për vendet e punës në vijim:

1. UPR0101B0200 Udhëheqës i sektorit për analiza të përgjithshme, hulumtim dhe eurointegrim në Njësinë speciale organizative - Instituti parlamentar — 1 realizues(ë)

**Kushtet e përgjithshme:**
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

**Kushtet e posaçme:**
- niveli i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi, sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, shkenca juridike, shkenca politike ose shkenca ekonomike
- më së paku 5 (pesë) vjet përvojë pune në profesion, ku së paku 2 (dy) vjet udhëheqës në vend pune në sektorin publik, përkatësisht së paku 8 (tetë) vjet përvojë pune në profesion, prej të cilave së paku 3 (tre) vjet në vend pune udhëheqës në sektorin privat.

Gjatë përzgjedhjes përparësi do të kenë kandidatët të cilët i plotësojnë edhe kushtet e veçanta në vijim për zbatim të punës:
- Të kryer shkallën e arsimit VII/2 ose 300 kredite sipas EKST(Shkenca juridike ose shkenca politike ose shkenca ekonomike)
- përvojë në planifikim strategjik
- përvojë në të shkruarit e raporteve (materiale informative)
- njohje të gjuhës zyrtare përpos gjuhës maqedone ku flasin më së paku 20% nga qytetarët e Republikës së Maqedonisë
- më së paku njohje të dy gjuhë të Bashkimit evropian

**Kompetencat e përgjithshme:**
- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- punë me të tjerë/punë ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara
- udhëheqje; dhe
- menaxhim financiar

**Kompetenca të posaçme:**
- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- çertifikatë e dhënies së provimit të udhëheqjes administrative
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frengjisht, gjermanisht)

**Kushtet shtesë:**
- përvojë në hulumtime juridike
- zotësi analitike
- përvojë pune me persona të zgjedhur ose të emëruar ose zyrtarë
- aftësi udhëheqëse
- aftësi për punë me njerëz me qëndrime të ndryshme
- angazhim për paanësi dhe transparencë

**Orari i punës :**
- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 08:30 - 16:30

Rroga neto: 35.872,00 denarë

**VËREJTJE:** Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.

2. UPR0101B0200 Udhëheqës i sektorit për edukim dhe komunikim, për bibliotekë hulumtuese dhe arkivi legjislativ në Njësin speciale organizative - Instituti parlamentar — 1 realizues(ë)

**Kushtet e përgjithshme:**
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

**Kushtet e posaçme:**
- niveli i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi, sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, Shkenca juridike ose bibliotekarisë dhe dokumentacioni
- më së paku 5 (pesë) vjet përvojë pune në profesion, ku së paku 2 (dy) vjet udhëheqës në vend pune në sektorin publik, përkatësisht së paku 8 (tetë) vjet përvojë pune në profesion, prej të cilave së paku 3 (tre) vjet në vend pune udhëheqës në sektorin privat

Gjatë përzgjedhjes përparësi do të kenë kandidatët të cilët i plotësojnë edhe kushtet e veçanta në vijim për zbatim të punës:
- Të kryer shkallën e arsimit VII/2 ose 300 kredite sipas EKST (Shkenca juridike ose bibliotekarisë dhe dokumentacioni)
- përvojë në planifikim strategjik
- përvojë me punën e sistemeve Universal Decimal Classification(UDC) dhe/ose Dewey Decimal Classification(DDC)
- përvojë me punën e sistemeve Interlibrary Loan (ILL)
- përvojë me punën e sistemeve elektronike Co-Operative Online Bibliographic System &Services(COBISS)
- përvojë në të shkruarit e raporteve (materiale informative)
- njohje të gjuhës zyrtare përpos gjuhës maqedone ku flasin më së paku 20% nga qytetarët e Republikës së Maqedonisë
- më së paku njohje të dy gjuhë të Bashkimit evropian

**Kompetencat e përgjithshme:**
- arritje të rezultateve
- punë me të tjerë/punë ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara
- udhëheqje; dhe
- menaxhim financiar
- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim

**Kompetenca të posaçme:**
- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- çertifikatë e dhënies së provimit të udhëheqjes administrative
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frengjisht, gjermanisht)

**Kushtet shtesë:**
- përvojë me punë në bibliotekë ose në arsim
- përvojë pune me persona të zgjedhur ose të emëruar ose zyrtarë
- zotësi analitike
- aftësi udhëheqëse
- aftësi për punë me njerëz me qëndrime të ndryshme
- angazhim për paanësi dhe transparencë

**Orari i punës :**
- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 08:30 - 16:30

Rroga neto: 35.872,00 denarë

**VËREJTJE:** Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Shqiptar(e) 1.

3. UPR0101B0400 Udhëheqës i njësisë për analiza të përgjithshme dhe hulumtime, Sektori për analiza të përgjithshme, hulumtime dhe eurointegrime në Njësinë speciale organizative - Instituti parlamentar — 1 realizues(ë)

**Kushtet e përgjithshme:**
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

**Kushtet e posaçme:**
- niveli i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi, sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, Shkenca juridike ose shkenca ekonomike
- më së paku 4 (katër) vjet përvojë pune në profesion, ku së paku 1 (një) vit në vend pune në sektorin publik, përkatësisht së paku 6 (gjashtë) vjet përvojë pune në profesion, prej të cilave së paku 2 (dy) vjet në vend pune udhëheqës në sektorin privat .

Gjatë përzgjedhjes përparësi do të kenë kandidatët të cilët i plotësojnë edhe kushtet e veçanta në vijim për zbatim të punës:
- Të kryer shkallën e arsimit VII/2 ose 300 kredite sipas EKST (Shkencat organizuese dhe menaxhim(menaxhment) ose shkenca ekonomike ose shkenca juridike)
- përvojë pune me persona të zgjedhur ose të emëruar ose zyrtarë
- njohje të gjuhës zyrtare përpos gjuhës maqedone ku flasin më së paku 20% nga qytetarët e Republikës së Maqedonisë
- më së paku njohje të dy gjuhë të Bashkimit evropian

**Kompetencat e përgjithshme:**
- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- punë me të tjerë/punë ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara
- udhëheqje; dhe
- menaxhim financiar

**Kompetenca të posaçme:**
- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- çertifikatë e dhënies së provimit të udhëheqjes administrative
- njohjen aktive të një prej tre gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frengjisht, gjermanisht)

**Kushtet shtesë:**
- përvojë nga hulumtimet në sferën e ekonomisë
- zotësi analitike
- aftësi për punë me njerëz me qëndrime të ndryshme
- angazhim për paanësi dhe transparencë

**Orari i punës :**
- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 08:30 - 16:30

Rroga neto: 28.303,00 denarë

**VËREJTJE:** Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.

4. UPR0101B0400 Udhëheqës i njësisë për edukim dhe për komunikim, Sektori për edukim dhe për komunikim, për bibliotekë hulumtuese dhe arkivi legjislativ në Njësinë speciale organizative - Instituti parlamentar — 1 realizues(ë)

**Kushtet e përgjithshme:**
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,

- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

**Kushtet e posaçme:**

- niveli i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi, sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, Shkenca juridike, shkenca politike ose shkenca ekonomike
- më së paku 4 (katër) vjet përvojë pune në profesion, ku së paku 1 (një) vit në vend pune në sektorin publik, përkatësisht së paku 6 (gjashtë) vjet përvojë pune në profesion, prej të cilave së paku 2 (dy) vjet në vend pune udhëheqës në sektorin privat.

Gjatë përzgjedhjes përparësi do të kenë kandidatët të cilët i plotësojnë edhe kushtet e veçanta në vijim për zbatim të punës:

- Të kryer shkallën e arsimit VII/2 ose 300 kredite sipas EKST(Shkenca juridike, shkenca politike, ose shkenca ekonomike)
- përvojë pune me persona të zgjedhur ose të emëruar ose zyrtarë
- përvojë në punë në arsim
- përvojë në përpilimin e programeve arsimore
- njohje të gjuhës zyrtare përpos gjuhës maqedone ku flasin më së paku 20% nga qytetarët e Republikës së Maqedonisë
- më së paku njohje të dy gjuhë të Bashkimit evropian

**Kompetencat e përgjithshme:**

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- punë me të tjerë/punë ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara
- udhëheqje; dhe
- menaxhim financiar

**Kompetenca të posaçme:**

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- çertifikatë e dhënies së provimit të udhëheqjes administrative
- njohjen aktive të një prej tre gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frengjisht, gjermanisht)

**Kushtet shtesë:**

- aftësi për punë me njerëz me qëndrime të ndryshme
- angazhim për paanësi dhe transparencë
- zotësi analitike

**Orari i punës :**

- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 08:30 - 16:30

Rroga neto: 28.303,00 denarë

**VËREJTJE:** Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.

5. UPR0101V0100 Këshilltar - hulumtues dhe analist në sistemet moderne ekonomike, Njësia për analiza të përgjithshme dhe hulumtime, Sektori për analiza të përgjithshme, hulumtime dhe eurointegrime në Njësinë speciale organizative - Instituti parlamentar — 1 realizues(ë)

**Kushtet e përgjithshme:**

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

**Kushtet e posaçme:**

- nilevi i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi sipas ECTS, ose të kryer shkallës VII/1, Shkencat organizuese dhe menaxhim(menaxhment) ose shkenca ekonomike
- së paku 3 (tre) vjet përvojë pune në profesion

Gjatë përzgjedhjes përparësi do të kenë kandidatët të cilët i plotësojnë edhe kushtet e veçanta në vijim për zbatim të punës:

- Të kryer shkallën e arsimit VII/2 ose 300 kredite sipas EKST (Shkencat organizuese dhe menaxhim(menaxhment) ose shkenca ekonomike)
- përvojë pune me persona të zgjedhur ose të emëruar ose zyrtarë
- zotësi për fjalim në publik dhe shprehjes me shkrim
- përvojë në të shkruarit e raporteve (materiale informative)
- njohje të gjuhës zyrtare përpos gjuhës maqedone ku flasin më së paku 20% nga qytetarët e Republikës së Maqedonisë
- më së paku njohje të dy gjuhë të Bashkimit evropian

**Kompetencat e përgjithshme:**

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- puna me të tjerë/puna ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar

**Kompetenca të posaçme:**

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frengjisht, gjermanisht)

**Kushtet shtesë:**

- përvojë nga implementimi i hulumtimeve ekonomike
- zotësi analitike
- aftësi për punë me njerëz me qëndrime të ndryshme
- angazhim për paanësi dhe transparencë

**Orari i punës :**

- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 08:30 - 16:30

Rroga neto: 25.023,00 denarë

**VËREJTJE:** Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.

6. UPR0101V0100 Këshilltar - hulumtues dhe analist në ligjet krahasuese dhe sistemet ligjore, Njësia për analiza të përgjithshme dhe hulumtime, Sektori për analiza të përgjithshme, hulumtime dhe eurointegrime në Njësin speciale organizative - Instituti parlamentar — 1 realizues(ë)

**Kushtet e përgjithshme:**

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

**Kushtet e posaçme:**

- nilevi i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi sipas ECTS, ose të kryer shkallës VII/1, Shkenca juridike
- së paku 3 (tre) vjet përvojë pune në profesion

Gjatë përzgjedhjes përparësi do të kenë kandidatët të cilët i plotësojnë edhe kushtet e veçanta në vijim për zbatim të punës:

- Të kryer shkallën e arsimit VII/2 ose 300 kredite sipas EKST (Shkenca juridike)
- përvojë pune me persona të zgjedhur ose të emëruar ose zyrtarë
- zotësi për fjalim në publik dhe shprehjes me shkrim
- përvojë në të shkruarit e raporteve (materiale informative)
- njohje të gjuhës zyrtare përpos gjuhës maqedone ku flasin më së paku 20% nga qytetarët e Republikës së Maqedonisë
- më së paku njohje të dy gjuhë të Bashkimit evropian

**Kompetencat e përgjithshme:**

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- puna me të tjerë/puna ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar

**Kompetenca të posaçme:**

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frengjisht, gjermanisht)

**Kushtet shtesë:**

- përvojë në hulumtime juridike
- zotësi analitike
- aftësi për punë me njerëz me qëndrime të ndryshme
- angazhim për paanësi dhe transparencë

**Orari i punës :**

- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 08:30 - 16:30

Rroga neto: 25.023,00 denarë

**VËREJTJE:** Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Turk(e) 1.

7. UPR0101V0100 Këshilltar - hulumtues dhe analist në ekonomin e tregut, Njësia për analiza të përgjithshme dhe hulumtime, Sektori për analiza të përgjithshme, hulumtime dhe eurointegrime në Njësinë speciale organizative - Instituti parlamentar — 1 realizues(ë)

**Kushtet e përgjithshme:**

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

**Kushtet e posaçme:**

- nilevi i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi sipas ECTS, ose të kryer shkallës VII/1, Shkencat organizuese dhe menaxhim(menaxhment) ose shkenca ekonomike
- së paku 3 (tre) vjet përvojë pune në profesion

Gjatë përzgjedhjes përparësi do të kenë kandidatët të cilët i plotësojnë edhe kushtet e veçanta në vijim për zbatim të punës:

- Të kryer shkallën e arsimit VII/2 ose 300 kredite sipas EKST (Shkencat organizuese dhe menaxhim(menaxhment) ose shkenca ekonomike)
- përvojë pune me persona të zgjedhur ose të emëruar ose zyrtarë
- zotësi për fjalim në publik dhe shprehjes me shkrim
- përvojë në të shkruarit e raporteve (materiale informative)
- njohje të gjuhës zyrtare përpos gjuhës maqedone ku flasin më së paku 20% nga qytetarët e Republikës së Maqedonisë
- më së paku njohje të dy gjuhë të Bashkimit evropian

**Kompetencat e përgjithshme:**

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- puna me të tjerë/puna ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar

**Kompetenca të posaçme:**

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frengjisht, gjermanisht)

**Kushtet shtesë:**

- përvojë nga implementimi i hulumtimeve ekonomike
- zotësi analitike
- aftësi për punë me njerëz me qëndrime të ndryshme
- angazhim për paanësi dhe transparencë

**Orari i punës :**

- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 08:30 - 16:30

Rroga neto: 25.023,00 denarë

**VËREJTJE:** Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.

Kushtet e lartpërmendura në shpallje kandidatët duhet t'i plotësojnë në momentin e aplikimit në formë elektronike nëpërmjet profilit të përdoruesit të krijuar në faqen e internetit të Agjencisë së Administratës.

Afati i aplikimit zgjatë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e publikimit të shpalljes. Pas mbarimit të afatit për aplikim, shpallja do të jetë e larguar nga faqja e internetit e Agjencisë.

Pas kalimit të afatit të aplikimit, shpallja do të jetë e hequr nga faqja e internetit e Agjencisë.

Kandidatëve u kërkohet fletëparaqitjen ta plotësojnë në tërësi, të jenë precizë dhe të japin të dhëna të sakta. Kandidatët e paraqitur në shpalljen publike në faqen e internetit të Agjencisë së administratës do të informohen, për kohën dhe vendin e mbajtjes së çdo faze të ardhshme të procedurës për selektim të nëpunësit administrativ.

Faza e 1 – rë: selektimi administrativ realizohet në një afat prej 15 ditësh pas mbarimit të shpalljes së publikuar.

Faza e 2 – të: provimi i nëpunësit administrativ realizohet në një afat jo më të shkurtër se 10, dhe jo më të gjatë se 30 ditë pas mbarimit të fazës së 1 – rë. Ai incizohet dhe emetohet drejtpërdrejtë në faqen e internetit të Agjencisë së administratës.

Faza e 3 – të: kontrollimi i vërtetësisë së provave dhe intervista realizohet në një afat prej 10 ditësh pas mbarimit të fazës së 2 – të.

REPUBLIKA E MAQEDONISË
AGJENCIA E ADMINISTRATËS

Në bazë të nenit 35 të Ligjit të Nëpunësve Administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 27/14, 199/14, 48/15, 154/15, 5/16, 142/16 dhe 11/18) dhe Rregullores së mënyrës së zbatimit të procedurës për punësim të nëpunësve administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 27/18), lidhur me nenin 20-g të Ligjit të punësuarve në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 27/14, 199/14, 27/16 dhe 35/18) dhe Rregullores së elementeve të obligueshme të shpalljes publike të plotësimit të vendit të punës në sektorin publik përmes punësimit dhe fletëparaqitjes për punësim, si dhe të formës, përmbajtjes dhe mënyrës së mbajtjes së regjistrit të personave që kanë dhënë të dhëna të rrejshme gjatë punësimit në sektorin publik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 34/15), Agjencia e Administratës publikon

## SHPALLJE PUBLIKE NUMËR – 36/2018

për punësimin e 5 nëpunësve shtetëror nga grupi I, nëngrupi I në „Drejtorinë e Mbrojtjes dhe të Shpëtimit "për vendet e punës në vijim:

1. UPR0101B02000 Udhëheqës i sektorit për çështje financiare — 1 realizues(ë)

### Kushtet e përgjithshme:
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

### Kushtet e posaçme:
- niveli i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi, sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, Shkenca ekonomike
- më së paku 5 (pesë) vjet përvojë pune në profesion, ku së paku 2 (dy) vjet udhëheqës në vend pune në sektorin publik, përkatësisht së paku 8 (tetë) vjet përvojë pune në profesion, prej të cilave së paku 3 (tre) vjet në vend pune udhëheqës në sektorin privat

**Kompetencat e përgjithshme:**
- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- punë me të tjerë/punë ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara
- udhëheqje; dhe
- menaxhim financiar

**Kompetenca të posaçme:**
- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- çertifikatë e dhënies së provimit të udhëheqjes administrative
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frengjisht, gjermanisht)

### Orari i punës :
- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 07:30 - 15:30
- Përshkrimi i orarit të punës: orari i punës duke filluar në mes orës 7:30 dhe 8:30 dhe përfundimi i të njëjtit në mes orës 15:30 dhe 16:30

Rroga neto: 35.872,00 denarë

**VËREJTJE:** Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.

2. UPR0101B04000 Udhëheqës i njësisë për teknologji informatike, Sektori për pajisje materiale-teknike dhe mirëmbajtje — 1 realizues(ë)

### Kushtet e përgjithshme:
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

### Kushtet e posaçme:
- niveli i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi, sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, Teknik kompjuterike dhe informatike, Informatikë ose Inxhinieri e telekomunikacionit
- më së paku 4 (katër) vjet përvojë pune në profesion, ku së paku 1 (një) vit në vend pune në sektorin publik, përkatësisht së paku 6 (gjashtë) vjet përvojë pune në profesion, prej të cilave së paku 2 (dy) vjet në vend pune udhëheqës në sektorin privat

**Kompetencat e përgjithshme:**
- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- punë me të tjerë/punë ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara
- udhëheqje; dhe
- menaxhim financiar

**Kompetenca të posaçme:**
- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- çertifikatë e dhënies së provimit të udhëheqjes administrative
- njohjen aktive të një prej tre gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frengjisht, gjermanisht)

### Orari i punës :
- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 07:30 - 15:30
- Përshkrimi i orarit të punës: orari i punës duke filluar në mes orës 7:30 dhe 8:30 dhe përfundimi i të njëjtit në mes orës 15:30 dhe 16:30

Rroga neto: 28.303,00 denarë

**VËREJTJE:** Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.

3. UPR0101B04000 Udhëheqës i njësisë për koordinim buxhetor, Sektori për çështje financiare — 1 realizues(ë)

### Kushtet e përgjithshme:
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

### Kushtet e posaçme:
- niveli i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi, sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, Shkenca ekonomike
- më së paku 4 (katër) vjet përvojë pune në profesion, ku së paku 1 (një) vit në vend pune në sektorin publik, përkatësisht së paku 6 (gjashtë) vjet përvojë pune në profesion, prej të cilave së paku 2 (dy) vjet në vend pune udhëheqës në sektorin privat

**Kompetencat e përgjithshme:**
- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- punë me të tjerë/punë ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara
- udhëheqje; dhe
- menaxhim financiar

**Kompetenca të posaçme:**
- njohjen aktive të një prej tre gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frengjisht, gjermanisht)
- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- çertifikatë e dhënies së provimit të udhëheqjes administrative

### Orari i punës :
- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 07:30 - 15:30
- Përshkrimi i orarit të punës: orari i punës duke filluar në mes orës 7:30 dhe 8:30 dhe përfundimi i të njëjtit në mes orës 15:30 dhe 16:30

Rroga neto: 28.303,00 denarë

**VËREJTJE:** Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.

4. UPR0101B04000 Udhëheqës i njësis për çështje juridike, Sektori për çështje të përbashkëta — 1 realizues(ë)

### Kushtet e përgjithshme:
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

### Kushtet e posaçme:
- niveli i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi, sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, Shkenca juridike
- më së paku 4 (katër) vjet përvojë pune në profesion, ku së paku 1 (një) vit në vend pune në sektorin publik, përkatësisht së paku 6 (gjashtë) vjet përvojë pune në profesion, prej të cilave së paku 2 (dy) vjet në vend pune udhëheqës në sektorin privat

**Kompetencat e përgjithshme:**
- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- punë me të tjerë/punë ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara
- udhëheqje; dhe
- menaxhim financiar

**Kompetenca të posaçme:**
- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- çertifikatë e dhënies së provimit të udhëheqjes administrative
- njohjen aktive të një prej tre gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frengjisht, gjermanisht)

### Orari i punës :
- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 07:30 - 15:30
- Përshkrimi i orarit të punës: orari i punës duke filluar në mes orës 7:30 dhe 8:30 dhe përfundimi i të njëjtit në mes orës 15:30 dhe 16:30

Rroga neto: 28.303,00 denarë

**VËREJTJE:** Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.

5. UPR0101B04000 Udhëheqës i njësisë për menaxhim me burime njerëzore — 1 realizues(ë)

### Kushtet e përgjithshme:
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

### Kushtet e posaçme:
- niveli i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi, sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, Shkenca juridike
- më së paku 4 (katër) vjet përvojë pune në profesion, ku së paku 1 (një) vit në vend pune në sektorin publik, përkatësisht së paku 6 (gjashtë) vjet përvojë pune në profesion, prej të cilave së paku 2 (dy) vjet në vend pune udhëheqës në sektorin privat

**Kompetencat e përgjithshme:**
- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- punë me të tjerë/punë ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara
- udhëheqje; dhe
- menaxhim financiar

**Kompetenca të posaçme:**
- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- çertifikatë e dhënies së provimit të udhëheqjes administrative
- njohjen aktive të një prej tre gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frengjisht, gjermanisht)

### Orari i punës :
- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 07:30 - 15:30
- Përshkrimi i orarit të punës: orari i punës duke filluar në mes orës 7:30 dhe 8:30 dhe përfundimi i të njëjtit në mes orës 15:30 dhe 16:30

Rroga neto: 28.303,00 denarë

**VËREJTJE:** Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Shqiptar(e) 1.

Kushtet e lartpërmendura në shpallje kandidatët duhet t'i plotësojnë në momentin e aplikimit në formë elektronike nëpërmjet profilit të përdoruesit të krijuar në faqen e internetit të Agjencisë së Administratës.

Afati i aplikimit zgjatë 20 ditë, duke llogaritur nga dita e publikimit të shpalljes. Pas mbarimit të afatit për aplikim, shpallja do të jetë e larguar nga faqja e internetit e Agjencisë.

Pas kalimit të afatit të aplikimit, shpallja do të jetë e hequr nga faqja e internetit e Agjencisë.

Kandidatëve u kërkohet fletëparaqitjen ta plotësojnë në tërësi, të jenë precizë dhe të japin të dhëna të sakta. Kandidatët e paraqitur në shpalljen publike në faqen e internetit të Agjencisë së administratës do të informohen, për kohën dhe vendin e mbajtjes së çdo faze të ardhshme të procedurës për selektim të nëpunësit administrativ.

Faza e 1 – rë: selektimi administrativ realizohet në një afat prej 15 ditësh pas mbarimit të shpalljes së publikuar.

Faza e 2 – të: provimi i nëpunësit administrativ realizohet në një afat jo më të shkurtër se 10, dhe jo më të gjatë se 30 ditë pas mbarimit të fazës së 1 – rë. Ai incizohet dhe emetohet drejtpërdrejtë në faqen e internetit të Agjencisë së administratës.

Faza e 3 – të: kontrollimi i vërtetësisë së provave dhe intervista realizohet në një afat prej 10 ditësh pas mbarimit të fazës së 2 – të.

Në stadiumin "Filipi i dytë" do të zhvillohet derbi mes dy ekipeve nga kryeqyteti, Rabotniçki dhe FC Shkupi. Ndeshje kjo e vlefshme për pozitën e katërt, e cila qon në Liga Evropë, por në anën tjetër, për skuadrën nga Çairi kjo ndeshje është e vlefshme edhe për garën për mbijetesë

LIGA E PARË, JAVA E 31



DYSHET:
SKOPJE - PELISTERI
SILEKSI - VARDARI
RABOTNIÇKI - SHKUPI
RENOVA - A.PANDEV
POBEDA - SHKËNDIJA

# SHKUPI NË MISION TË VËSHTIRË, POR SYNON FITOREN

Koha Bujar KURTAJ

*Shkup, 27 prill* - Tani kur Shkëndija që nga java e 29 zyrtarizoi titullin e kampionit, në Ligën e parë po zhvillohet një "luftë" e madhe mes ekipeve në garën për dalje në Evropë dhe mbijetesë. Ndryshe, të dielën në stadiumin "Filipi i dytë" do të zhvillohet derbi mes dy ekipeve nga kryeqyteti, Rabotniçki dhe FC Shkupi. Ndeshje kjo e vlefshme për pozitën e katërt, e cila qon në Liga Evropë, por në anën tjetër, për skuadrën nga Çairi kjo ndeshje është e vlefshme edhe për garën për mbijetesë. Atmosfera në kampin bardhekaltër është e shkëlqyer, sidomos pas fitores ndaj Pobedës me 3-1. Me fitore FC Shkupi do ti afrohej në vetëm dy pikë skuadrës së Rabotniçkit, por ka edhe një ndeshje më pak, atë me Pelisterin, derisa edhe një pikë do tu kryente shumë punë, "pëllumbave" nga Çairi. Për këtë janë të vetëdijshëm edhe djemtë e trajnerit Zekirija Ramadani. "Ndeshja ndaj Rabotniçkit është e një karakteri shumë të rëndësishëm për mua dhe për klubin. Me fitore eventuale ndaj Rabotniçkit kemi mundësi që të vazhdojmë garën për një vend që dërgon në Evropë. Unë dhe bashkëlojtarët e mi dhe të gjithë të tjerët në klub do të japim gjithçka nga vetja dhe do ta fitojmë këtë ndeshja, ndërsa tifozët duhet të kenë besim tek ne", deklaroi Emre Xhan Atila. Ndërkohë, orari i ngjeshur i kampionatit padyshim që ka dhe koston e vet, kështu që në duelin e të mërkurës Rron Broja ka pësuar një lëndim në nyjën e këmbës që vazhdon ta ketë të ënjtur, ndërsa edhe më tej lëndimi e përcjell Bllazhe Ilijoskin dhe paraqitja e tyre të dielën do të jetë në dyshim. Por, gëzon fakti se për ndeshjen e radhës rikthehet në ekip edhe Bllagoja Ljamçevski i cili vuajti dy ndeshje shkaku i kartonit të kuq, ndërsa në 18-in do të jetë pas një pauze të gjatë shkaku i lëndimit Stefan Vujçiç.

Kampioni i ri i Maqedonisë Shkëndija, do të sfidohet nga skuadra e Pobedës. Në Prilep kuqezinjtë do të udhëtojnë për të arkëtuar tre pikë. "Më duhet ta përsëris atë që po e themi vazhdimisht se ne si profesionistë do të tentojmë deri në fund të luajmë me përqendrim maksimal, pa marrë parasysh se kampionati për ne matematikisht ka përfunduar para dy xhirove. Normal që kur e din se je kampion dhe të pret finalja e Kupës mendja edhe kërkon para kohe të përqendrohet në atë më të rëndësishmen, por punojmë vazhdimisht me stafin teknik që të jemi të koncentruar në çdo ndeshje të radhës për të kërkuar fitore dhe tre pikë. Duam secilën lojë ta shfrytëzojmë për tu përgatitur sa më mirë për atë që na pret në finalen e Kupës, por edhe pastaj në eliminatoret e Ligës së Kampionëve. Pobeda ka brengat e mbijetesës dhe e dimë se do të japin gjithçka për të marrë atë që duan, por ne do të dalim në fushë me objektivin e njejtë si gjithë sezonin, pra për të fituar", deklaroi për gazetën KOHA, Mevlan Adili. Në anën tjetër, skuadra tjetër tetovare Renova, para tifozëve të saj do të pret skuadrën e Akademia Pandev. Pikët nga kjo përballje janë të rëndësishme për të dyja skuadrat, andaj pritet të zhvillohet një betejë e madhe në fushën e gjelbër. Në përballjet tjera, Sileksi do të pret Vardarin, ndërsa "Skopje" - Pelisterin.

## Skënderbeu nuk ka besim te UEFA

Me një reagim për mediat klubi i Skënderbeut ka bërë me dije se nuk ka aspak besim te komisioni i Apelit në UEFA pas seancës së djeshme dëgjimore pranë këtij komisioni që zgjati 6 orë dhe që u morën në pyetje disa nga lojtarët aktualë por edhe ish lojtarë të skuadrës bardhekuqe. Megjithatë te Skënderbeu janë optimistë se të drejtën do ta fitojnë në KAS-in e Lozanës, teksa presin që Gjykata e Abritrazhit Sportiv t'i shpallë të pafajshëm dhe t'u heqë dënimin 10-vjeçar për mospjesëmarrje në kompeticionet evropiane dhe gjobën prej një milion eurosh që u ka vendosur UEFA.



NËSE SHKËNDIJA E FITON KUPËN

## Në Evropë edhe vendi i katërt

*Shkup, 27 prill* - Shkëndija – Pelisteri do të jetë finalja e Kupës së Maqedonisë. E përbashkëta e këtyre dy skuadrave është se asnjëherë nuk e kanë "nënvlerësuar" Kupën dhe zakonisht e kanë kërkuar atë. Rezultati i kësaj finaleje nuk u intereson vetëm dy skuadrave që do të përballen me njëra-tjetrën më 23 maj. Me interes drejt verdiktit të saj shohin edhe skuadrat e tjera të kampionatit Rabotniçki, Akademia Pandev e pse jo edhe Renova që pas eliminimit nga Kupa shikojnë të vetmen rrugë që të çon në Evropë atë nga kampionati. Me Shkëndijën e cila matematikisht ka dalë kampion dhe që luan në finalen e Kupës mundësia që edhe skuadra që përfundon kampionatin në vendin e katërt të sigurojë dalje në Evropë është reale. Pasi tre vjet më parë FFM, ka ndryshuar rregullin që çonte në eliminatoret e Ligës së Evropës finalisten e Kupës në rast së trofeu fitohej nga skuadra kampione. Rregullorja e re thotë- "Nëse klubi i shpallur kampion i LPFM-së, fiton njëkohësisht edhe Kupën e Maqedonisë, atëherë klubi i renditur në vendin e katërt në klasifikimin përfundimtar do të marrë pjesë në turrin e parë eliminator të Ligës së Evropës", bwn tw ditur "Alsat-M", transmeton KOHA. Kampionati pritet të përfundojë në 20 maj, 3 ditë para finales së Kupës dhe vendi i katërt në finalen e Kupës do t'i duhet të bëjë tifo për Shkëndijën. Po ashtu edhe në sezonin e kaluar Shkëndija dhe Pelisterit u përballën në finale ku skuadra nga Manastiri doli fituese. "Kuqezinjtë" sivjet janë duan të fitojnë dy trofetë e futbollit vendor edhe pse Kupën e kanë fituar në vitin 2016, ndërsa Pelisteri që po lufton për mbetje në elitën e futbollit vendor në finalen e pestë po kërkon të fitojë trofeun e tretë. Vardari ka 5 trofe të fituar ndërsa ish Slloga J. (sot FC Shkupi) ka më shumë finale 8 të luajtura.



## 12 klube kërkojnë zgjedhje në Federatën e Xhudos

*Shkup, 27 prill* - Dymbëdhjetë klube sportive të xhudos në Maqedoni janë bashkuar në kërkesën e tyre të vetme që të votojnë për udhëheqësinë e Federatës së Xhudos dhe të ardhmes të këtij sporti në Maqedoni. Gjegjësisht, këto 12 klube kanë ngritur iniciativë për mbajtjen e mbledhjes të jashtëzakonshme duke u bazuar në nenin 27, pika 3 nga Rregullorja e punës së Kuvendit të Federatës së Xhudos të Maqedonisë, ku si rend dite kërkojnë zgjedhjen e organeve të Kuvendit, siç janë: Kryesia e punës nga tre persona, Komisioni verifikues nga tre persona, dhe një mbajtës të proces verbalit. Gjithashtu këto klube kërkojnë edhe votëbesimin ndaj Organeve Drejtuese të Xhudo Federatës të Maqedonisë, siç janë: Kryetari, anëtarët e këshillit drejtues dhe anëtarët e komisionit Shqyrtues. Në rast se gjatë këtij votimi, kërkesat mbështeten nga shumica e delegatëve të Kuvendit dhe votohet kundër besimit ndaj këtyre organeve, atëherë në rend të ditës do të hyjnë edhe pikat për: Zgjedhjen e Komisionit Kandidues, Zgjedhjen e Kryetarit të Xhudo Federatës, Zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Drejtues dhe Komisionit për Shqyrtim dhe Zgjedhja e nënkryetarëve të XHFM. Kjo mbledhje do të mbahet në ambientet e ndërtesës së vjetër komunale, në amfiteatrin në rrugën "Pitu Guli" nr. 2 në Prilep. Sidoqoftë, Federata e Xhudos në Maqedoni po kalon momente të rënda, që nga emërtimi i Kryetarit aktual Filip Ivanov dhe stafit të tij drejtues, si dhe për shkak të vizionit për ngritjen e këtij sporti në piedestalin e merituar.

Ditë më parë, Kandidati për Kryetar në XHFM, z. Zeglul Rexhepi publikoi një letër ku u bënte thirrje klubeve që të mos humbin shpresën si pasojë e pasivitetit të XHFM-së, sepse sipas tij Asgjë nuk është pamundur. Mjafton të besojnë se me punë dhe përkushtim mund ti lëvizin gjerat përpara, z. Rexhepi shpreson se ditë më të mira e presin sportin e Xhudos në vendin tonë.

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune – teksti i pastruar (“Gazeta Zyrtare e RM” nr. 167/2015)
ud. Drejtori i NP Ujësjellësi dhe kanalizimi – Shkup
publikon

**SHPALLJE PUBLIKE**
**Për pranim të punëtorëve për kohë të pacaktuar**

Publikohet shpallje publike për themelim të marrëdhënies së punës për kohë të pacaktuar për vendet e punës në vijim:

**Sektori “Punë teknike dhe zhvillim”**

1. Vizatues teknik – përpunues – 1 realizues

**Sektori “Eksploatimi dhe mirëmbajtja e kapaciteteve”**

2. Inxhinier i pavarur - 1 realizues
3. Rojtar i objekteve – 2 realizues
4. Operator i stacioneve korinatore – 1 realizues

**Sektori “Mekanizmi”**

5. Vozitës të makinës së rëndë ngarkuese – 3 realizues
6. Drejtues të makinave të mesme ndërtimore – 1 realizues

**Sektori “Kontabiliteti, çështje financiare, furnizime publike dhe komerciale”**

7. Udhëheqës i Shërbimit të financave – 1 realizues
8. Inkasant – 3 realizues
9. Likuidues – 2 realizues
10. Arkëtar – 2 realizues

**Sektori “Punë juridike, kadrovike dhe të përgjithshme”**

11. Referent për marrëdhënie juridiko-pronësore – 1 realizues
12. Mirëmbajtës të higjienës – 3 realizues

**Kushtet e përgjithshme:**

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë
- Të jetë i moshës së rritur
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës

**Kushtet e posaçme:**

1. Për vendin e punës me numër rendor 1. Vizatues teknik – përpunues
   - arsim i mbaruar: PMP – shkalla IV – shkolla e ndërtimtarisë ose arkitekturës
2. Për vendin e punës me numër rendor 2. Inxhinier i pavarur
   - arsim i mbaruar: PSP – shkalla VII – fakulteti i makinerisë ose elektroteknikës
   - së paku 2 vjet përvojë pune
3. Për vendin e punës me numër rendor 3. Rojtar i objekteve
   - arsim i mbaruar: KU -III, PMP – shkalla IV
   - Licencë për kryerje të punëve të sigurimit të personave dhe pronës të dhënë nga Oda e Republikës së Maqedonisë për sigurim të personave dhe pronës
4. Për vendin e punës me numër rendor 4. Operator i stacioneve korinatore
   - arsim i mbaruar: PMP – shkalla IV – shkolla e makinerisë ose elektroteknike
5. Për vendin e punës me numër rendor 5. Vozitës të makinës së rëndë ngarkuese
   - arsim i mbaruar: Vozitës i kategorisë “C”
6. Për vendin e punës me numër rendor 6. Drejtues të makinave të mesme ndërtimore
   - arsim i mbaruar: KU – shkalla III
7. Për vendin e punës me numër rendor 7. Udhëheqës i Shërbimit të financave
   - arsim i mbaruar: PSP – shkalla VII – fakulteti ekonomik
   - së paku 3 vjet përvojë pune
8. Për vendin e punës me numër rendor 8. Inkasant
   - arsim i mbaruar: PMP – shkalla IV
9. Për vendin e punës me numër rendor 9. Likuidues
   - arsim i mbaruar: PMP – shkalla IV – shkolla ekonomike ose gjimnaz
10. Për vendin e punës me numër rendor 11. Arkëtar
    - arsim i mbaruar: PMP – shkalla IV – shkolla ekonomike ose gjimnaz
11. Për vendin e punës me numër rendor 12. Referent për marrëdhënie juridiko-pronësore
    - arsim i mbaruar: PSP – shkalla VII – fakulteti juridik
12. Për vendin e punës me numër rendor 13. Mirëmbajtës të higjienës
    - arsim i mbaruar: arsim fillor

**Dokumentet e nevojshme:**

1. Fletëparaqitje (Lutje)
2. Certifikatë/Diplomë për arsim të mbaruar
3. Biografi të shkurtë
4. Certifikatë të shtetësisë
5. Dëshmi për përvojë të punës (vlen vetëm për vendin e punës me numër rendor 2. Inxhinier i pavarur dhe për vendin e punës me numër rendor 7. Udhëheqës i Shërbimit të financave)

- Orari ditor i punës prej ora 07:30-15:30.
- Orari javor i punës 40 orë pune (prej ditës së hënë deri ditën e premte).
- Pagesa bazë:

- për vendin e punës me numër rendor 1. Vizatues teknik – përpunues është 19.068,00 denarë
- për vendin e punës me numër rendor 2. Inxhinier i pavarur është 26.423,00denarë
- për vendin e punës me numër rendor 3. Rojtar i objekteve është 19.340,00 denarë
- për vendin e punës me numër rendor 4. Operator i stacioneve korinatore është 19.885,00 denarë.
- për vendin e punës me numër rendor 5. Vozitës të makinës së rëndë ngarkuese është 20.430,00 denarë.
- për vendin e punës me numër rendor 6. Drejtues të makinave të mesme ndërtimore është 19.068,00 denarë.
- për vendin e punës me numër rendor 7. Udhëheqës i Shërbimit të financave është 29.147,00 denarë.
- për vendin e punës me numër rendor 8. Inkasant është 20.158,00 denarë.
- për vendin e punës me numër rendor 9. Likuidues është 20.158,00 denarë.
- për vendin e punës me numër rendor 10. Arkëtar është 20.158,00 denarë
- për vendin e punës me numër rendor 11. Referent për marrëdhënie juridiko-pronësore është 26.423,00 denarë
- për vendin e punës me numër rendor 12. Mirëmbajtës të higjienës është 17.706,00 denarë

Shpallja publike zgjat 5 (pesë) ditë pune llogaritur nga dita e publikimit në shtypin ditor.

Nëse në shpalljen publike paraqiten deri në 200 kandidatë për një vend pune zgjedhja do të realizohet në afat prej 45 ditëve, prej 201 deri në 500 kandidatë për një vend pune zgjedhja do të realizohet në afat prej 90 ditë dhe mbi 500 kandidatë për një vend pune zgjedhja do të realizohet në afat prej 120 ditë, pas kalimit ë afatit për paraqitje.

Dokumentacioni i dorëzuar pas afatit dhe i pakompletuar nuk do të merret parasysh.

Fletëparaqitjet së bashku me dokumentacionin e nevojshëm kandidatët duhet ti dorëzojnë në NP Ujësjellësi dhe kanalizimi – Shkup në adresën “Llazar Liçenoski” nr. 9 - Shkup.

Telefon për kontakt 02/30 73 010 lok. 316; kontakt personi: Darko Donevski;

---

Në bazë të nenit 28 të Statutit të Shoqërisë aksionare Ekonomia e ujërave të Republikës së Maqedonisë në pronësi të shtetit (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 187/2015, 94/16 dhe 158/16) dhe nenit 2 të Rregullores për kushtet, mënyrën dhe procedurën për shitje të materialit të nxjerrë shkarkues – rërë, zhavorr dhe gurë nga shtrati i lumit të Shoqërisë aksionare Ekonomia e ujërave të Republikës së Maqedonisë, në pronësi të shtetit, Shkup përmes ankandit publik me gojë nr. 0202-3572 të datës 30.09.2016, Drejtori gjeneral ekzekutiv i Shoqërisë aksionare Ekonomia e ujërave të Republikës së Maqedonisë, në pronësi të shtetit, Shkup në vijim ka sjellë këtë:

**VENDIM**
**Për shitjen e materialit shkarkues**

**Neni 1**

Në bazë të Pëlqimit të Ekonomisë së ujërave për rregullim të një pjese të shtratit të Lumit Pçinja, aksi Novo Sellë-Kumanovë, lokacioni i PK 4885 KK Vince dhe PK 3540/1 KK Studena Bara në Komunën e Kumanovës dhe PK 2208/1 LL Kojnare e Epërme në Komunën e Petrovecit me gjatësi prej 2896.78 metra, rrjedha lumore e Vardarit, të dhënë nga Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, nr. UP 1-11/5-185/2018 të datës 30.03.2018 është lejuar nxjerrja e materialit tepricë të lumit (rërë, zhavorr dhe gurë) nga shtrati i Lumit Pçinja dhe lëshimit e tij në qarkullim të Shoqërisë aksionare Ekonomia e ujërave të Republikës së Maqedonisë, në pronësi të shtetit, Shkup.

**Neni 2**

Materiali tepricë shkarkues do të mënjanohet nga shtrati i Lumit Pçinja aksi Novo Sellë-Kumanovë, lokacioni i PK 4885 KK Vince dhe PK 3540/1 KK Studena Bara në Komunën e Kumanovës dhe PK 2208/1 LL Kojnare e Epërme në Komunën e Petrovecit me gjatësi prej 2896.78 metra, rrjedha lumore e Vardarit, për shkak të rregullimit të regjimit të ujërave.

**Neni 3**

Materiali i nxjerrë shkarkues – rërë, zhavorr dhe gurë i cili do të mënjanohet dhe lëshohet në qarkullim nuk guxon të kalojë sasinë prej 308.061,93 m3.

Shitja e materialit të nxjerrë shkarkues – rërë, zhavorr dhe gurë nga shtretërit e lumit do të realizohet përmes ankandit publik me gojë.

**Neni 4**

Çmimi fillestar i materialit të nxjerrë shkarkues – rërë, zhavorr dhe gurë nga shtrati i lumit është 45,oo denarë plus 7 % kompensim për ujërat plus 18% TVSH.

**Neni 5**

Procedura do të realizohet me publikimin e thirrjes publike për shitjen e materialit shkarkues – rërë, zhavorr dhe gurë nga shtretërit e lumit në dy gazeta ditore prej të cilave një që publikohet në gjuhën maqedonase dhe një që publikohet në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve që flasin gjuhë zyrtare ndryshe nga gjuha maqedonase.

**Neni 6**

Anëtarët dhe zëvendës anëtarët e komisionit që do të publikojë thirrjen publike dhe do të realizojë procedurën për ankand publik janë:

1. Andrea Najdenovski, Kryetar
   Sibela Markova, Zëvendës kryetar
2. Krsto Danillovski, anëtar
   Boban Piperkovski, zëvendës anëtar
3. Kosta Mallzarkov, anëtar
   Martin Malinovski, zëvendës anëtar
4. Elena Georgijevska, anëtar
   Nikolla Denkovski, zëvendës anëtar
5. Mirjana Çemkova, anëtar
   Mare Sllavevska, zëvendës anëtar

**Neni 7**

Pas procedurës së realizuar për shitje të materialit shkarkues – rërë, zhavorr dhe gurë nga shtretërit e lumit, Komisioni obligohet deri te Drejtori gjeneral ekzekutiv të parashtrojë propozim për zgjedhje të ofertuesit më të volitshëm ose propozim për anulim të procedurës.

Parashtruar deri te:
-Anëtarët e grupit të punës
- Arkivi

**SHA “Ekonomia e ujërave të RM” – Shkup**
**Drejtori gjeneral ekzekutiv**
**Ilmi Selami**

---

**REPUBLIKA E MAQEDONISË**
**KOMUNA E KUMANOVËS**

**Sektori për urbanizëm, veprimtari komunale dhe mbrojtje të mjedisit jetësor dhe natyrës**

21-2932/3
26.04.2018

Në bazë të nenit 35 paragrafi 3 të Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik (“Gazeta Zyrtare e RM” nr. 199/14, 44/15, 193/15 ,31/16 dhe 163/16 ), nenit 50 paragrafi 1 pika 4 e Ligjit për vetëqeverisje lokale (“Gazeta Zyrtare e RM” nr. 5/02) dhe nenit 25 paragrafi 1 pika 7 e Statutit të Komunës së Kumanovës (“Fleta Zyrtare e Komunës së Kumanovës” nr. 13/03, 13/07 dhe 8/15), Kryetari i Komunës së Kumanovës në vijim publikon këtë:

**LAJMËRIM**

Për organizim të Anketës publike dhe Prezantimit publik në lidhje me

1. PAU të PK 20/33 me qëllim A1 banim në shtëpi banesore, fshati Biljanovc KK Biljanovc – Komuna e Kumanovës, dokumentacioni teknik nr. U-24/17 të punuar nga “URBAN GIS” SHPK – Kumanovë
2. PAU të PK 711/3 me qëllim A1 banim në shtëpi banesore, fshati Donrshan KK Dobërshan – Komunae Kumanovës, dokumentacioni teknik nr. 55/017 të punuar nga “EDNA” SHPKNJP – Shkup

Anketa publike dhe Prezantimi publik në lidhje me Propozim PDU-e do të realizohet me ekspozimin e Propozim PDU-e në Sirtarët e komunës në Shesin e qytetit, që gjendet tek ish “Tutun” – Kumanovë.

Anketa publike do të **zgjasë 5 ditë pune** duke filluar nga **07.05.2018 deri më 11.05.2018.**

Për kohëzgjatjen e anketës publike subjektet e interesuara fizike dhe juridike informacione më të detajuara mund të marrin në Komunën e Kumanovës, Sektori për urbanizëm dhe veprimtari komunale dhe mbrojtje të mjedisit jetësor dhe natyrës.

Gjatë anketës publike propozimet ose vërejtjet e tyre mund të parashtrojnë të gjitha subjektet e interesuara fizike dhe juridike në listat anketuese.

**PREZANTIMI PUBLIK**

Më **datë 09.05.2018 në ora 12$^{00}$**, në sallën e takimeve në Komunën e Kumanovës organizohet Prezantim publik me prezantim profesional të Projektit Arkitektonik Urbanistik të PK 20/33 me qëllim A1 banim në shtëpi banesore, fshati Biljanovc KK Biljanovc – Komuna e Kumanovës, dokumentacioni teknik nr. U-24/17 të punuar nga “URBAN GIS” SHPK – Kumanovë, PAU të PK 711/3 me qëllim A1 banim në shtëpi banesore, fshati Donrshan KK Dobërshan – Komunae Kumanovës, dokumentacioni teknik nr. 55/017 të punuar nga “EDNA” SHPKNJP – Shkup

Kryetari i Komunës
Maksim Dimitrievski

ASHTU SIÇ ISHTE PARALAJMËRUAR



“Nuk e imagjinoja kurrë se do të arrija ato që kam arritur këtu. Është një klub i mrekullueshëm. Nuk ka qenë një vendim i lehtë për t’u marrë. Kam folur me shumë njerëz para se të bindesha”, ka thënë mesfushori spanjoll

# INIESTA MES LOTËVE ZYRTARIZON LARGIMIN NGA BARCELONA

Andres Iniesta, pas 670 ndeshjes dhe 31 trofeve të fituar, ka zyrtarizuar largimin e tij nga Barcelona në një konferencë për shtyp, e cila po zhvillohet aktualisht. “Nuk e imagjinoja kurrë se do të arrija ato që kam arritur këtu. Është një klub i mrekullueshëm. Nuk ka qenë një vendim i lehtë për t’u marrë. Kam folur me shumë njerëz para se të bindesha”, ka thënë mesfushori spanjoll. Kapiteni i Barcelonas është pyetur edhe në lidhje me faljet që i ka kërkuar “France Football” për faktin se nuk e ka vlerësuar atë me “Topin e Artë”: “Nuk është një problem për mua dhe nuk do të jetë një peng. Kam fituar shumë në karrierën time”. Në lidhje me aventurën e ardhshme: “Nuk doja të qëndroja në Evropë, sepse nuk doja të luaja kundër Barçës”, tha Iniesta. Konferenca është ndërprerë në një moment për shkak se gazetarët e pranishëm i kanë dedikuar një duartrokitje të përbashkët, gjë që e ka befasuar dhe emocionuar akoma më shumë Iniestan, i cili ka vazhduar më pas me falënderimet. Nuk mund të mungonte një mesazh për Leo Messin, shoku i shumë betejave. “Ka qenë një nder dhe një privilegj që kam luajtur me të. Nuk ka asnjë si ai. Është një pjesë thelbësore e këtij klubi dhe ka qenë një eksperiencë unike për mua që kam luajtur gjithë këto vite me të”, përfundoi Iniesta.



## Emery njofton largimin nga PSZH-ja

Unai Emery konfirmoi dje në mëngjes, në një konferencë për shtyp, se nuk do të jetë më trajner i PSZH-së, kur ky sezon të përfundojë. “Unë pata një takim vetë i tretë, me Antero dhe Al-Khelaifi. Aty vendosëm se ishte më e mirë për të gjithë të vepronim kështu. Do të largohem që këtu duke pasur një marrëdhënie të mirë me të gjithë, plot respekt të ndërsjellë”, – informoi trajneri spanjoll në konferencën për shtyp. Në fakt, fati i Unai Emery në “Parce des Princes” u vendos pas eliminimit nga Liga e Kampionëve, kundër Real Madridit, që në 1/8 finale. Shtypi francez ka spekuluar mbi disa kandidatë për stolin parisien, si Tomas Tuçel, Antonio Konte dhe Maks Alegri. Emery, i cili do ta përfundojë kontratën këtë qershor, është vendosur si favorit për stolin e Real Sosiedad. “Në të tashmen, apo në të ardhmen, Real Sosiedad gjithmonë më pëlqen mua”, – pati thënë Emery javë më parë. Trajneri spanjoll arriti në Paris në vitin 2016, pas suksesit me Sevilja, dhe do të largohet pas dy sezoneve, me disa trofe kombëtarë të fituar.

Publicitet

Në bazë të nenit 22 dhe nenit 23 të Ligjit për marrëdhënie pune, nenit 77-a të Ligjit për kulturë dhe pëlqimit të Ministrisë së financave të RM nr. 18-3995/2 të datës 04.04.2018, U.D Drejtori i Shtëpisë së kulturës “Jane Sandanski” – Novo Sellë, publikon:

**SHPALLJE PUBLIKE nr. 01/18**
**Për plotësimin e vendit të lirë të punës**

1.Dokumentarist – teknik me shifër KUL 0304 GJ01002, (një realizues)
Marrëdhënia e punës themelohet për kohë të pacaktuar dhe me orar të plotë të punës.
Orari i punës fillon prej ora 07,00 deri në ora 15,00, prej ditës së hënë deri ditën e premte.
Neto pagesa për këtë vend pune është 18.000,00 denarë.
Secili prej kandidatëve duhet të përmbushë kushtet e përgjithshme:
-të jetë shtetas i RM
-të jetë i moshës së rritur
-me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.
Kushtet e posaçme të përcaktuara në Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës:
-Arsimi i mesëm gjimnaz ose turizëm dhe hoteleri
-përvojë e punës së paku 2 vjet
Kandidatët për punësim paraqiten në shpalljen publike duke plotësuar fletëparaqitjen për punësim dhe me parashtrimin e dokumenteve në vijim:
-biografi të shkurtë
-diplomë ose certifikatë për arsim të mbaruar (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter),
-certifikatë të shtetësisë (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter)
-vërtetim nga gjykata se me vendim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter).
Shpallja zgjatë 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit.
Fletëparaqitja së bashku me dokumentacionin e nevojshëm të parashtrohet deri në Shtëpia e kulturës “Jane Sandanski” – Novo Sello, rr. “Marshall Tito” pn.

Shtëpia e kulturës “Jane Sandanski” – Novo Sello
U. D Drejtor,
Zvonko Tilev

I. Nr. 324/2014

**SHPALLJE PUBLIKE**
**(në bazë të nenit 46-b, të Ligjit për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për përmbarim, Gazeta Zyrtare nr. 8 të datës 17.01.2008)**

Përmbaruesi Vanço Markovski duke vepruar me propozim të kreditorit Eshref Ajruli, përmes aut. avokatit Branko Trajkovski nga Tetova dhe vendbanim në rr. Drenoec – Poroj nr. 8, kundër borxhliut Husein Memedi nga Tetova me vendbanim në rr. Lubo Bozhinovski Pish nr. 69, dhe borxhliut pengmarrës Imer Shaqiri nga Tetova me vendbanim në rr. Lubotenska nr. 69 në Tetovë, për shkak të realizimit në holla në shumë prej 24.600.000,00 denarë **më datë 23.04.2018**

**FTON**

Borxhliun pengmarrës Imer Shaqiri nga Tetova me vendbanim në rr. Lubotenska nr. 69 në Tetovë të paraqitet në zyrën e përmbaruesit Vanço Markovski në rr. Ilindenska nr. 64 Tetovë, për parashtrim të akteve në vijim:
- Procesverbal për shitje të dytë të pronës së patundshme përmes ankandit publik me gojë I. nr. 324/2014 të datës 26.02.2018;
- Konkluzion për shitje të patundshmërisë në ankandin publik me gojë I. nr. 324/2014 të datës 27.02.2018;
- Procesverbal I nr. 321/2014 të datës 02.03.2018, të përpiluar në bazë të nenit 84 paragrafi 8 të LP;
- Konkluzion për shitjen e realizuar I nr. 324/2014 të datës 16.03.2018;
- Konkluzion për dhënie në pronësi I nr. 324/2014 të datës 21.03.2018;
- Konkluzion për anulim të përmbarimit I nr. 324/2014 të datës 04.04.2018;
- Konkluzion për përcaktimin e kohës së ndarjes I. nr. 324/2014 të datës 20.04.2018;

**NË AFAT PREJ 1 (NJË) DITE**, duke llogaritur nga dita e publikimit të fundit të kësaj thirrje publike në shtypin ditor.
**PARALAJMËROHET** borxhliu pengmarrës Imer Shaqiri se mënyra e këtillë e dorëzimit llogaritet si dorëzim në rregull dhe se për pasojat negative që mund të dalin i bartë vet pala.
Kjo shpallje paraqet **PUBLIKIMIN E KATËRT** të thirrjes publike

**PËRMBARUES**
**Vanço Markovski**

Në shpalljen për parashtrimin e ofertave për ekskursion për SHFK “Toli Zordumis” Kumanovë, të publikuar në gazetën ditore Koha më datë 27.04.2018, është bërë gabim në pjesën 4. Lëndë e furnizimit me numër rendor 2 – në vend të tre ditë duhet të qëndrojë pesë ditë.

Nga Komisioni për realizim të ekskursioneve

Shitet toke në Shkup, nga bashkëpronarët Stefanovski Dobre pronar i 2/6 pjesë ideale, Stefanovski Zlatko pronar i 1/6 pjesë ideale dhe Stefanovski Zoran pronar i 1/6 pjesë ideale, e cila gjendet në Radishani, edhe atë;
-PK 3756, vendi i quajtur Borinarec, me sipërfaqe prej 8908m2, e regjistruar ne Flet pronësi nr. 3153 për KK Radishani .
Të interesuarit dhe të gjithë ata që kufizohen me parcelën në fjalë, ofertat e tyre mund ti paraqesin në zyrën e Noterit Mahir Ziberit, rr. Butelska nr. 4, Shkup-Butel.



## Rikthehet në stërvitje pas 17 muajsh

Santi Kazorla ditën e enjte ishte në fushën "Emirates" për të zhvilluar një seancë të lehtë stërvitore në prag të gjysmëfinales së "Europa League" ndaj Atletiko Madridit. Mesfushori spanjoll herën e fundit që ka luajtur për klubin ka qenë në tetor të 2016 dhe që prej asaj kohe ka qenë në infermieri. 33-vjeçari i është nënshtruar disa operacioneve në kaviljen e djathtë dhe ka humbur tetë centimetra nga tendina, teksa një infeksion rrezikoi të amputonte këmbën. Një tjetër dëmtim në janar ka vonuar rikthimin e spanjollit por mesa duket tani është në rrugën e duhur për t'u riaftësuar 100 për qind. Ai është stërvitur me një pjesëtar të stafit të Arsenalit dhe përveç stërvitjes atletike ka bërë edhe disa ushtrime me topin në këmbë. Një lajm që do të ketë kënaqur së tepërmi tifozët e ekipit londinez.



E ÇUDITSHME NË SPANJË

## Gjyqtari “plaçkiste” lojtarët!

Gjykata në Xinizio de Lima ka dënuar gjyqtarin Jose Alberto A. M, gjithashtu punonjës i policisë, që ka përfituar nga roli i tij i gjyqtarit në “kampionatin e veteranëve” për t'i vjedhur paratë futbollistëve në pesë qytete spanjolle Cea, Cartelle, Sarreaus, A Peroksa dhe San Cibrao das Vinas. Nga maji deri në nëntor të vitit 2015, ai arriti të vjedhë një shumë totale prej 1795 eurosh, derisa u kap në flagrancë dhe u detyrua të dilte para gjykatës. Ai do ta kthejë gjithë këtë shumë, për më tepër do të paguajë edhe një gjobë prej 2200 eurosh, e cila do t'i shmangë dënimin prej 9 muajsh heqje lirie, ashtu si e parashikon ligji spanjoll. Çuditërisht, pavarësisht nga ky veprim, gjyqtarin nuk është pezulluar nga Federata Spanjolle e Futbollit dhe vazhdon të gjykojë në kategoritë amatore, por jemi të bindur se ekipet do ta mbyllim me çelës dhomën ku do të ndërrohen.



# FUTBOLLISTI QË DËSHTOI TE REAL MADRIDI PO SHKËLQEN SI KËNGËTAR!

Elvir Baljiç, i blerë në vitin 1998, për një shifër rreth 20 milionë euro, luajti vetëm 12 ndeshje me “Los Blancos” dhe shënoi vetëm një gol. Por tani vjen revanshi edhe për të. Pikërisht kështu, pasi u bë i famshëm si blerja më e keqe e historisë së Realit, ai ka nisur një karrierë tjetër, pasi vari këpucët në gozhdë, shumë të suksesshme. Në fakt, Baljiç iu përkushtua muzikës së lehtë dhe tani është këngëtari më i dashur në Ballkan dhe videot e tij në “Youtube” kanë miliona ndjekës



Gabimet në merkato, herët a vonë, i provojnë të gjithë. Kjo vlen dhe për të lavdishmin Real Madridin, që ka gjërat e tij për të fshehur. Jo të gjithë futbollistët që kanë zbritur në “Santiago Bernabeu” kanë treguar se kanë qenë në nivelin e duhur për të luajtur në këto nivele. Disa prej tyre janë larguar dhe kanë shkëlqyer gjetkë, ndërsa të tjerë kanë vazhduar një karrierë gjithsesi dinjitoze, por ka edhe nga ata që janë tërhequr. Elvir Baljiç, i blerë në vitin 1998, për një shifër rreth 20 milionë euro, luajti vetëm 12 ndeshje me “Los Blancos” dhe shënoi vetëm një gol. Por tani vjen revanshi edhe për të. Pikërisht kështu, pasi u bë i famshëm si blerja më e keqe e historisë së Real Madridit, boshnjaku ka nisur një karrierë tjetër, pasi vari këpucët në gozhdë, shumë të suksesshme. Në fakt, Baljiç iu përkushtua muzikës së lehtë dhe tani është këngëtari më i dashur në Ballkan dhe videot e tij në “Youtube” kanë miliona ndjekës. Tani, në kërkimet në internet, veç disa ndeshjeve sporadike me Rajo Valekanon, Fenerbahçen dhe Gallatasarajin shfaqen shumë suksese muzikore. Le të themi një lloj ngjashmërie me jetën e të madhit Julio Iglesias, i cili u bë evropiani që ka shitur më shumë disqe në historinë e muzikës, edhe pse deri në moshën 19 vjeç ishte portieri i Real Madrid. Sigurisht që nuk ishte shumë e vështirë për Baljiç që të kishte më shumë sukses në muzikë sesa në futboll, sepse ai konsiderohet si një nga blerjet më të dështuara të historisë së Real Madridit, në kohën kur trajner ishte Xhon Tohak, por që u largua nga Del Boske, edhe pse figuron si fitues i Ligës së kampionëve 1999-2000, sepse luajti 79 minuta në atë sezon me “merengues”. Kësisoj, nuk është gabim të thuhet se “disku i artë”, nëse do të fitohet nga Baljiç, do të jetë më i merituar se trofeu i "Champions League".

## Tifozi bën tatuazh fanellën e skuadrës së zemrës

Hose Maurisio Dos Anjos, tifoz i pakushtëzuar i Flamengos, ka ndarë përmes rrjeteve sociale vendimin e tij për të bërë tatuazh fanellën e ekipit të tij të zemrës. Braziliani tregoi 32 seancat e tij deri në rezultatin përfundimtar, ndërkohë që tatuazhi i plotë i kushtoi rreth 200 $. Fotot e lëkurës nga mesi deri të qafa, që duket si të ketë veshur fanellën e Flamengos, janë bërë menjëherë virale në rrjetet sociale. “Njerëzit më pyesin nëse nuk është e çuditshme që gjithmonë të veshësh fanellën e Flamengos dhe e vërteta është “jo”. Për mua është mëse normale. Jam i sigurt se kurrë në jetë nuk do të pendohem për këtë tatuazh”, – tha për “The Sun” tifozi më i veçantë në botë, falë pikturimit që i bëri trupit të tij.



PASI NUK GJEN VEND PËR PARKING

## Ranieri nuk shkon në festën e ekipit

Trajneri i Nantes, Klaudio Ranieri, ka dhënë një arsye të çuditshme për mungesën e tij gjatë festës për 75 vjetorin e klubit francez. Në fakt, shtypi francez kishte shkruar për një ftohje të tij me drejtuesit e Nantes, por ka qenë vetë ish-trajneri i Leiçester që ka shuar çdo thashetheme për të ardhmen. “Kur mbërrita në vendin ku do të zhvillohej festa, kishte aq shumë makina në parking që nuk munda të gjej vend. Në atë pikë i telefonova presidentit dhe i thashë se po largohesha. Më pas shkova në aeroport dhe mora një avion privat për në Londrës, sepse kisha disa probleme hidraulike në apartamentin tim, si pasojë e shiut që ra në ditët e fundit”, – deklaroi Ranieri për “Le Figaro”.

Ranieri ka edhe një vit kontratë me Nantes, por jashtë shtuar zërat për largimin e tij, gjithsesi trajneri deklaroi. “Nuk them asgjë, vetëm se jam trajner i Nantes dhe vitin tjetër do të jem sërish këtu”.



## DASHI 21. mars - 20. prill

Dita e sotme për çiftet pritet të jetë shumë premtuese. Venusi do iu bëjë ta shijoni sa më shumë lidhjen tuaj. Shprehini sa më shumë ndjenjat. Edhe beqarët do kalojnë një ditë të bukur, megjithëse nuk do kenë dëshirë të fiksohen. Ditë ideale për aventura. Situata financiare do jetë e mirë dhe ju do keni fat me shumicë.

## DEMI 21. prill - 21. maj

Gjatë kësaj dite partneri/ja nuk do ketë shumë besim tek ju dhe do kërkojë t'iu kontrollojë. Nëse nuk iu pëlqen gjeni mënyrën e duhur për t'ia thënë. Mërkuri do influencojë pozitivisht tek jeta e beqarëve. Financat në përgjithësi do jenë të mira.

## BINJAKET 22. maj - 21. qershor

Gjatë gjithë kësaj dite nuk do jeni me humor shumë të mirë. Nëse keni ndonjë vërejtje ndaj partnerit/es sqarojini gjërat sa më parë. Beqarët ka shumë gjasa të takojnë personin e ëndrrave. Mos e lini këtë mundësi t'iu ikë nga duart. Situata financiare nuk do jetë aspak e favorshme.

## GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik

Do e keni më të lehtë të jetoni pranë atij që doni sot. Saturni do iu ndihmojë të qëndroni gjatë gjithë kohës në humor. Edhe partneri/ja do iu ndihmojë ta ngrohni atmosferën. Beqarët do mendojnë vetëm të gjejnë dikë dhe të krijojnë familje. Prisni edhe pak! Mos i lini pas dore mundësitë qe do iu jepen sot në planin financiar. Përfitoni.

## LUANI 23. korrik - 22. gusht

Urani do ndikojë negativisht sot në jetën tuaj në çift. Do keni shumë mosmarrëveshje dhe zënka të forta. Komunikimi do të zbehet dita ditës. Nëse ju beqarë doni të bëni për vete dikë që iu pëlqen prej kohësh tregohuni vetvetja dhe mos bëni asgjë false. Falë influencës së mirë planetare financat do fillojnë të stabilizohen.

## VIRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator

Sot do bëni gjithçka për të dashurin e zemrës suaj. Do gjeni fjalët e përshtatshme dhe do i jepni atij/asaj ngrohtësinë e dëshiruar. Edhe vetë do ndiheni mjaft mirë! Për beqarët nuk do vijë momenti që ata kanë ëndërruar por gjithsesi do fillojnë të hedhin hapat e para drejt dashurisë. Tek financat planetët do iu sjellin fat dhe do iu mbrojnë.

## PESHORJA 24. shtator - 23. tetor

Mos u tregoni shumë mosbesues kundrejt partnerit/es tuaj sot. Nëse ju e ruani në çdo hap që hedh ai edhe mund të mërzitet. Beqarët do fillojnë të pëlqejnë një koleg pune. Edhe ai ka kohë që iu pëlqen. Dita e sotme do jetë e mrekullueshme në sektorin financiar.

## AKREPI 24. tetor - 22. nëntor

Gjatë kësaj dite do përjetoni një ndjenjë pasigurie në jetën në çift. Nëse kjo lidhje nuk iu jep kënaqësinë që prisni është më mirë t'i jepni fund. Beqarët nga ana tjetër jo vetëm që do kenë takime, por do jenë edhe pasionantë. Për financat do shqetësoheni sepse ato nuk do jenë në gjendje të mirë.

## SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor

Nëse keni tashmë një lidhje, marrëdhënia me partnerin/en tuaj do jetë më sensuale dhe pasiononte sesa zakonisht. Beqarët edhe pse jo me qëllim do e ngatërrojnë dashurinë me punën. Në sektorin e financave do keni më shumë besim tek vetja dhe do gjeni mundësitë e duhura për t'ia dalë mbanë.

## BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar

Pasioni në çift do të rindizet gjatë kësaj dite dhe ju do ndiheni si mbi re. Edhe ata që kanë pasur debate dhe mosmarrëveshje kohët e fundit do i zgjidhin dhe do rivendosin komunikimin. Beqarët duhet t'i shprehin ato që ndjejnë për dikë vetëm kur të jenë të sigurt. Do iu duhet të bëni disa shpenzime urgjente, kujdes.

## UJORI 21. janar - 19. shkurt

Ambienti yjor do favorizojë dashurinë e çifteve. Do jeni edhe më sensualë dhe pasionontë gjatë kësaj dite si dhe do merrni vendime të rëndësishme. Beqarët nuk duhet të tentojnë të joshin persona që kanë një lidhje sepse do vuajnë vetë. Financat do jenë të mira. Momenti ideal për të kryer investime.

## PESHQIT 20. shkurt - 20. mars

Dashuria do iu verbojë gjatë kësaj dite dhe mund të dilni nga vetja juaj. Kujdes, mos bëni gjithçka që iu thotë partneri/ja sepse do të pendoheni shpejt. Nëse beqarët duan të gjejnë dashurinë duhet të lënë mënjanë tekat. Tregohuni më të hapur ndaj ftesave që do iu bëhen. Financat nuk do jenë të mira.




# FJALËKRYQ KLASIK



***HORIZONTALISH:*** **1.** Veçova; **6.** Hapsirë e madhe me ujë të kripur; **10.** Mashtrim, batakçillëk; **12.** Tantal; **13.** Shkrues i analeve; **14.** Qytet në Iran; **15.** Caqe, kufij; **16.** Shkrimtari ynë, Fan Stilian; **17.** Xhaxhai; **18.** Avio-kompani Etiopiase; **19.** Shpirt, zemër (bised.)(fem.); **21.** Letër karboni, kopjativ; **24.** Dru frutor i vendeve të ngrohta; **25.** Që ka titull profesional-shkencor; **26.** Dante Aligeri; **27.** Ngurtësimi i në organi ose një indi (mjek.); **28.** Shkrimtari amerikan, Xhon; **29.** Shahisti holandez, Jan.

***VERTIKALISHT:*** **1.** Stop; **2.** Ramadan Krasniqi; **3.** Gjermani (vjet.); **4.** Çantë udhëtimi; **5.** Afrova (bised.); **6.** Vektor njëkahor; **7.** Q. E.; **8.** Ujdhesë koralesh; **9.** Emri, fama; **11.** Lloj vepre letrare; **14.** Shumëgjymtyrësh (mat.); **16.** Pika më e ulët (astr.); **18.** Shkon andej e këndej; **19.** Lloj sporti i stilit të mundjes; **20.** Zot, perendi; **21.** Shenja ndërkomb. për Irlandën; **22.** Qytet dhe territor i Palestinës; **23.** Qytet në Algjeri; **25.** Njësi e vjetër peshe; **27.** Simboli kimik i stronciumit.

***ZGJIDHJET:*** SALI, OPEL, MAZA, BRE, RATA, M, ET, KUKARAÇA, RU, EMIRA, AL, ORAR, CIGANE, ALMA, AUITA, ZT, ANAÇ, DAT, B, E NGRËNA, RAN, AKTI, ST, SHANTAZHI, KATE, PTERO, SELEK, SARAJET, ERI, EROL, TAKTIL, MAN, TORTILA. ***FJALËKR. KLASIK:*** NDAVA, OQEAN, DALLAVERE, TA, ANALIST, POM, LIMITE, NOLI, AXHA, EAL, XHANE, INDIGO, ULLI, ORDINAR, DA, SKLEROZA, O'HARA, TIMAN.



# Automobili i ardhshëm me dhomë ndeje në rrota

E ardhmja autonome do të transformojë edhe enterierin e automobilave. Në fakt, diçka nga ajo që pritet të vijë në të ardhmen tashmë ka nisur të prezantohet. Një trendi të tillë nuk do të mundë t'i ikin as kompanitë më të mëdha botërore, që tashmë kanë caktuar afatet kohore se kur do të mundë të sjellin automobila që vetëvoziten. Tash imagjinata se si të caktohen uleset për të shikuar një film në një ekran të madh nuk është e parealizueshme. Ose kontrollomi i funksioneve të ndryshme, si kondicioneri i ajrit duke klikuar në dritare, ose ndryshimi i pozicionit të retrovizorëve me kamera ashtu që të shihet gjithçka që po ndodh në trafik. Këto janë vetëm disa nga idetë me të cilat janë nisur kompanitë ndërkombëtare, teksa imagjinojnë të ardhmen e vozitjes autonome ose pa shofer.





## Bima që cila shëron diabetin dhe ndalon kancerin

Manaferrat goji, një lloj i veçantë i manaferrave, janë shumë të dobishme për shëndetin tonë, sidomos për ata prej nesh që vuajnë nga diabeti, shtypja e lartë e gjakut, malaria dhe karcinoma. Ky lloj i manaferrave e përmirëson qarkullimin, largon marramendjen dhe dhembjen e kokës, e është i dobishëm edhe për përmirësimin e shikimit. Kjo bimë arrin gjatësinë deri në tri metra, lulëzon gjatë tërë verës, e frutat i jep në vjeshtë. Shumë ekspertë preferojnë që këto pemë të mos mblidhen me duar, por që të shkunden nga pema. Meqë janë tepër të pasura me antioksidues, manaferrat goji përdoren edhe për forcimin e muskujve dhe eshtrave, përmirësojnë punën e zemrës, mëlçisë dhe veshkave. Më së miri është që ato të konsumohen si shtesë ndaj ushqimeve të tjera, e nga pemët e thara mund të përgatiten edhe çaje dhe lëngje. Këto pije zvogëlojnë djersitjen dhe gjakderdhjen nga hunda. Për nga shija, kjo pemë ngjan me stafidhet.

## Përse ish-duhanxhinjtë shëndoshen?

Njëri nga shkaqet që shumica e duhanxhinjve nuk i harrojnë ato shprehi të pashëndetshme është frika nga shëndoshja (shtimi në peshë). Në të vërtetë, afro 80 për qind e duhanxhinjve të cilët vendosin ta lënë duhanin shëndoshen mesatarisht për 7 kilogramë.

Shkencëtarët zviceranë konstatojnë që shkaku i shëndoshjes nuk janë kaloritë, shkruan "Deutsche Welle". Ata konstatojnë që shkaku i ndryshimeve është flora e zorrëve.

Shkencëtarët e Spitalit universitar të Cyrihut nëntë javë kanë analizuar kampionët e jashtëqitjes së personave që kanë pirë duhan dhe të atyre që nuk kanë pirë duhan dhe kanë konstatuar: derisa te duhanpirësit dhe te joduhanpirësit asgjë nuk ka ndryshuar, në florën e zorrëve të personave të cilët e kanë lënë duhanin kanë ndodhur ndryshime dramatike.

Kanë filluar të shtohen llojet e baktereve të cilat dominojnë edhe në zorrët e personave të tjerë. Ato baktere u takojnë familjeve të cilat profesionalisht quhen proteobacteria dhe baceteroidetes.



Personat të cilët e kanë lënë duhanin menjëherë kanë filluar të shëndoshen, edhe pse nuk kanë futur në organizëm më shumë kalori nëpërmjet ushqimit dhe pijeve sesa kur kanë pirë duhan.

Baktere të caktuara në florën e zorrëve janë në gjendje posaçërisht në mënyrë efektive të përpunojnë energjinë nga ushqimi dhe ta depozitojnë në qelizat e yndyrës. Për shkak të këtyre efekteve njerëzit shëndoshen.



## Serbia po zvogëlohet...

Për më pak se pesë vjet numri i banorëve në Serbi është pakësuar për 141 mijë e 136 veta, është thënë në një simpozium shkencor në Nish. "Në një kohë të shkurtër kemi mbetur pa një qytet mesatar në Serbi, sa Leskovci. Në periudhën e analizuar nga viti 2011 deri në vitin 2016, Beogradi është bërë me 21.744 banorë të rinj. Numri i njerëzve në Vojvodinë është pakësuar për 41.244, në Shumadi e Serbi perëndimore për 61.020, e në Serbinë lindore e juglindore për 60.616", citon "novostionline" të ketë thënë demografi dr.Edvard Jakopin në këtë simpozium shkencor. Në simpozium u përmenden dallime ekonomike të veriut e jugut e u theksua se paga në jug është 2.5 herë më e ultë nga ajo në Beograd.

## KALENDARI HISTORIK 28 PRILL

357 – Perandori Konstantini II viziton Romën
1376 – Parlamenti anglez kërkon mbikqyrjen ndaj harxhimeve mbretërore
1503 – Beteja e Karignallo: Ushtria spanjolle nën G. Kordoba mund Francën
1550 – Zgjerohet fuqia e inkuizicionit holandez
1655 – Admirali anglez Blejk mund flotën pirate Tunen
1848 – Lirohen robërit e fundit në kolonitë franceze
1910 – Fluturimi i parë gjatë natës (Claude Grahame-White, England)
1925 – Rebelët kurd dorëzohen para armatës turke
1932 – Shpallet vaksina e parë për njerëz kundër etheve të së verdhës
1938 – Mbreti i Shqipërisë Zogu martohet me Konteshën Gjeraldina të Hungarisë
1956 – Trupat e fundit francez largohen nga Vietnami
1967 - Muhammad Ali refuzon inkuadrimin në armatë dhe i hiqen titujt e boksit
1969 – Sharl de Gol jep dorëheqje si kryetari i Francës
1989 – Irani proteston kundër shitjes së 'Vargjeve Satanike' të Salman Ruzhdisë

## A E DINI SE...



Udhëheqësi bolshevik rus Lenini, vdiq në 21 janar të vitit 1924. Ai vuante nga një çrregullim degjenerativ i trurit. Në momentin e vdekjes, truri i tij ishte sa një e katërta e madhësisë normale.



Kryeministri liberal britanik, Uilliam Gladstoun, u lind në 29 dhjetor 1809. Me sa duket, si pasojë e impulseve të forta puritane, ai mbante një koleksion kamxhikësh në bodrumin e tij, me të cilët e ndëshkonte veten rregullisht.



Nëna e ish-kryeministrit legjendar britanik Uinston Çërçill, ishte me prejardhje nga Indianët e Kuq.

## BARSOLETA

**FËMIJA I PARË**

Një burrë tepër i emocionuar merr doktorin në telefon.
- Doktor, si t'ja bëj? Po më lind gruaja dhe dhimbjet i ka shumë të shpeshta.
- Fëmija i parë?
- Jo mor idiot, jam burri.

## THËNIA E DITËS



Ka vetëm një të mirë: dituria. Dhe vetëm një të keqe: padituria.
**(Sokrati)**